



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 85

Tiranë – E hënë, 23 maj 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.5.2016	Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim..... 4683

**VENDIM****Nr. 354, datë 11.5.2016****PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË
TARIFAVE PËR SHËRBIME NË
PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM,
MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe

kolaudim, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vendimi nr.704, datë 29.10.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe të gjitha ministritë, institucionet dhe subjektet që investojnë fonde publike apo private në vepra ndërtimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MANUALI I TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM

TIRANË 2016

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E TABELAVE.....	5
AKRONIME.....	5
KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	6
Neni 1 Fusha e veprimit	6
Neni 2 Përkufizimet.....	6
Neni 3 Shërbimet dhe tipologjitë e shërbimit.....	7
Neni 4 Kostot e llogaritshme.....	9
Neni 5 Grupet tarifore.....	9
Neni 6 Baza për tarifat.....	9
Neni 7 Përcaktimi i tarifave.....	10
Neni 8 Llogaritja e tarifave në situata të veçanta.....	11
Neni 9 Llogaritja e tarifave për shërbime të veçanta.....	12
Neni 10 Planet përgatitore dhe përfundimtare të projektit.....	12
Neni 11 Kontratat për projektet e pjesshme.....	12
Neni 12 Rishikime të pjesshme të Planeve Vendore.....	13
Neni 13 Interpolimi.....	13
Neni 14 Shpenzime mbështetëse.....	13
Neni 15 Pagesa.....	14
Neni 16 TVSH.....	14
KREU II PLANET VENDORE	14
Neni 17 Fusha e veprimit.....	14
Neni 18 Planifikimi i përgjithshëm vendor sipas fazave.....	14
Neni 19 Tabela e tarifave për shërbimet, në lidhje me planet e përgjithshme vendore	15
Neni 20 Planifikimi i detajuar vendor, sipas fazave.....	18
Neni 21 Tabela e tarifave për shërbimet, në lidhje me planet e detajuara vendore.....	18

Neni 22 Shërbime të veçanta për tipologjitë e shërbimit të planifikimit.....	21
KREU III PLANIFIKIMI I OBJEKTEVE.....	23
SEKSIONI I NDËRTHESAT DHE NDARJET FUNKSIONALE TË TYRE.....	23
Neni 23 Parimet e tarifave.....	23
Neni 24 Fazat e projektimit të ndërtesave dhe ndarjet funksionale të tyre sipas tipologjisë.....	23
Neni 25 Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre sipas tipologjisë, si dhe strukturat në ambientet e jashtme sipas tipologjisë së shërbimit.....	24
Neni 26 Tabela e tarifave për shërbimet lidhur me ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre	31
Neni 27 Shërbimet për ndërtesat ekzistuese.....	33
Neni 28 Mirëmbajtja dhe riparimi.....	34
Neni 29 Grupet tarifore për ndërtesat dhe ndarjet funksionale të brendshme.....	34
SEKSIONI II STRUKTURAT NË AMBIENTET E JASHTME.....	38
Neni 30 Parimet e tarifave.....	38
Neni 31 Fazat e projektimit të strukturave në ambientet e jashtme sipas tipologjisë së shërbimit.....	39
Neni 32 Tabela e tarifave për shërbimet, që kanë të bëjnë me strukturat në ambientet e jashtme	40
Neni 33 Grupet tarifore dhe klasifikimi i tyre.....	42
SEKSIONI III VEPRA INXHINIERIKE.....	44
Neni 34 Fusha e veprimit.....	44
Neni 35 Parimet e tarifave.....	44
Neni 36 Fazat e projektimit të veprave inxhinierike.....	44
Neni 37 Shërbime për planifikimin e objekteve ndërtimore inxhinierike dhe të komunikacionit.	46
Neni 38 Tabela e tarifave, për shërbimet, në lidhje me punimet e veprave inxhinierike	52
Neni 39 Grupet tarifore dhe klasifikimi i tyre.....	54
SEKSIONI IV STRUKTURAT E TRANSPORTIT DHE QARKULLIMIT.....	58
Neni 40 Fusha e veprimit.....	58
Neni 41 Parimet e tarifave.....	59

Neni 42 Fazat e projektimit të strukturat të transportit sipas tipologjisë së shërbimit.....	59
Neni 43 Shërbimet për planifikimin e strukturave të transportit sipas tipologjisë së shërbimit.....	60
Neni 44 Tabela e tarifave për shërbimet në lidhje me strukturat e transportit.....	61
Neni 45 Grupet tarifore dhe klasifikimi i tyre.....	63
KREU IV PROJEKTET SPECIFIKE.....	65
SEKSIONI I PROJEKTIMI I STRUKTURAVE ME AFTËSI MBAJTËSE.....	65
Neni 46 Fusha e veprimit.....	65
Neni 47 Parimet e tarifave.....	66
Neni 48 Fazat e projektimit të strukturave mbajtëse.....	67
Neni 49 Shërbimet për planifikimin e strukturave mbajtëse.....	68
Neni 50 Tabela e tarifave për shërbimet në lidhje me projektimin e strukturave mbajtëse.....	71
Neni 51 Grupet tarifore dhe klasifikimi i tyre.....	72
SEKSIONI II SISTEMET TEKNIKE.....	74
Neni 52 Fusha e veprimit.....	74
Neni 53 Parimet e tarifave.....	75
Neni 54 Fazat e projektimit të sistemeve teknike sipas tipologjisë.....	75
Neni 55 Shërbimet në planifikimin e sistemeve teknike.....	77
Neni 56 Tabela e tarifave për sistemet teknike.....	81
Neni 57 Grupet tarifore dhe klasifikimi i tyre.....	82
SEKSIONI III SHËRBIME QË I TAKOJNË NËNTOKËS DHE PUNIMEVE NË THEMELE	84
Neni 58 Parimet e tarifave.....	84
Neni 59 Fazat e projektimit të shërbimeve të nëntokës dhe punimeve në themele.....	84
Neni 60 Tabela e tarifave për shërbimet që i takojnë nëntokës punimeve nën themele.....	86
Neni 61 Grupet tarifore dhe klasifikimi i tyre.....	88
KREU V SHËRBIMET PËR KOLAUDIMIN	89
Neni 62 Tarifat për kolaudimin e shërbimeve të ndërtimit.....	89

KREU VI SHËRBIMET E RILEVIMIT TOPOGRAFIK	90
Neni 63 Fusha e veprimit.....	90
SEKSIONI I SHËRBIME TOPOGRAFIKE NË FAZËN E PROJEKTIMIT.....	91
Neni 64 Parimet e tarifave	91
Neni 65 Fazat e shërbimi	92
Neni 66 Shërbimet për rilevimin topografik në fazën e projektimit.....	93
Neni 67 Grupimet tarifore për shërbimet e rilevimit topografik, në fazën e projektimit.....	95
SEKSIONI II SHËRBIME TOPOGRAFIKE NË FAZËN E NDËRTIMIT.....	97
Neni 68 Parimet e tarifimit.....	97
Neni 69 Fazat e shërbimit	98
Neni 70 Shërbimet për rilevimin topografik në fazën e ndërtimit.....	99
Neni 71 Grupimet tarifore për shërbimet e rilevimit topografik, në fazën e projektimit.....	100
SEKSIONI III TABELA E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E RILEVIMEVE TOPOGRAFIKE.....	102
Neni 72 Tabela e tarifave.....	102
Neni 73 Shërbime të rilevimit topografik kadastror.....	104
KREU VII SHËRBIMET E STUDIMEVE TË NDIKIMIT NË MJEDIS	104
Neni 74 Fazat e studimeve të ndikimit në mjedis.....	104
Neni 75 Shërbimet për studimet e ndikimit në mjedis.....	105
Neni 76 Grupet tarifore për shërbimet bazë, lidhur me studimet e ndikimit në mjedis.....	107
Neni 77 Tabelat e tarifave.....	110
KREU VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE.....	112
Neni 78 Dispozitat kalimtare.....	112
Neni 79 Shfuqizimet	112
Neni 80 Hyrja në Fuqi.....	112

LISTA E TABELAVE

Tabela. 1 Tabela e përqindjes së tarifimit sipas fazave të shërbimit të planifikimit të territorit.....	14
Tabela. 2 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 19, paragrafi 1 - Planet e Përgjithshme Vendore.....	16
Tabela. 3 Tabela shoqëruese e tarifave, sipas fazave - Planet e Detajuara Vendore.....	18
Tabela. 4 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 21, paragrafi 1 - Planet e Detajuara Vendore.....	20
Tabela. 5 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 24 - Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre.....	24
Tabela. 6 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 25 - Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre sipas tipologjisë, si dhe strukturat në ambientet e jashtme sipas tipologjisë së shërbimit.....	32
Tabela. 7 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për strukturat në ambientet e jashtme.....	40
Tabela. 8 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 32, pika 1 - Strukturat në ambientet e jashtme.....	41
Tabela. 9 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për veprat inxhinierike.....	45
Tabela. 10 Tabela e shoqëruese e tarifave, neni 38, pika 1 - Punimet e veprave inxhinierike.....	52
Tabela. 11 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për strukturat e transportit.....	60
Tabela. 12 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 44, pika 1 - Strukturat e transportit (Qarkullimi).....	62
Tabela. 13 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për strukturat me aftësi mbajtëse.....	67
Tabela. 14 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 40, pika 1 - Strukturat mbajtëse.....	72
Tabela. 15 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për sistemet teknike.....	77
Tabela. 16 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 56, pika 1 - Sistemet teknike.....	81
Tabela. 17 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për nëntokën dhe punimet e themeleve.....	84
Tabela. 18 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 60, pika 1 - shërbimet që i takojnë nëntokës punimeve nën themele.....	86
Tabela. 19 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 62, pika 1 - shërbimet që i takojnë shërbimeve për kolaudimin.....	88
Tabela. 20 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për rlevimet topografike.....	91
Tabela. 21 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për rlevimet topografike, shërbimet e veçanta.....	97
Tabela. 22 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 72 - shërbimet e rlevimit topografik.....	101
Tabela. 23 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 73 - shërbimet e rlevimit topografik kadastrale.....	102
Tabela. 24 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për vlerësimet e ndikimit në mjedis.....	103
Tabela. 25 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 76 - shërbimet e lidhur me studimet e ndikimit në mjedis.....	109

AKRONIME

- AKM - Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- ARM - Agjencia Rajonale e Mjedisit
- VNM - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
- PPV - Plani i Përgjithshëm Vendor
- PDV - Plani i Detajuar Vendor
- KKT - Këshilli Kombëtar i Territorit
- NJ.Q.V. - Njësi të Qeverisjes Vendore

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Fusha e veprimit

1. Ky manual i tarifave vlen për llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet e planifikimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, të kryera nga arkitektët dhe inxhinierët (porosimarrës), të financuara me fonde publike, të përfshira në listën e punimeve të këtij manuali.
2. Në rastin kur shërbimet e përmendura në pikën 1, financohen nga subjekte private, atëherë llogaritja për tarifën e shërbimeve nuk mund të jenë më të vogla se tarifën minimale referuese në këtë manual.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij manuali, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "**Objektet**" janë: ndërtesat, ndarjet funksionale të brendshme, të tyre, strukturat në ambientet e jashtme, strukturat mbajtëse dhe objektet për shërbime teknike.
2. "**Ndërtesat**" janë struktura të mbyllura, që funksionojnë në mënyrë të pavarur, të cilat mundësojnë hyrjen e njerëzve dhe janë të përshtatshme ose të destinuara për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose sendeve.
3. "**Ndërtesa dhe struktura të reja**" përkufizohen si struktura, që ndërtohen ose krijohen nga fillimi.
4. "**Rindërtimet**" janë objekte, dikur të shkatërruara që rindërtohen në ndërtesën ekzistuese ose mbi elementet strukturorë. Ato klasifikohen si ndërtesa të reja, në qoftë se është i domosdoshëm riprojektimi i tyre.
5. "**Zgjerimet**" përkufizohen si shtesa në një projekt ekzistues.
6. "**Shndërrimet**" janë rimodelim i një projekti ekzistues, që përfshin ndryshime thelbësore në ndërtimin e tij ose në përbërësit strukturorë, që i shërbejnë ndryshimit të destinacionit;
7. "**Modernizimet**" janë punë ndërtimore, që kanë për qëllim që të rrisin vlerën ose përdorimet e objektit, përveç rasteve të përshkruara në pikat 5, 6 ose 9 të këtij neni.
8. "**Ndarje funksionale të brendshme**" përkufizohen si ndërtime apo krijime të brendshme, që përfshijnë ndryshime jothelbësore në ndërtim ose në elementet strukturorë. Këto mund të ndodhin, njëkohësisht, me shërbimet e mbuluara nga pika 3-7 të këtij neni.
9. "**Riparimet**" përkufizohen si punë me qëllime restauruese (sipas projektit të mëparshëm) për të rikthyer një projekt në gjendje të përshtatshme për funksionin e

kaktuar, përveç punimeve të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, ose që vijnë si rezultat nga masat e përcaktuara në pikën 7, të këtij neni.

- 10 "**Mirëmbajtja**" përkufizohet si punë, me qëllim për të ruajtur objektin në gjendjen e tij të projektimit.
11. "**Struktura në ambientet e jashtme**" përkufizohen si sipërfaqe apo struktura të projektuara për ambientet e hapura, apo instalime, të përfshira brenda strukturave, ose në ndihmë të tyre.
12. "**Standardet teknike të njehsuara**" janë specifikime teknike të shkruara, të cilat reflektojnë opinionin profesional bashkëkohor, i përshtaten konsumatorëve dhe publikut, lejojnë përcaktimin e kostos së llogaritshme në përputhje me vetë manualin dhe janë të provuara në praktikë.
13. "**Preventivat paraprake**" përkufizohen si një përcaktim i përafërt i shpenzimeve, në bazë të projektimit paraprak. Ato janë baza të përkohshme, për çdo planifikim financiar dhe janë bazuar në gjetjet e projektimit paraprak, llogaritjet sasiore, informacionit shpjegues, lidhur me faktorët e projektimit, proceset dhe kushtet, duke përfshirë informacion mbi truallin e ndërtimit, si dhe lidhjen me infrastrukturën përreth.
14. "**Llogaritjet e kostove**" përkufizohen si përcaktim i shpenzimeve, në bazë të formës përfundimtare të projektimit. Ato janë të bazuara në vizatimet e rishikuara të projektimit apo vizatime të detajuara të planeve tip, si dhe llogaritjet sasiore dhe shpjegimet përkatëse për llogaritjen dhe vlerësimin e kostove.
15. "**Grupet tarifore**" paraqesin shkallën e vështirësisë së projektimit të një objekti ose të një sipërfaqeje.
16. "**Shërbimet**" i referohen shërbimeve të planifikimit dhe studimit urban, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit.

Neni 3

Shërbimet dhe tipologjitë e shërbimit

1. Shërbimet, në kuptimin e këtij manuali tarifash, janë kategorizuar në: shërbime themelore, të veçanta dhe shtesë. Në kreun e II-të, III, IV, VI dhe VII-të të këtij manuali, përcaktohen rregulla të detyrueshme, për tarifën e shërbimeve themelore.
2. Shërbimet themelore, përfshijnë shërbime të tilla, që në përgjithësi janë të nevojshme, për të përmbushur një kontratë. Këto shërbime themelore, janë grupuar të gjitha, në tipologjitë e shërbimit.
3. Shërbimet e veçanta, përfshijnë shërbime të cilat kërkohen si një modifikim i qëllimit të shërbimit, të fushës së veprimit, ose marrëveshjeve të tjera të klientit. Ato nuk janë të përfshira në kuadër të tipologjisë së shërbimit dhe për këtë arsye mund të negociohen dhe tarifohen të veçuara nga shërbimet themelore.

Për shërbime të veçanta, të cilat nuk arrihen të sigurohen nga profesionistë brenda vendit, në këtë rast aplikohen rregullat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik.

4. Shërbimet që nuk parashikohen të tarifohen sipas tarifave të përcaktuara në këtë manual, vlerësimet e tyre bëhet sipas shpenzimeve faktike, duke shtuar mbi këto deri 60% për shpenzimet e ndryshme administrative, në varësi nga puna, vendi i ndërtimit dhe shpenzimet shtesë të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi (pagesa për personelin administrativ, kancelarinë, shpenzime për qira, ujë të pijshëm, energji elektrike, telefoni, udhëtime e dieta, amortizimin e pajisjeve etj.). Mbi shumën e përgjithshme të këtyre shpenzimeve shtohet fitimi i planifikuar në masën 15%.
5. Tipologjitë e shërbimit të përcaktuara në këtë manual janë të ndara sipas fazave 1-9 paraqitur më poshtë:
 - FAZA I: Analiza e detyrës së projektimit /termat e referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit;
 - FAZA II: Projektideja paraprake;
 - FAZA III: Projektideja përfundimtare;
 - FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit;
 - FAZA V: Projekti i zbatimit;
 - FAZA VI: Preventivi përfundimtar;
 - FAZA VII: Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi;
 - FAZA VIII: Mbikëqyrje;
 - FAZA IX: Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar për kolaudim.
6. Projektimi i strukturave mbajtëse përfshin vetëm fazat e shërbimit III-VI.
7. Pavarësisht nga pika 5, projektimi i planeve vendore, neni 18 përfshin gjashtë faza, planifikimi i detajuar vendor, neni 20 përfshin pesë faza, projektimi i strukturave mbajtëse, neni 48 përfshin gjashtë faza, planifikimi i punimeve të nëntokës dhe themeleve, neni 59 përfshin tre faza, shërbimet topografike tokësore, fotogrametrike në fazën e projektimit, neni 65 përfshin gjashtë faza, shërbimi i rilevimit topografik në fazën e ndërtimit, neni 69 përfshin katër faza, studimi i ndikimit në mjedis, neni 73 përfshin katër faza. Efektiviteti i kostos së shërbimit duhet të merret gjithmonë në konsideratë.
8. Fazat e shërbimit të trajtuara në kreu II-të, deri në kreun VII-të janë vlerësuar si një normë përqindjeje e tarifave.

Neni 4

Kostot e llogaritshme

Kostot e llogaritshme janë pjesë e kostove të ndërtimit, rindërtimit, modernizimit, mirëmbajtjes ose riparimit të objekteve dhe shpenzimeve të lidhura. Ato duhet të përcaktohen duke iu referuar standardeve teknike, të përcaktuara ose rregulloreve administrative mbi bazën e çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre në fuqi. Shpenzimet e tatimit mbi vlerën e shtuar nuk përfshihen në koston e llogaritshme.

Neni 5

Grupet tarifore

1. Planifikimi i objekteve, projektimi i strukturave me aftësi mbajtëse klasifikohen sipas grupeve të mëposhtme të tarifimit:
 - i) Grupi I tarifor: kërkesa shumë të vogla planifikuese;
 - ii) Grupi II tarifor: kërkesa të vogla planifikuese;
 - iii) Grupi III tarifor: kërkesa mesatare planifikuese;
 - iv) Grupi IV tarifor: kërkesa mbi mesataren planifikuese;
 - v) Grupi V tarifor: kërkesa shumë të larta planifikuese.
2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, projektimi i sistemeve teknike është klasifikuar sipas grupeve të mëposhtme të tarifimit:
 - i) Grupi I tarifor: kërkesa të vogla planifikuese;
 - ii) Grupi II tarifor: kërkesa mesatare planifikuese;
 - iii) Grupi III tarifor: kërkesa të larta planifikuese.
3. Grupet tarifore përcaktohen në bazë të kriterëve të vlerësimit, për rregullimin e tarifave në tipologjitë e shërbimit, të trajtuara në kreu II-të, III, IV, VI dhe VII-të. Klasifikimi, sipas grupeve tarifore individuale, bëhet në bazë të kriterëve të vlerësimit apo sistemit të pikëzimit, aty ku kjo është e zbatueshme.

Neni 6

Baza për tarifimin

1. Tarifat për shërbimet e përcaktuara nga ky manual bazohen:
 - i) në tipologjinë e shërbimit, për seksionin II-të dhe IV-ërt të kreut III, në bazë të kostove në ngarkim të projektit bazuar në kostot e llogaritshme, ose, nëse kjo nuk është në dispozicion, bazuar në kostot vlerësuese, ndërsa për tipologjitë e shërbimit në seksionin e II-të të kreut III, në bazë të madhësisë së sipërfaqes, ose të njësive llogaritëse.
 - ii) në tipologjinë e shërbimit,
 - iii) në grupet tarifore,

- iv) në tarifat e tabelave shoqëruese,
 - v) në shërbimet e rindërtimit, sipas nenit 27 dhe 28.
2. Në qoftë se, në datën e vënies në shërbim nuk ka në dispozicion projekt, si një parakusht të llogaritjes së shpenzimeve ose të llogaritjes së kostos, tarifat të llogariten në bazë të kostove të matëshme të ndërtimit, sipas dispozitave të këtij manuali. Kjo do të mundësojë që palët të bien dakort për kostot e verifikueshme të ndërtimit.

Neni 7

Përcaktimi i tarifave

1. Tarifa për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuara në këtë manual, në përputhje me ligjin e prokurimit publik.
2. Nëse kostot e llogaritshme të identifikuara, vlerat ose njësitë e llogaritjes qëndrojnë jashtë vlerave tabelare të këtij manuali, tarifat sipas rastit janë më të ulëta apo më të larta të llojit apo grupit tarifor përkatës të shërbimit, si dhe koeficientin e ndryshimit të tarifave për atë grup tarifor, në nivel rritës apo zbritës për secilën vlerë tabelare, domethënë, nëse kemi një kosto të llogaritshme më të lartë se vlera në tabelë, tarifa llogaritet sipas tarifës së vlerës më të lartë të tabelës e zbritur me koeficientin e ndryshimit.
3. Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat edhe mund të jenë më të ulëta se sa tarifa minimale, të specifikuar nga ky manual.
4. Tarifat maksimale, të specifikuar nga ky manual, nuk mund të tejkalohen, përveç se në rastin e shërbimeve të jashtëzakonshme, apo të shërbimeve që shtrihen në një periudhë të gjatë kohore, për më shumë se dy vjet. Në këtë rast, marrëveshja me shkrim është e nevojshme. Faktorët, të cilët janë të rëndësishëm, në drejtim të caktimit të punës në grupet tarifore ose për renditjen e punës në shkallët minimale/maksimale nuk do të merren parasysh në rrethana të tilla.
5. Nëse, gjatë kohës të vlefshmërisë së kontratës, ndryshon projekti me kërkesë të porositesit, duke ndikuar në ndryshimin e kostos së llogaritshme, vlerat ose njësitë e llogaritjes, atëherë marrëveshja mbi të cilën është e llogaritur tarifa, duhet të rillogaritet dhe të dokumentohet me shkrim.
6. Nëse, nuk është rënë dakord ndryshe me shkrim, në kohën e dhënies së kontratës, tarifat minimale përkatëse, sipas pikës 1 të këtij neni, do të llogariten siç është rënë dakord. Përveç, rastit kur marrëveshja për tarifën është hartuar në bazë të pikës 1 të këtij neni, fazat e shërbimit I dhe II të zonës që do të zhvillohet do të vlerësohen si tarifë minimale e përqindjes së tarifës përkatëse.

7. Në rastin e uljes së konsiderueshme të kostove të llogaritshme, që vijnë si rezultat i punës tekniko-shkencore, ose si zgjidhje të një ndikimi pozitiv në mjedis dhe që nuk ulin standardet e veprës të përshkruar në kontratë, mund të merret në konsideratë pagimi i një "tarife suksesi". Tarifa e suksesit është tarifë shtesë e llogaritur në bazë të vlerës që fitohet me tarifën përkatëse. Kufiri minimal dhe maksimal mund të jetë pjesë e negociatave, që mund të arrijë deri në 20% të tarifës bazë, të fiksuar në kontratë. Në rastet e rritjes së kostove të llogaritshme të fiksuar në kontratë, mund të merret në konsideratë një ulje e tarifës së fiksuar në kontratë. Kjo ulje llogaritet në bazë të vlerës që fitohet me tarifën përkatëse. Kufiri minimal dhe maksimal mund të jetë pjesë e negociatave që mund të arrijë deri në masën 5% të saj.
8. Për lidhjen e kontratës së shërbimit dhe për llogaritjen e tarifës, si bazë merret vlerësimi i përafërt i kostove të llogaritshme, i cili parashtrohet nga investitori (porositësi) ose përgatitet nga ofruesi i shërbimit në kryerjen e fazës së dytë të shërbimit "Projektideja paraprake". Në rastin, kur vlerësimi i përafërt i kostos llogaritet nga ofruesi i shërbimit, atëherë kjo kosto mbart një tolerancë maksimale prej 30% nga kostoja përfundimtare. Kjo kosto shërben si bazë për lidhjen e kontratës. Mbas përfundimit të fazës së shtatë të shërbimit: "Organizimi i procedurës dhe vlerësimi i tenderit" vendoset "Kostoja e llogaritshme e tenderuar" dhe bëhet rillogaritja e tarifës së shërbimit, e cila i shtohet kontratës në formën e një shtojce. Kjo kosto mbart një tolerancë maksimale prej 10% nga kostoja e llogaritshme përfundimtare. Mbas përfundimit të fazës së nëntë të shërbimit: "Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar për kolaudim", bëhet kontraktimi i "Kostos së llogaritshme përfundimtare të objektit". Kjo kosto është kostoja e llogaritshme përfundimtare dhe reale dhe mbi këtë kosto bëhet rillogaritja e tarifës përfundimtare të shërbimit.
9. Nëse objekti nuk prokurohet për zbatim brenda 12 muajve nga data e marrjes në dorëzim të projektit, projektuesit i lind e drejta e marrjes së kostos së përafërt të llogaritur në fazën e dytë të shërbimit duke i zbritur tolerancën maksimale prej 30%.
10. Ngarkohet ministria përgjegjëse për zhvillimin urban për të ofruar mbështetjen ndaj AKSHI-t për zhvillimin e sistemit informatik për llogaritjen e tarifave të manualit.

Neni 8

Llogaritja e tarifave në situata të veçanta

1. Në rast se nuk janë porositur të gjitha fazat e shërbimit të një tipologjie shërbimi, atëherë mund të zbatohet vetëm përqindja e tarifës së lejuar, për ato faza të shërbimeve të porositura dhe të fiksuar kontraktualisht.
2. Në rast se, kontrata nuk i mbulon të gjitha nënfazat e një faze, atëherë tarifat e llogaritura dhe të negociuara për nënfazat e porositura duhet të korrespondojnë

proporcionalisht me nënfazat e porositura të tipologjisë së përgjithshme të shërbimit. E njëjta gjë vlen, në qoftë se ofruesit të shërbimit nuk i është porositur një pjesë e rëndësishme e shërbimeve themelore. Gjithsesi, në këto raste, duhet të merret parasysh kostoja shtesë për punën e koordinimit dhe përpunimit me fazat ose nënfazat e tjera.

Neni 9

Llogaritja e tarifave për shërbime të veçanta

1. Nëse vizatimet paraprake ose projektidetë përfundimtare janë porositur si shërbime të veçanta në kontrata, për planet urbane të përdorimit të tokës, ndërtesave dhe ndarjet funksionale të tyre, objekteve në ambiente të hapura, punimeve inxhinierike, objekteve të transportit dhe qarkullimit, sistemeve teknike, atëherë tarifimi i shërbimit përkatës (të fazës së shërbimit që i takon), do të jetë:
 - i) Për projektidenë paraprake: tarifa në përqindje, për projektidenë paraprake, plus tarifa pjesore, ose deri në maksimum për fazën e mëparshme.
 - ii) Për projektidenë përfundimtare: tarifa në përqindje, për projektidenë përfundimtare, plus tarifa pjesore, ose deri në maksimum për fazën korrente të shërbimit bazë.
2. Në rast se projektideja paraprake e strukturave, në ambientet e jashtme është porositur si shërbim më vete, pavarësisht vlerësimeve për shërbimet në nenin 31, mund të rritet deri në 60% të tarifës totale.

Neni 10

Planet përgatitore dhe përfundimtare të projektit

Nëse, me kërkesën e porositësit, hartohen disa projektide paraprake për të njëjtin projekt dhe me kërkesa të ndryshme, atëherë tarifatat e plota, në përqindje të aplikueshme për këto faza të shërbimit në nenin 3, pika 5, mund të negociohet në lidhje me hartimin paraprak, ose përfundimtar. Në llogaritjen e tarifës, për çdo variant shtesë duhet të përcaktohet kontraktualisht edhe përqindja e tarifës në proporcion me variantin e parë.

Neni 11

Kontratat për projektet e pjesshme

1. Kur kontrata përfshin disa projekte, atëherë pavarësisht nga paragrafët e mëposhtëm tarifatat duhet të llogariten veçmas për çdo projekt. Kjo nuk vlen për projekte me kërkesa shumë të ngjashme në të njëjtin grup tarifor, të cilat janë të destinuara që të operohen dhe të përdoren në afërsi kohore dhe fizike, si pjesë e një skeme në shkallë të madhe. Në këtë rast, tarifa llogaritet si shumë e kostove të llogaritshme.

2. Kur kontrata përfshin disa projekte, në thelb të ngjashme, të cilat kanë për qëllim që të vendosen në afërsi kohore ose fizike në kushte të ngjashme operative ose ku projektet janë të projektuara tip ose për prodhim në seri, normat, nëpërqindje të aplikueshme për fazën e shërbimit 1-7, duhet të reduktohen me 50% për katër objektet e para, me 60% nga objekti i pestë deri në të shtatin, kurse nga i teti dhe në vazhdim llogaritjet reduktohen në 90%.
3. Kur kontrata përfshin shërbime, të cilat kanë qenë më parë objekt i një kontrate të ndryshme në mes të palëve të pranishme kontraktuese, atëherë pika 2 më lart vlen në përputhje me normat në përqindje aplikuar për fazat e shërbimit të porositura në kontratën e re, edhe nëse shërbimet nuk kanë qëllim për t'u kryer në afërsi kohore apo fizike.
4. Pikat 1 deri në 3, më lart, nuk do të zbatohen për planet vendore. Për sa kohë që specifikimet, gjetjet nga planet e tjera, preventivat fillestare të kostove, si dhe të peizazhit, mund të merren të gatshme, në këtë rast tarifatat duhet të reduktohen në mënyrë të arsyeshme. Kjo vlen edhe për rastet, kur këto plane i ka hartuar një planifikues urban/urbanist tjetër.

Neni 12

Rishikime të pjesshme të planeve vendore

Aty ku nënzonat, pjesë e planeve vendore kërkojnë përditësim apo ndryshim, atëherë, llogaritjet tarifa vetëm duke iu referuar faktorëve të ndryshuar në përpunimin e kësaj sipërfaqeje.

Neni 13

Interpolimi

Tarifatat minimale dhe maksimale të lejuara, për pikë të ndërmjetme të kostove të llogaritshme, vlerave dhe/ose njërive të llogaritjes, të përcaktuara në rreshtat e tabelave të tarifave, duhet të llogariten me interpolim linear.

Neni 14

Shpenzime mbështetëse

1. Shpenzimet mbështetëse të shkaktuara, nga ofruesi i shërbimit për plotësimin e kontratës, nëse ato janë të nevojshme, mund të llogariten mbi shumën e tarifës së projektimit.
2. Palët kontraktuese mund të përcaktojnë në momentin e nënshkrimit të kontratës edhe shërbimet mbështetëse, të cilat mund edhe të përjashtohen nëse nuk i nënshtrohen pikës 1 të këtij neni.
3. Shpenzimet mbështetëse përfshijnë:

- i) kostot e dërgimit me postë, kostot e transferimit të të dhënave, kostot për shumëfishimin e vizatimeve, përfshirë realizimin e filmave dhe fotove;
 - ii) kostot e mbajtjes së një zyre duke përfshirë pajisje, ndriçim dhe ngrohje;
 - iii) kostot për shpenzimet e udhëtimeve jashtë një rrezeje prej 15 kilometër nga zyra e regjistruar e ofruesit të shërbimit, rimbursohen në bazë të akteve ligjore në fuqi.
 - iv) shërbime, të cilat nuk janë të parashikuara në kontratë dhe që duhen bërë nga specialistë të tretë.
4. Shpenzimet mbështetëse mund të llogariten në mënyrë afrofe ose të vërtetohen në mënyrë të detajuar. Ato njihen vetëm në bazë të faturave fiskale, nëse nuk është rënë dakord për një llogaritje afrofe.

Neni 15

Pagesa

1. Pagesa duhet të shlyhet, nëse në kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, kur shërbimi është kryer konform kontratës dhe është paraqitur tek porositësi një faturë e kontrollueshme.
2. Këstet mund të paguhen në afatet e përcaktuara në kontratë ose në distanca kohore logjike për shërbime të kryera dhe të vërtetueshme.
3. Shpenzimet mbështetëse duhet të paguhen pas paraqitjes së fakteve, nëse nuk është përkufizuar ndryshe në kontratë.
4. Për modalitete të tjera të pagesës duhet të bihet dakort me shkrim.

Neni 16

TVSH

Mbi tarifatat për shërbimet aplikohet vlera eTVSH-së sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

KREU II PLANET VENDORE

Neni 17

Fusha e veprimit

Produktet e planit të përgjithshëm vendor (niveli vendor dhe më lart) përfshijnë përgatitjen dhe hartimin e planeve, detajimet dhe relacionet e domosdoshme, përgatitjen e bazës së të dhënave GIS dhe materialin hartografik, si dhe proceset e miratimit.

Neni 18
Planifikimi i përgjithshëm vendor sipas fazave

1. Shërbimet e planifikimit të përgjithshëm vendor janë përmbledhur në gjashtë faza të shërbimit dhe vlerësohen në përputhje me përqindjet mbi vlerën e tarifës, të përcaktuar në nenin 19. Fazat e shërbimit dhe përqindjet përkatëse, jepen në tabelën më poshtë:

Nr.	Fazat e shërbimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e I-rë	Hartimi i nismës për fillimin e PPV dhe miratimi në instancat përkatëse	1%-5%
2	Faza e II-të	Përgatitja e analizës së thelluar	10%-20%
3	Faza e III-të	Hartimi i planit paraprak	30%
4	Faza e IV-ërt	Hartimi i planit përfundimtar	25%
5	Faza e V-të	Hartimi i rregullores	15%
6	Faza e VI-të	Projekti përfundimtar për miratim	5%

Tabela. 1 Tabela e përqindjes së tarifimit sipas fazave të shërbimit të planifikimit të territorit

Shpjegim: Kur nisma për fillimin e PPV-së hartohet për herë të parë, atëherë kjo fazë duhet të llogaritet 5%, në rast se kryhet rishikimi i nismës për fillimin e PPV-së, kjo fazë duhet të llogaritet me 1%-3%.

Edhe për fazën e dytë do të ndiqet po e njëjta logjikë si më lart, për rastet e hartimit të nismës për fillimin e PPV-së për herë të parë, përgatitja e analizës së thelluar do të llogaritet me 20%, kurse në rastin kur kryhet rishikimi i hartimit të nismës për fillimin e PPV-së, përgatitja e analizës së thelluar do të llogaritet me 10%-15%.

2. Përmbajtja për secilën fazë do të respektojë rregulloret e planifikimit të legjisalcionit përkatës.

Neni 19

Tabela e tarifave për shërbimet, në lidhje me planet e përgjithshme vendore

X

1. Tabela e mëposhtme specifikon tarifat minimale dhe maksimale, në lidhje me Planet e Përgjithshme Vendore (niveli vendor dhe më lart), të listuara në nenin 18.
2. Tarifat do të llogariten, në përputhje me kriteret e listuara, në paragrafin 3, më poshtë. Për secilin nga kriteret 1 deri 3, duhet të llogariten të shkëputura pikët dhe për llogaritjen e tarifës së përgjithshme duhet të bëhet shuma e tyre. Shuma, si rezultat i mbledhjes së pikëve të dy kriterëve të para, të paragrafit 3, do të përcaktojë një grup të vetëm tarifor, siç përshkruhet në pikën 7, në vijim. Ndërsa, pikët që i takojnë kriterit të tretë, do të përcaktojnë një grup tarifor më vete. Shuma, e këtyre dy grupeve tarifore, do të përcaktojë tarifën e përgjithshme.
3. Tarifat duhet të përcaktohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:
 - i) Numri i popullsisë ekzistuese, për kohën kur hartohet plani:
Për 1 banor - 10 njësi të llogaritjes;
 - ii) Sipërfaqja, që do të planifikohet, duke përfshirë vetëm tokën e deklaruar si tokë truall: Për 1 hektar - 1800 njësi të llogaritjes;
 - iii) Sipërfaqja që do të planifikohet, që përfshin tokat jo-truall, si psh. tokat bujqësore, fondi pyjor, tokat e pafrytshme, livadhet, kullotat e të tjera të ngjashme me to: Për 1 hektar - 35 njësi të llogaritjes.
4. Tarifa totale, për shërbimet në fazat I deri në V, duhet të arrijnë në të paktën 250000 lekë.
5. Ndarja në grupet tarifore përcaktohet në bazë të kriterëve të mëposhtme të vlerësimit për kërkesat e projektimit:
 - i) Kushtet topografike dhe situata gjeologjike;
 - ii) Kërkesat mjedisore dhe kërkesat ndaj strukturës urbane, mbrojtja ndaj monumenteve;
 - iii) Përdorimi dhe dendësia;
 - iv) Shkalla e kërkuar e cilësisë për procesin e planifikim/projektimit;
 - v) Lidhja me infrastrukturën ekzistuese;
 - vi) Mbrojtja e mjedisit dhe kushtet ekologjike.
6. Gjatë përlllogaritjes së grupit tarifor, për hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore, shkalla e vështirësisë për secilin zë të përshkruar në paragrafin 5, më sipër, duhet të vlerësohet me 1 deri në 5 pikë. Shuma e tyre do të caktojë grupin tarifor, që i përket.

7. Në bazë të sistemit të pikëzimit të përshkruar në pikën 7, më poshtë bëhet kategorizimi i shërbimit për planifikimin e përgjithsëm vendor në një nga grupet tarifore më poshtë:

- | | |
|--------------------------|-----------------|
| i) Grupi I Tarifor : | deri në 9 pikë, |
| ii) Grupi II Tarifor : | 10-14 pikë, |
| iii) Grupi III Tarifor : | 15-19 pikë, |
| iv) Grupi IV Tarifor : | 20-24 pikë, |
| v) Grupi V Tarifor : | 25-30 pikë. |

NJËSTITË E LLOGARITJES	GRUPI TARIFOR I		GRUPI TARIFOR II		GRUPI TARIFOR III		GRUPI TARIFOR IV		GRUPI TARIFOR V		
	nga LEKË	deri LEKË	nga LEKË	deri LEKË	nga LEKË	deri LEKË	nga LEKË	deri LEKË	nga LEKË	deri LEKË	
5,000	145740	163660	163660	182700	182700	200760	200760	200760	219800	219800	237720
10,000	292180	328300	328300	364560	364560	401660	401660	401660	437780	437780	474040
20,000	466900	525140	525140	583520	583520	642460	642460	642460	700700	700700	759080
40,000	817320	919660	919660	1022140	1022140	1123640	1123640	1123640	1225980	1225980	1328320
60,000	1109360	1247960	1247960	1386560	1386560	1524460	1524460	1524460	1662920	1662920	1801520
80,000	1370040	1541680	1541680	1712620	1712620	1884260	1884260	1884260	2055200	2055200	2226700
100,000	1594460	1793680	1793680	1993740	1993740	2192820	2192820	2192820	2392880	2392880	2592100
150,000	2100700	2363760	2363760	2625980	2625980	2888900	2888900	2888900	3151120	3151120	3414180
200,000	2529100	2845640	2845640	3161340	3161340	3477880	3477880	3477880	3793580	3793580	4110120
250,000	2918020	3282720	3282720	3647980	3647980	4012540	4012540	4012540	4377940	4377940	4742500
300,000	3326680	3742480	3742480	4158140	4158140	4573940	4573940	4573940	4989740	4989740	5405400
350,000	3744860	4213300	4213300	4681040	4681040	5149480	5149480	5149480	5617360	5617360	6085800
400,000	4046420	4551960	4551960	5057360	5057360	5563740	5563740	5563740	6069140	6069140	6574680
450,000	4288900	4825100	4825100	5361300	5361300	5898340	5898340	5898340	6434540	6434540	6970880
500,000	4570720	5142340	5142340	5713960	5713960	6284880	6284880	6284880	6856500	6856500	7428260
600,000	5018860	5646480	5646480	6273960	6273960	6900740	6900740	6900740	7528360	7528360	8155840
700,000	5311040	5973380	5973380	6638520	6638520	7302960	7302960	7302960	7966840	7966840	8630580
800,000	5603080	6303080	6303080	7002940	7002940	7703920	7703920	7703920	8403780	8403780	9103920
900,000	5777100	6499080	6499080	7222040	7222040	7943880	7943880	7943880	8666840	8666840	9388820
1,000,000	6030640	6784120	6784120	7538440	7538440	8291920	8291920	8291920	9046240	9046240	9799860
1,500,000	6710900	7549500	7549500	8388800	8388800	9227400	9227400	9227400	10066840	10066840	10905300
2,000,000	7002940	7878640	7878640	8754200	8754200	9629060	9629060	9629060	10644480	10644480	11380180
3,000,000	7586460	8534540	8534540	9483320	9483320	10431400	10431400	10431400	11380180	11380180	12328120
6,000,000	8800294	9900066	9900066	11000651	11000651	12100424	12100424	12100424	13201009	13201009	14300619
12,000,000	10296344	11583078	11583078	12870762	12870762	14157496	14157496	14157496	15445180	15445180	16731724
24,000,000	12149685	13668032	13668032	15187499	15187499	16705845	16705845	16705845	18225313	18225313	19743435

Tabela. 2 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 19, paragrafi 1 - Planet e Përgjithshme Vendore.

Neni 20

Planifikimi i detajuar vendor, sipas fazave

1. Shërbimet, në lidhje me planifikimin e detajuar vendor, janë përmbledhur në pesë faza të shërbimit dhe vlerësohen në përputhje me përqindjet mbi vlerën e tarifës, së përcaktuar në nenin 21. Fazat e shërbimit dhe përqindjet përkatëse, jepen në tabelën më poshtë:

Nr.	Fazat e shërbimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e I	Hartimi i nismës për fillimin e PDV dhe miratimi në instancat përkatëse	2.5%
2	Faza e II	Përgatitja e analizës së thelluar	30%
3	Faza e III	Hartimi i planit paraprak	25%
4	Faza e IV	Hartimi i planit përfundimtar	40%
5	Faza e V	Projekti përfundimtar për miratim	2.5%

Tabela 3 Tabela e përqindjes së tarifimit sipas fazave të shërbimit- Planet e Detajuara Vendore

2. Përmbajtja për secilën fazë do të respektojë rregulloret e planifikimit të legjisalcionit përkatës.

Neni 21

Tabela e tarifave për shërbimet, në lidhje me planet e detajuara vendore

1. Vlerat e tarifave maksimale e minimale për shërbimet, në lidhje me planet e detajuara vendore, të listuara në nenin 20, bazohen në zonën e mbuluar nga plani në hektarë dhe janë të specifikuar në tabelën në vijim.
2. Tarifat janë llogaritur në bazë të madhësisë së zonës së mbuluar nga plani, në propozimin paraprak të planifikimit. Nëse zona e mbuluar nga plani është ndryshuar nga rrjedha e procedurave formale, atëherë tarifat për këto faza të shërbimit nuk kryhen, në rastet kur kërkohen ndryshime të madhësisë së zonës së planifikimit, tarifa duhet të llogaritet në bazë të madhësisë së shtuar.
3. Ndarja në grupet tarifore përcaktohet në bazë të kriterëve të mëposhtme të vlerësimit për kërkesat e projektimit:

- i) Kushtet topografike dhe situata gjeologjike;
 - ii) Kërkesat mjedisore dhe kërkesat ndaj strukturës urbane, mbrojtja ndaj monumenteve;
 - iii) Përdorimi dhe dendësia;
 - iv) Shkalla e kërkuar e cilësisë për procesin e planifikim/projektimit;
 - v) Lidhja me infrastrukturen ekzistuese;
 - vi) Mbrojtja e mjedisit dhe kushtet ekologjike.
4. Kur kriteret e vlerësimit i përkasin grupeve tarifore të ndryshme, duke ngritur dyshime mbi grupin tarifor, në të cilin duhet të futet Plani i Detajuar Vendor për territorin, atëherë duhet të bëhet vlerësimi me sistemin e pikëzimit, në bazë të paragrafit 5, më poshtë dhe në varësi të shumës së pikëve, kategorizohet në një nga grupet tarifore më poshtë:
- i) Grupi I Tarifor : deri në 10 pikë;
 - ii) Grupi II Tarifor : 10-20 pikë;
 - iii) Grupi III Tarifor : 21-30 pikë.
5. Gjatë përlllogaritjes së grupit tarifor, për hartimin e Planeve të Detajuara Vendore, shkalla e vështirësisë për secilin zë të përshkruar në paragrafin 1, më sipër, duhet të vlerësohet me 1 deri në 5 pikë. Shuma e tyre do të caktojë grupin tarifor, që i përket.

TABELA SHOQËRUESE E TARIFAVE NENI 21 PARAGRAFI 1 -PLANET E DETAJUARA VENDORE						
SIPERFAQE NË HEKTARË	GRUPI TARIFOR I		GRUPI TARIFOR II		GRUPI TARIFOR III	
	nga	deri	nga	deri	nga	deri
	LEKË		LEKË		LEKË	
0.5	33040	111440	111440	246120	246120	380660
1	66780	203490	203490	438620	438620	673960
2	132650	354760	354760	735840	735840	1116500
3	198800	492520	492520	996100	996100	1499960
4	265370	616910	616910	1219330	1219330	1821610
5	331520	740530	740530	1442140	1442140	2143680
6	398020	848400	848400	1620850	1620850	2393230
7	456680	942480	942480	1775130	1775130	2608200
8	500430	1025150	1025150	1925140	1925140	2825130
9	544460	1105090	1105090	2066120	2066120	3026730
10	588210	1184260	1184260	2206260	2206260	3228680
11	631470	1260630	1260630	2338980	2338980	3417260
12	675570	1331470	1331470	2455810	2455810	3580640
13	719670	1402310	1402310	2572780	2572780	3743670
14	758240	1477560	1477560	2710540	2710540	3943660
15	794500	1554700	1554700	2858240	2858240	4162130
16	831040	1632610	1632610	3006640	3006640	4380250
17	867720	1710240	1710240	3154340	3154340	4597950
18	904260	1787800	1787800	3302320	3302320	4816910
19	940940	1865360	1865360	3450020	3450020	5034960
20	977130	1942850	1942850	3598000	3598000	5253080
21	1013810	2016490	2016490	3735760	3735760	5455450
22	1050350	2090970	2090970	3874710	3874710	5658170
23	1085770	2164190	2164190	4012540	4012540	5861310
24	1122450	2238180	2238180	4151140	4151140	6063680
25	1159830	2312940	2312940	4290090	4290090	6266820
30	1315720	2669310	2669310	4990090	4990090	7310520
35	1457470	3012170	3012170	5677420	5677420	8343160
40	1600340	3344390	3344390	6334580	6334580	9325120
45	1742930	3658970	3658970	6943650	6943650	10227840
50	1885800	3962140	3962140	7521500	7521500	11080510
60	2108680	4486930	4486930	8564010	8564010	12640810
70	2302720	4944380	4944380	9472680	9472680	14000980
80	2493260	5399170	5399170	10380160	10380160	15361220
90	2674000	5855360	5855360	11309270	11309270	16762760
100	2851520	6331780	6331780	12298230	12298230	18264680

Tabela. 4 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 21, paragrafi 1 – Planet e Detajuara Vendore.

Neni 22

Shërbimet e veçanta për tipologjitë e shërbimit të planifikimit

1. Planifikimi i përgjithshëm vendor mund të përfshijë shërbimet e veçanta të mëposhtme:
 - i. Hartimi i nismës për fillimin e PPV dhe miratimi në instancat përkatëse
 - a) Planifikimi i specifikimeve të projektit;
 - ii. Përgatitja e analizës së thelluar
 - a) Modele terreni;
 - b) Punime gjeodezike në objekt;
 - c) Përditësimi i hartave;
 - ç) Prodhimi i hartave të gjendjes në terren me cilësi të lartë për shumëfishim;
 - d) Zhvillimi i një dokumentacioni bazë të projektit nga harta, të burimeve të ndryshme;
 - dh) Analiza e fotove ajrore;
 - e) Pyetësorë për të marrë statistika kryesore përfshirë këtu dhe analizën e materialeve dytësore;
 - ë) Survejime statistikore lokale, si dhe identifikimin e nevojave si atyre të furnizimit, ekonomike, sociale, infrastrukturës së strehimit, strukturave kulturore dhe sociale, aty ku nuk janë të përfshira në shërbimet bazë, transportit publik, mobilitetit, trafikut dhe sinjalistikës. Kërkime të detajuara për përdorimet aktuale.
 - iii. Hartimi i planit paraprak
 - a) Hartimi i "Dokumentit të Politikave".
 - b) Hartimi i Profilit të Njesisë së Qeverisjes Vendore ku përfshihen: profili social, demografik, ekonomik, mjedisor, topografik, fizik, urban, mobilitetit;
 - c) Hartimi i Analizës S.W.O.T, ku përcaktohen pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet me të cilat përballet NJ.Q.V.;
 - ç) Hartimi i Vizionit për Zhvillimin e Territorit dhe objektivave strategjike në mbështetje të vizionit;
 - d) Hartimi i Programeve dhe Politikave në Mbështetje të objektivave strategjike;
 - dh) Hartimi i Planit të veprimit për realizimin e vizionit dhe objektivave strategjike për zhvillimin e territorit.

Këshillohet që Dokumenti i politikave të hartohet nga vetë Nj.Q.V. Në rastin e pamundësisë ose për pamjaftueshmërinë e burimeve njerëzore në Njësinë e Qeverisjes Vendore ose Qendrore, ky shërbim mund të porositet, por në asnjë rast nuk duhet të konsiderohet si një shërbim, i cili mund të kryhet në mënyrë krejtësisht të pavarur nga grupi i NJ.Q.V. Grupi i NJ.Q.V. duhet të bashkëpunojë me grupin e ofruesve të shërbimit, që në këtë rast janë planifikuesit urbanë.

- a) Asistimi i klientit në marrëdhëniet me publikun, përfshirë këtu broshurat informative, diskutime me publikun si dhe përpilimi i dokumenteve të nevojshme narrative dhe grafike;
- b) Prodhi i axhendave të mbledhjeve, dokumentet dhe raportet;
- c) Përgjegjësi për përfshirjen e autoriteteve dhe institucioneve publike, që mund të jenë ndikuar nga plani.

iv. Hartimi i planit përfundimtar

- a) Prodhi i planeve ndihmës, si ato për trafikun dhe sinjalistika, strukturat infrastrukturore, riparcelizimi, planet për shtigjet dhe lëvizjen e ujërave, hartat e pronësisë dhe harta për kriteret e cilësisë, duke marrë parasysh planet e prodhuara nga specialistë të tjerë në ekipin e planifikimit; Planet e mobilitetit urban (Plani Urban i Trafikut & Sinjalistikës(PUT&S), Planet e Mobilitetit (PM) dhe Transporti Publik Urban(TPU)).
- b) Ndryshime kryesore, ose rishikim total të planeve pas ndërtimit, sidomos kur këto hartohen në përgjigje të kritikave apo sugjerimeve;
- c) Përgatitja e dokumenteve këshilluese për autoritetet lokale në përgjigje të kritikave dhe sugjerimeve;
- ç) Përmbledhje e detajuar për shfrytëzim.

v. Hartimi i rregullores

vi. Projekti përfundimtar për miratim

- a) Shërbime për printim;
- b) Prodhi i kopjeve shtesë me ngjyra, të planeve të zonimit (Plani i përdorimit të tokës i propozuar, plani për zhvillimin e infrastrukturës dhe fazat e zbatimit);
- c) Rishikimi i vizatimeve dhe raporteve shpjeguese pas aprovimit.

2. Planifikimi i detajuar vendor mund të përfshijë shërbimet e veçanta të mëposhtme:

- i. Hartimi i nismës për fillimin e PDV dhe miratimi në instancat përkatëse
 - a) Identifikimi i natyrës dhe shkallës së çdo kërkimi shtesë që mund të nevojitet, veçanërisht për rastet e zonave që kanë shkallë të lartë urbanizimi dhe zhvillimi;
 - b) Kthim përgjigjeje për çdo propozim individual, hasur gjatë përgatitjes së planit.
- ii. Përgatitja e analizës së thelluar
 - a) Mbledhja e të dhënave gjeodezike;
 - b) Pyetësorët fillestarë (pyetësorë, aprovimi i projektit);
 - c) Hetimet shtesë, aty ku nuk ekziston planifikim zonal;

- ç) Ofrimi i ndihmës për identifikimin e mundësive të financimit nga burime publike;
 - d) Analiza vizuale e qytetit.
- iii. Hartimi i planit paraprak
- a) Prodhimi i maketeve.
- iv. Hartimi i planit përfundimtar
- a) Vlerësimi dhe prezantimi i masave për mbrojtjen e mjedisit.
- v. Projekti përfundimtar për miratim.
- a) Prodhimi i kopjeve me ngjyrë shtesë të Planit të Detajuar Vendor

KREU III PLANIFIKIMI I OBJEKTEVE

SEKSIONI I NDËRTESTAT DHE NDARJET FUNKSIONALE TË TYRE

Neni 23

Parimet e tarifave

1. Kostot e llogaritshme janë kostot e ndërtimit për shërbimet e lidhura me ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre.
2. Në kostot e llogaritshme përfshihen edhe kostot e sistemeve (ngrohje ventilim, hidrosanitare, elektrike) edhe kur projektuesi nuk i planifikon vetë. Në këtë rast kostoja e ndërtimit llogaritet :
 - i) në vlerën e plotë, kur kostot e llogaritshme të sistemeve nuk kalojnë 15% të kostove totale të projektit;
 - ii) në 50%, kur kostot e llogaritshme të sistemit, kalojnë 15% të kostos totale të projektit.
3. Nuk përfshihen në kostot e llogaritshme, kostot për lidhjen me infrastrukturën jo-publike (individuale, p.sh lidhja me një pus uji, që e shpon vetë investitori), pajisja me vepra arti, vepra, të cilat projektuesi nuk i projekton, ose nuk mbikëqyr teknikisht instalimin e tyre.

Neni 24

Fazat e projektimit të ndërtesave dhe ndarjet funksionale të tyre sipas tipologjisë

Tipologjia e shërbimit për punimet e ndërtesave dhe punimeve të brendshme përfshin shërbimet, që lidhen me ndërtesa të reja, objekte të reja, rindërtim, zgjerim, ndryshim destinacioni, punimet e modernizimit, shtesat e punimeve të brendshme, mirëmbajtje

dhe riparime. Shërbimet janë përmbledhur në nëntë faza dhe vlerësohen në përputhje me përqindjet e tarifave në nenin 25, si më poshtë:

Nr.	Faza e projektimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e I	Analiza e detyrës së projektimit / përcaktimi i bazës së projektit	3% për ndërtesat 3% për ndarjet funksionale
2	Faza e II	Projektideja paraprake	7% për ndërtesat 7% për ndarjet funksionale
3	Faza e III	Projektideja përfundimtare	11% për ndërtesat 14% për ndarjet funksionale
4	Faza e IV	Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit	6% për ndërtesat 2% për ndarjet funksionale
5	Faza e V	Projekti i zbatimit	32% për ndërtesat 30% për ndarjet funksionale
6	Faza e VI	Preventivi përfundimtar	10% për ndërtesat 7% për ndarjet funksionale
7	Faza e VII	Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi	3% për ndërtesat 3% për ndarjet funksionale
8	Faza e VIII	Mbikëqyrja	25% për ndërtesat 31% për ndarjet funksionale
9	Faza e IX	Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar për kolaudim	3% për ndërtesat 3% për ndarjet funksionale

Tabela. 5 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 24 – Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre.

Neni 25

Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre sipas tipologjisë, si dhe strukturat në ambientet e jashtme sipas tipologjisë së shërbimit

1. Faza I: Analiza e detyrës së projektimit/termave te referencës dhe përcaktimi i

- i) Shërbimet bazë
 - a) Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit/termave të referencës;
 - b) Dhënia e konsultave mbi nevojën dhe shkallët e shërbimit;
 - c) Formulimi i kërkesave për përzgjedhjen e specialistëve të tjerë të domosdoshëm në procesin e projektimit;
 - ç) Përmbledhja e rezultateve.
- ii) Shërbimeve të veçanta:
 - a) Studimi i gjendjes
 - b) Analiza e vend ndodhjes
 - c) Planifikimi i punës
 - ç) Hartimi i një programi hapësinor
 - d) Hartimi i një programi funksionimi
 - dh) Verifikimi i rëndësisë së mjedisit
 - e) Verifikimi i pajtueshmërisë me mjedisin

2. Faza II: Projektideja paraprake (përgatitja e projektit dhe ecurisë projektuese)

- i) Shërbimi bazë
 - a) Analiza e e bazës materiale dhe e parimeve;
 - b) Dakordësimi mbi objektivat (kushtet përreth objektivit, konfliktet eventuale për arritjen e objektivit);
 - c) Përgatitja e një katalogu/liste të planeve, që detajon qëllimet e projektit (objektivat e programit);
 - ç) Zhvillimi i një plani konceptual duke përfshirë edhe alternativa të tjera të mundshme që i përgjigjen kushteve dhe kërkesave të projektit me vizatime dhe skica, vlerësimi i tyre, zëvendësimi i vizatimeve eksperimentale me vizatime të lira, me shënime përkatëse kur është e mundshme;
 - d) Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera të ofruara nga specialistë e pjesëmarës në projekt;
 - dh) Qartësimi dhe shpjegimi i rolit të objektit në planin e qytetit, nën aspektin e ndërthurjes dhe ndërveprimit të aspekteve funksionale, në gjendjen fizike dhe teknike, në efikasitetin financiar dhe energjitik (p.sh. koston efektive të energjisë, strategjinë e përdorimit të energjisë dhe përdorimin e burimeve energjitike të rinovueshme) dhe në faktorët e mjedisit ose faktorët ekologjikë, proceset dhe kushtet, si dhe barrën imponuese ekosistemet përkatëse dhe ndjeshmërinë e tyre;

- e) Negociatat paraprake me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt për testimin e mundësisë së marrjes së lejes së ndërtimit të objektit;
- ë) Në projektimin e ambienteve të jashtme: mbledhja, vlerësimi dhe shpjegimi i të dhënave në lidhje me strukturën ekologjike dhe në marrëdhënie me elemente si psh. toka, uji, klima, ajri, flora dhe fauna, plus paraqitja e shfrytëzimit të hapësirës dhe përcaktimi i strategjisë me shpjegime informuese veçanërisht në lidhje me peizazhin, përmirësimin e zonës së banuar dhe ndërlidhjet, me bimësinë ekzistuese, mbjellje të reja, duke ndarë zonën e gjelbërimit, trafikun, ujin, zonat e lojrave dhe zonat sportive, gjithashtu qartësimi dhe pranimi i kufirit të projektit dhe harmonizimin me objektet rrethuese;
- f) Parashikimi i kostove;
- g) Mbledhja e përfundimeve e të gjitha aktiviteteve paraprake të projektit;
 - ii) Shërbimet e veçanta
 - a) Kërkimi për mundësi zgjidhjesh sipas kërkesave principialisht të kundërta;
 - b) Plotësim i dokumenteve të planifikimit paraprak mbi bazën e kërkesave të veçanta;
 - c) Hartimi i një plani financimi;
 - ç) Hartimi i një analize objekti- funksionimit, shpenzimeve dhe dobia;
 - d) Bashkëveprim gjatë gjetjes së kredisë;
- dh) Kryerja e kërkesës paraprake (kërkesë për ndërtim);
 - e) Përgatitja e paraqitjeve të veçanta teknike, si p.sh. perspektiva, mostra, modele;
 - ë) Hartimi i një plani kohor dhe organizimi.
 - f) Plotësimi i dokumenteve të planifikimit paraprak në lidhje me masa të veçanta për optimizimin e ndërtesës dhe pjesëve të ndërtimit, të cilat e tejkalojnë masën e zakonshme të punimeve të planifikimit, për pakësimin e shpenzimit të energjisë si dhe të emisioneve me lëndë të dëmshme dhe emisioneve të CO₂ dhe për shfrytëzimin e energjive të rinovueshme në marrëveshje me pjesëmarrës të tjerë specialistë në planifikim. Masa e zakonshme është dhënë për masa për kursimin e energjisë nëpërmjet plotësimit të kërkesave, të cilat dalin nga dispozitat ligjore dhe rregullat e njohura në përgjithësi.

3. Faza III: Projekt-ideja përfundimtare (sistemet dhe planifikimi i integruar).

- i) Shërbimi bazë
 - a) Përpunimi i konceptit të projektit (përpunim hap pas hapi i alternativave të përzgjedhura të ndërtimit me vizatime) duke marrë parasysh planin e

qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efikasitetin financiar dhe energjitike (p.sh. efikasitetin e energjisë, përdorimi i burimeve energjitike të rinovueshme) dhe kërkesat mjedisore ose të zhvillimit të qëndrueshëm duke vënë në përdorim ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, dhe kompletimin e projektidesë përfundimtare.

- b) Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera, të ofruara nga specialistë e pjesëmarrës në projekt.
- c) Përshkrimi i projektit, me shpjegime për masat që do të ndërmerren për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe vlerave të tjera të kësaj natyre, duke përfshirë edhe masat për zëvendësimin, sipas legjislacionit në fuqi.
- ç) Përmbledhja e të gjithë projektit në formën e vizatimit p.sh. projektidesë paraprake dhe/ose projektidesë përfundimtare (shkalla sipas natyrës dhe madhësisë së strukturës. Për sipërfaqet e hapura paraqitja të jetë në shkallë 1:500 deri në 1:100, veçanërisht me informacione për përmirësimin e mjedisit, masat që do të ndërmerren, masat për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe për mbjelljen e diferencuar të gjelbërimit. Për ndërtesat në shkallë 1:50 deri 1:20, veçanërisht me detaje të mureve ndarëse, ngjyra, drita dhe materiale, në rast të veçantë edhe me plane të detajuara për grupet hapësinore.
- d) Negociatat për mundësinë e marrjes së lejes së ndërtimit me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt.
- dh) Parashikim i kostove sipas manualit të çmimeve, të miratuar me akte nën ligjore, që përcaktojnë kostot në zonat e banimit ose kërkesave cilësore të investitorit.
- e) Kontrolli i kostove, duke krahasuar llogaritjen e kostos me koston paraprake.
- ë) Përmbledhja e rezultateve të të gjithë dokumentacioneve të projektit.

ii) Shërbimet e veçanta

- a) Analizë e alternativave/variantëve dhe vlerësim me studim të shpenzimeve (optimim).
- b) Llogaritja e rentabilitetit.
- c) Llogaritja e shpenzimeve duke bërë listën e sasive të pajisjeve ose katalogut të elementeve të ndërtimit.
- ç) Përpunimi i masave të veçanta për optimizimin e ndërtesës dhe pjesëve të ndërtimit, të cilat e tejkalojnë masën e zakonshme të punimeve të planifikimit, për pakësimin e shpenzimit të energjisë si dhe të emisioneve me lëndë të dëmshme dhe emisioneve të CO₂ dhe për shfrytëzimin e energjive të rinovueshme në marrëveshje me pjesëmarrës të tjerë specialistë në planifikim. Masa e zakonshme është dhënë për masa për kursimin e energjisë nëpërmjet plotësimit të kërkesave, të cilat dalin nga dispozitat

ligjore dhe rregullat e njohura në përgjithësi.

4. Faza IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

i) Shërbimi bazë:

- a) Përgatitja e dokumenteve të dorëzimit për miratim dhe lejet e kërkuara, në bazë të rregullores për planifikimin urban, duke përfshirë edhe kërkesat për përjashtime dhe ngrirje/shtyrje kushtesh, duke përdorur ndihmesën e ofruar nga specialistët e tjerë të përfshirë në projekt si edhe ndonjë negociim me autoritetet publike.
- b) Dorëzimi i dokumenteve në entin publik.
- c) Përfundimi dhe plotësimi nëse është e nevojshme i kërkesës së projektit, përshkrimet dhe shpenzimet duke përdorur ndihmesën e specialistëve të përfshirë në projekt.
- c) Sistemimet e jashtme dhe punimet e ndërtimit: Kontrollimi i kërkesave dhe lejeve të veçanta që duhen për miratimin e kërkesës dhe për marrjen e lejes të ndërtimit.

ii) Shërbime të veçanta:

- a) Bashkëveprim për sigurimin e aprovimit të fqinjëve.
- b) Përpunimi i dokumenteve për procedura të veçanta kontrolli.
- c) Mbështetje profesionale dhe organizative e ndërtuesit në procese kundërshtimi, procese gjyqësore ose të ngjashme.
- c) Ndryshimi i dokumenteve të miratimit si rezultat rrethanash, për të cilat nuk përgjigjet porosimarrësi.

5 Faza V: Projekti i zbatimit

i) Shërbimet bazë:

- a) Përpunim dhe detajim i punës së bërë në fazat 3 dhe 4 (zhvillimi dhe paraqitja hap pas hapi e projektit të zgjidhur) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efikasitetin financiar dhe energjitike (p.sh. efikasiteti i energjisë, përdorimi i burimeve energjitike të rinovueshme) dhe kërkesat e mjedisit ose të konservimit duke përdorur edhe ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, nëpërmjet një projekti (vizatimi) të zbatueshëm.
- b) Paraqitja e projektit në formë grafike me të gjitha detajet e nevojshme për zbatim p.sh. zbatimi i plotë përfundimtar, vizatime të detajuara të konstrukcionit në një shkallë 1:50 deri 1:1, për strukturat në ambientet e jashtme në varësi të tipit të ndërtesës, në një shkallë 1:200 deri në 1:50, veçanërisht për bimësinë, shoqëruar me relacionin përkatës.
- c) Për ndërtesa: paraqitje e hollësishme e dhomave dhe apartamenteve në shkallë 1:25 deri 1:1 me përshkrimin, përcaktimin e materialeve.

- c) Përgatitja e bazës, për specialistët e tjerë të përfshirë në projekt dhe përfshirja e tyre në fazën e zbatimit.
 - d) Azhornimi i vazhdueshëm i projektit zbatues gjatë fazës së zbatimit.
- ii) Shërbimet e veçanta:
- a) Hartimi i një përshkrimi të detajuar të objektit si libër ndërtimi për bazë të përshkrimit të shërbimeve me program të punimeve¹.
 - b) Hartimi i një përshkrimi të detajuar të objektit si libër hapësire si bazë të përshkrimit të shërbimeve me program të punimeve¹.
 - c) Kontrolli i përputhjes së planeve të zbatimit të përpunuara nga sipërmarrja zbatuese në bazë të përshkrimit të shërbimit me program shërbimi me planifikimin e projektit paraprak¹.
 - ç) Punimi i modeleve të detajuara.
 - d) Kontrolli dhe pranimi i planeve të të tretëve , që profesionalisht nuk marrin pjesë në planifikim, për përputhjen me planet e zbatimit (p.sh. vizatimet e studiove nga sipërmarrjet, planet e vendosjes së themeleve dhe bazamentit nga livruesit e makinerive), përderisa punët kanë të bëjnë me komplekse, që nuk janë përfshirë në shpenzimet e llogaritshme.

6. Faza VI: Preventivi përfundimtar

i) Shërbimet bazë:

- a) Përcaktimi dhe mbledhja e masave për të prodhuar specifikimet e projektit duke përdorur kontributet e dhëna nga specialistët e tjerë të përfshirë në projekt.
- b) Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndarë sipas kategorive dhe zërave të punës.
- c) Harmonizimi dhe koordinimi i kategorive të punës së projektit të bëra nga specialistët e përfshirë në planifikimin e projektit.

7. Faza VII shërbimit: Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi

i) Shërbimet bazë:

- a) Përmbledhja e dokumenteve të dhënies për të gjitha fushat e punës.
- b) Verifikimi dhe vlerësimi i termave të referencës përfshirë hartimin e dokumentacionit për prokurim.
- c) Akordimi dhe përmbledhja e punimeve të atyre që marrin pjesë profesionalisht, të cilët bashkëpunojnë gjatë dhënies së dokumentave.
- ç) Llogaritja e shpenzimeve.
- d) Bashkëveprim gjatë dhënies së ofertës.

¹ Ky shërbim i veçantë tek përshkrimi i shërbimit me program shërbimi bëhet pjesërisht ose tërësisht

ii) Shërbimet e veçanta:

- a) Kontrolli i vlerave të ofertave nga përshkrimi i shërbimeve me program të shërbimeve përfshirë pasqyrën e çmimeve. ¹⁾
- b) Hartimi, kontrolli dhe vlerësimi i pasqyrave të çmimeve sipas kërkesave të veçanta.

8. Faza VIII: Mbikëqyrja e punimeve

i) Shërbimet bazë:

- a) Vëzhgimi i realizimit të objektit në përputhshmëri me lejet dhe miratimet e ndërtimit, zbatimin e vizatimeve dhe veçantitë e projektit me standartet teknike të pranuar dhe me rregullat në fuqi.
- b) Mbikëqyrje e fazës së realizimit të strukturave mbajtëse të përcaktuara në nenin 40, pika 2, nënpika i) dhe ii) për përputhshmëri me provën e qëndrueshmërisë.
- c) Koordinimi i aktivitetit të specialistëve të përfshirë në mbikëqyrjen e projektit.
- ç) Vëzhgimi dhe korrigjimi i detajeve të elementeve të parapërgatitur (parafabrikeve).
- d) Përgatitja dhe ndjekja e një plani dinamik/program pune (grafikë me kolona).
- dh) Mbajtja e ditarit të kantierit.
- e) Kryerja e matjeve në kantier në bashkëpunim me kontraktorin ndërtues.
- ë) Miratimi dhe pranimi i fazave të punimeve të ndërtimit me përfshirjen e specialistëve të tjerë pjesëmarrës si në planifikim edhe në mbikëqyrje, identifikimi i defekteve.
- f) Kontrolli i faturave dhe i kontabilitetit.
- g) Kontrolli dhe përlllogaritja e kostos përfundimtare reale.
- gj) Bërja e kërkesës për aprovimin (lejet e ndyshme ligjërish të përcaktuara) nga ana e enteve publike dhe pjesëmarrje në kolaudime.
- h) Dorëzimi i objektit duke përfshirë dorëzimin dhe përmbledhjen e të gjithë dokumenteve të nevojshme p.sh. udhëzimet e përdorimit të paisjeve, raportet e provave, etj.
- i) Listimi i periudhave të garancive për riparime të detyrueshme nga kontraktorët.
- j) Kontrolli i veprimeve korrigjuese në rast konstatimi të defekteve të zbuluara gjatë periudhës së garancisë kontraktuale dhe në asnjë rast jo më shumë se dy vjet pas dorëzimit të objektit.
- k) Kontrolli dhe raporti i kostos përfundimtare të objektit duke krahasuar

faturat e ndërtuesve me çmimet e kontratave dhe me parashikimin e shpenzimeve (preventivin).

ii) Shërbimet e veçanta:

- a) Hartimi, mbikëqyrja dhe vazhdimi i shkrimit të planit të pagesave.
- b) Hartimi, mbikëqyrja dhe vazhdimi i shkrimit të planeve të diferencuara të kohës, shpenzimeve ose kapaciteteve.

9. Faza IX: Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar, mbikëqyrja përfundimtare për kolaudim

i) Shërbimet bazë:

- a) Kontroll në objekt, verifikimi i të metave eventuale të konstatuara brenda afatit të garancisë dhe jo më vonë se dy vite pas marrjes në dorëzim të punimeve.
- b) Mbikëqyrje të veprimeve korigjuese të defekteve që u dalluan para skadimit të afateve të garancive kontraktuale ose të paktën në dy vitet e para pas pranimit të punimeve të ndërtimit.
- c) Ndihma me detyrimet e sigurisë dhe të garancive.
- ç) Mbledhje e vazhdueshme e vizatimeve dhe llogaritjeve që tregojnë rezultatet përfundimtare të projektit.

ii) Shërbimet e veçanta:

- a) Përgatitja e planeve për gjendjen;
- b) Hartimi i listave për pajisjet dhe inventarin;
- c) Përgatitja e udhëzimeve për mirëmbajtjen dhe kujdesin;
- ç) Kontrolli i objektit;
- d) Administrimi i dokumentacionit dhe i objektit;
- dh) Këqyrja në vend me këmbë pas dorëzimit;
- e) Mbikëqyrja e punimeve të mirëmbajtjes;
- ë) Llogaritja dhe konstatimi i shpenzimeve për ritarifimin;
- f) Verifikimi i analizës së objektit dhe analizës funksionimit, shpenzimeve dhe defekteve.

Neni 26

Tabela e tarifave për shërbimet lidhur me ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre

1. Tabela e mëposhtme specifikon vlerat e tarifave minimale dhe maksimale për shërbimet në lidhje me ndërtesat dhe shtesat e punimeve të brendshme të listuara në nenin 24:

KOSTO E LLOGARITSHME LEIKE	GRUPI TARIFOR I		GRUPI TARIFOR II		GRUPI TARIFOR III		GRUPI TARIFOR IV		GRUPI TARIFOR V	
	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %
3,579,240	3.14	3.82	3.82	4.74	4.74	6.11	6.11	6.11	7.03	7.71
4,200,000	3.14	3.82	3.82	4.72	4.72	6.08	6.08	6.08	6.98	7.66
4,900,000	3.15	3.82	3.82	4.72	4.72	6.06	6.06	6.06	6.96	7.63
5,600,000	3.14	3.81	3.81	4.71	4.71	6.05	6.05	6.05	6.94	7.61
6,300,000	3.15	3.81	3.81	4.70	4.70	6.04	6.04	6.04	6.92	7.59
7,000,000	3.15	3.81	3.81	4.68	4.68	6.01	6.01	6.01	6.89	7.55
14,000,000	3.14	3.76	3.76	4.58	4.58	5.82	5.82	5.82	6.64	7.26
21,000,000	3.14	3.72	3.72	4.48	4.48	5.62	5.62	5.62	6.39	6.96
28,000,000	3.14	3.67	3.67	4.37	4.37	5.43	5.43	5.43	6.13	6.66
35,000,000	3.14	3.63	3.63	4.28	4.28	5.25	5.25	5.25	5.90	6.38
42,000,000	3.04	3.51	3.51	4.14	4.14	5.09	5.09	5.09	5.72	6.19
49,000,000	2.90	3.37	3.37	4.00	4.00	4.94	4.94	4.94	5.57	6.04
56,000,000	2.76	3.23	3.23	3.86	3.86	4.81	4.81	4.81	5.43	5.91
63,000,000	2.62	3.10	3.10	3.72	3.72	4.67	4.67	4.67	5.30	5.77
70,000,000	2.49	2.96	2.96	3.59	3.59	4.53	4.53	4.53	5.16	5.63
140,000,000	2.24	2.66	2.66	3.21	3.21	4.04	4.04	4.04	4.59	5.01
210,000,000	2.17	2.56	2.56	3.09	3.09	3.88	3.88	3.88	4.41	4.80
280,000,000	2.13	2.51	2.51	3.03	3.03	3.80	3.80	3.80	4.31	4.70
350,000,000	2.10	2.48	2.48	2.99	2.99	3.75	3.75	3.75	4.26	4.64
420,000,000	2.10	2.46	2.46	2.94	2.94	3.66	3.66	3.66	4.13	4.49
490,000,000	2.10	2.44	2.44	2.90	2.90	3.58	3.58	3.58	4.04	4.38
560,000,000	2.10	2.43	2.43	2.87	2.87	3.52	3.52	3.52	3.96	4.29
630,000,000	2.10	2.42	2.42	2.84	2.84	3.48	3.48	3.48	3.90	4.22
700,000,000	2.10	2.41	2.41	2.83	2.83	3.45	3.45	3.45	3.86	4.17
1,400,000,000	2.10	2.39	2.39	2.77	2.77	3.35	3.35	3.35	3.73	4.02
2,100,000,000	2.10	2.37	2.37	2.73	2.73	3.26	3.26	3.26	3.61	3.88
2,800,000,000	2.10	2.35	2.35	2.68	2.68	3.17	3.17	3.17	3.50	3.74
3,500,000,000	2.10	2.34	2.34	2.65	2.65	3.12	3.12	3.12	3.43	3.67
3,579,043,160	2.10	2.34	2.34	2.65	2.65	3.12	3.12	3.12	3.43	3.66

Tabela. 6 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 25 – Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre sipas tipologjisë, si dhe strukturat në ambientet e jashtme sipas tipologjisë së shërbimit

2. Përcaktimi i grupit tarifor, të shërbimit për ndërtesat, bëhet sipas vlerësimit të shkallës së vështirësisë së kriterëve të mëposhtme:

- i) Kërkesat, lidhur me integrimin me mjedisin e përreth;
- ii) Gama e funksioneve;
- iii) Kërkesat estetike;
- iv) Kërkesat e ndërtimit;
- v) Sistemet teknike;
- vi) Punimet e brendshme.

3. Përcaktimi i grupit tarifor, të shërbimit, për shtesa dhe punime të brendshme, bëhet sipas vlerësimit të shkallës së vështirësisë së kritereve të mëposhtme:
 - i) Funkzioni;
 - ii) Kërkesat e ndriçimit;
 - iii) Kërkesat, në lidhje me ndarjen funksionale të brendshme;
 - iv) Sistemet teknike;
 - v) Kërkesat në aspektin e ngjyrës dhe të materialeve;
 - vi) Detajet konstruktive.

4. Gjatë përlllogaritjes së grupit tarifor për ndërtesat, shtesat ose punimet e brendshme, për të cilat është i paqartë përcaktimi i grupit tarifor, atëherë është e nevojshme të përdoret sistemi i pikëzimit, i përshkruar në pikën 5 në vijim, për kriteret e vlerësimit:
 - i) Grupi I tarifor:
ndërtesat dhe ndarjet funksionale të brendshme, deri në 10 pikë;
 - ii) Grupi II tarifor:
ndërtesat dhe krijimi i hapësirave dhe punimet e brendshme me 11-18 pikë;
 - iii) Grupi III tarifor:
ndërtesat dhe krijimi i hapësirave dhe punimet e brendshme me 19-26 pikë;
 - iv) Grupi IV tarifor:
ndërtesat dhe krijimi i hapësirave dhe punimet e brendshme me 27-34 pikë;
 - v) Grupi V tarifor:
ndërtesat dhe krijimi i hapësirave dhe punimet e brendshme me 35-42 pikë.

5. Për të caktuar grupin e saktë të tarifave të ndërtesave dhe ndarjen funksionale të brendshme, bëhet vlerësimi si më poshtë:
 - i) Për ndërtesat sipas paragrafit 2:

pika i) dhe iv) - vi)	deri në 6 pikë;
pika ii) dhe iii)	deri në 9 pikë secila;
 - ii) Për ndërtesat sipas paragrafit 3:

pika i) - iv),	deri në 6 pikë;
pika v) dhe vi	deri në 9 pikë secila.

Neni 27

Shërbimet për ndërtesat ekzistuese

1. Në rastin e shndërrimit të objektit ekzistues ose në rastin e modernizimeve, aplikohet një shtesë e tarifës bazë deri në 50%. Shërbimet në grupin e tarifave pësojnë një shtesë prej maksimalisht 15%.
2. Tarifat, për shërbimet në lidhje me projektet, që përfshijnë shndërrimin dhe modernizimin, siç përcaktohet nga neni 2 pika 6 dhe 7, përcaktohen duke iu referuar

shpenzimeve të përfshira, grupeve të pagesave, fazave të shërbimit dhe çmimit të caktuar në të cilin shndërimi, ose modernizimi është caktuar në përputhje me rrethanat.

Neni 28

Mirëmbajtja dhe riparimi

1. Për shërbimet e aprovuara, të mirëmbajtjes dhe riparimit, të objekteve, përqindja për mbikëqyrjen e ndërtimit rritet deri në 50%.
2. Tarifat për shërbimet, që lidhen me mirëmbajtjen dhe riparimin e projekteve, duhet të përcaktohen duke iu referuar shpenzimeve të përfshira, kategorive të pagesave, fazave të shërbimit dhe çmimit të caktuar, për të cilin mirëmbajtja dhe riparimi është caktuar në përputhje me rrethanat.

Neni 29

Grupet tarifore për ndërtesat dhe ndarjet funksionale të brendshme

1.Ndërtesat

Tipet e ndërtesave, ndahen sipas grupeve tarifore:

i. Grupi I tarifor:

Ndërtesë me kërkesa shumë të vogla planifikuese, kjo do të thotë me kërkesa shumë të vogla në lidhjen e saj me ambientin rrethues, një fushë funksionimi, kërkesa shumë të vogla përsa i përket formës, konstruksionit të thjeshtë, pa ose me zgjerim të thjeshtë, ku hyjnë:

- a) Barakat për fjetje dhe strehim dhe ndërtesa të tjera ndihmëse për përdorim të përkohshëm;
- b) Salla pushimi, salla lojrash, salla pritjeje, shëtitore të mbuluara, korridore lidhëse, salla shërbimi, plevica fushe dhe ndërtesa të tjera të thjeshta për bujqësinë;
- c) Ndërtime për tribuna, konstruksione për mbrojtje nga koha e keqe.

ii. Grupi II tarifor:

Ndërtesë me kërkesa të vogla planifikuese, kjo do të thotë me kërkesa të vogla në lidhjen e saj me ambientin rrethues, me pak fusha funksionimi, kërkesa të vogla përsa i përket formës, konstruksione të thjeshta, pajisje teknike të pakta, pa ose me zgjerim të thjeshtë, ku hyjnë:

- a) Ndërtesa banimi të thjeshta me ambiente sanitare dhe të kuzhinës të përbashkëta; Ndërtesa garazhesh, parkimi, serra;
- b) Salla dhe ndërtesa të mbyllura njëkatëshe si detyra ndërtimi më vete, ndërtesa sportesh pagese, ndërtesa varkash, punishte të thjeshta pa vinça me shina;

- c) Salla shitjeje, qendra sanitare dhe për aksidentet;
- ç) Pavione muzike.

iii. Grupi III tarifor:

Ndërtesë me kërkesa mesatare planifikuese, kjo do të thotë me kërkesa mesatare në lidhjen e saj me ambientin rrethues, me disa fusha funksionimi të thjeshta, kërkesa mesatare përsa i përket formës me konstruksione normale ose të përdorshme, pajisje teknike mesatare, me zgjerim normal mesatar ku hyjnë:

- a) Shtëpi banimi, strehime për banim dhe konvikte me pajisje mesatare;
- b) Qendra fëmijësh, kopshte fëmijësh, qendra strehimi të përbashkëta, kampe pushimi për të rinjtë, shkolla fillore;
- c) Qendra për kohën e lirë për të rinjtë, qendra për rininë, shtëpi për qytetarët, shtëpi studentësh, lokale për të moshuarit, dhe qendra të tjera përkujdesjeje;
- ç) Reparte pune për industrinë përpunuese të metalit, shtypshkronja, frigoriferë; punishte, salla të mbyllura dhe ndërtesa për bujqësinë, përderisa ato nuk përmenden në grupin e I, II dhe të IV.
- d) Ndërtesa parkimi të integruara me mënyra të tjera shrytëzimi;
- dh) Ndërtesa zyresh me pajisje mesatare, ndërtesa tregtie, qendra shitjeje, tregje dhe tregje të mëdha, salla panairesh, lokale, kantina, menca, ndërtesa për ekonominë, mbrojtje nga zjarri, qendra shpëtimi, ambulanca, qendra për përkujdesje pa pajisje mjekësore dhe teknike, spitale ndihmëse;
- e) Ndërtesa ekspozitash, ndërtesa kinemaje;
- ë) Ndërtesa gjimnastikore dhe sportive si dhe komplekse, përderisa nuk përmenden në grupin II, IV.

iv. Grupi IV tarifor:

Ndërtesë me kërkesa mbi mesatare planifikuese, kjo do të thotë me kërkesa mbi mesatare në lidhjen e saj me ambientin rrethues, me disa fusha funksionimi me marrëdhënie të shumëllojta, kërkesa mbi mesatare përsa i përket formës me kërkesa konstruktive mbi mesatare, pajisje teknike mbi mesatare, me zgjerim mbi mesatar, ku hyjnë:

- a) Shtëpi banimi me pajisje mbi mesataren, shtëpi me tarracë, shtëpi në kodër, shtëpi një familjare me punime planifikimi të brendshme përkatëse dhe grupe shtëpishë me intensitet të dendur dhe me punë projektimi mbi mesatare në troje të vogla, konvikte me pajisje tekniko-mjekësore shtesë;
- b) Punishte qendrore, fabrika birre, ndërtesa prodhimi për industrinë e makinave, ndërtesa centralesh;
- c) Shkolla, përjashto shkollat fillore, qendra arsimore, shkolla të larta publike, shkolla profesionale, shkolla të larta, universitete, akademi, ndërtesa me salla

leksionesh, ndërtesa laborator, biblioteka dhe arkiva, ndërtesa institucionesh për mësim dhe punë kërkimore, përderisa nuk përmenden në grupin V;

- ç) Ndërtesa për bujqësinë me pajisje mbi mesataren, kuzhina të mëdha, hotele, banka, qendra tregtare, bashki, ndërtesa parlamentesh dhe gjykatash, si dhe ndërtesa për administratën me pajisje mbi mesataren; spitale të shkallës së kujdesit të përgjithshëm, spitale specialiteti, spitale me destinacion të veçantë, qendra terapie dhe rehabilitimi, ndërtesa për çlodhje, kurim dhe ripërtëritje;
- d) Kisha, salla koncertesh, muzeume, skena studioje, salle me shumë funksione për qëllime fetare, kulturore e sportive;
- dh) Salla për pishina, qendra sportive cilësore, qendra të mëdha sportive.

v. Grupi V tarifor:

Komplekse në natyrë me kërkesa shumë të larta planifikimi, kjo do të thotë me kërkesa shumë të larta për lidhjen me zonën përreth, kërkesa shumë të larta për mbrojtjen, trajtimin dhe zhvillimin e natyrës dhe peizazhit, shumë fusha funksionimi me marrëdhënie të shumëllojshme, kërkesa mbi mesatare kompozimi, kërkesa mbi normalen për furnizimin dhe pastrimin e mbeturinave. Në këtë grup klasifikohen:

- a) Spitale me shkallë përkujdesjeje të lartë, klinika universitare, uzina çeliku, uzinat e shkrirjes, salla për përpunim metalesh, uzinë koksifikimi;
- b) Studio për radio-televizion, teatër, ndërtesë koncertesh, ndërtesë skenash.
- c) Ndërtesa për punë kërkimore shkencore (specialitete eksperimentesh).

2. Punime për ndarjet funksionale të brendshme

Punimet për ndarjet funksionale të brendshme të mëposhtme, zakonisht i caktohen grupeve tarifore si vijon:

i. Grupi I tarifor

Punime të brendshme hapësirë formuese me kërkesa shumë të vogla planifikimi, kjo do të thotë me një fushë funksionimi me kërkesa shumë të vogla lidhur me kompozimin dhe orientimin ndaj dritës, me kërkesa shumë të vogla për renditjen dhe proporcionet e ambienteve pa ose me pajisje teknike të thjeshtë, me kërkesa shumë të vogla për kompozimin e ngjyrave dhe materialeve, me kërkesa shumë të vogla për kompozimin konstruktiv të detajeve. Në këtë grup klasifikohen:

- a) Sipërfaqe të brendshme qarkullimi,
- b) Salla të hapura pushimi, loje dhe çlodhjeje,
- c) Ambiente të brendshme të thjeshta për përdorim të përkohshëm.

ii. Grupi II tarifor:

Punime të brendshme hapësirë formuese me kërkesa të vogla planifikimi, kjo do të thotë me më pak fusha funksionimi, me kërkesa të vogla lidhur me kompozimin e dritës, kërkesa të vogla për renditjen dhe proporcionet e ambienteve, pajisje teknike të

pakta, kërkesa të vogla për kompozimin e ngjyrave dhe materialeve, kërkesa të vogla për kompozimin konstruktiv të detajeve. Në këtë grup klasifikohen:

- a) Ambiente të thjeshta banimi, qëndrimi dhe zyre, punishte, magazina shitjeje, ambiente dytësore për komplekse sportive, kioska të thjeshta shitjeje;
- b) Ambiente të brendshme, të cilat kompozohen me mobilje dhe objekte të tjera pajisje të ciësisë së thjeshtë prodhuara në seri.

iii. Grupi III tarifor:

Punime të brendshme hapësirë formuese me kërkesa mesatare planifikimi, kjo do të thotë me mjaft fusha funksionimi të thjeshta, kërkesa mesatare lidhur me kompozimin e dritës, kërkesa mesatare për renditjen dhe proporcionet e ambienteve, pajisje teknike mesatare, kërkesa mesatare për kompozimin e ngjyrave dhe materialeve, kërkesa mesatare për kompozimin konstruktiv të detajeve. Në këtë grup klasifikohen:

- a) Ambiente, qëndrimi, zyre, për kohë të lirë, lokale, grupe, banimi, sociale, mbledhjeje dhe shitjeje, kantina si dhe dhoma hoteli, për të sëmurë, klasash dhe banjoje me punime të brendshme dhe pajisje mesatare ose me pajisje teknike mesatare; stenda panairesh me pjesë sistemi ose pjesë modele;
- b) Ambiente të brendshme me kompozim mesatar, të cilët në pjesën më të madhe kompozohen me mobilje dhe objekte të tjera pajisjeje të prodhuara në seri.

iv. Grupi IV tarifor:

Punime të brendshme hapësirë formuese me kërkesa mbi mesatare planifikimi, kjo do të thotë me mjaft fusha funksionimi me marrëdhënie të shumëllojshme, kërkesa mbi mesatare lidhur me kompozimin e dritës, kërkesa mbi mesatare për renditjen dhe proporcionet e ambienteve, kërkesa mbi mesatare për pajisje teknike, kërkesa mbi mesatare për kompozimin e ngjyrave dhe materialeve, kërkesa mbi mesatare për kompozimin konstruktiv të detajeve. Në këtë grup klasifikohen:

- a) Ambiente banimi, qëndrimi, trajtimi, shitjeje, pune, bibliotekash, mbledhesh, shoqërore, lokalesh, referatesh. Salla leksionesh, ekspozita, panairë, dyqane speciale, përderisa nuk përmenden në grupin II dhe III tarifor;
- b) Salla pritjeje dhe sportelesh me punime të brendshme mbi mesataren, me mobilim të shkallës së lartë ose me pajisje teknike mbi mesataren, p.sh. në spitale, hotele, banka, qendra të mëdha tregtare dhe bashki;
- c) Salla parlamenti dhe gjykate, salla për disa qëllime për qëllime fetare, kulturore ose sportive;
- ç) Punime të brendshme hapësirë formuese të pishinave dhe kuzhinave ekonomike;
- d) Objekte kulturi;
- dh) Ambiente të brendshme me kompozim mbi mesatar, duke përdorur mobilje dhe objekte të tjera pajisjeje të cilësisë së lartë të prodhuara në seri.

v. Grupi V tarifor:

Punime të brendshme hapësirë formuese me kërkesa shumë të larta planifikimi, kjo do të thotë me një numër të madh fushash funksionimi me marrëdhënie të shumëllojshme, kërkesa shumë të larta lidhur me kompozimin e dritës, kërkesa shumë të larta për renditjen dhe proporcionet e ambienteve, një pajisje teknike të shumëllojshme dhe me kërkesa të larta teknike, kërkesa shumë të larta për kompozimin e ngjyrave dhe materialeve, kërkesa shumë të larta për kompozimin konstruktiv të detajeve. Në këtë grup klasifikohen:

- a) Salla koncertesh dhe teatri, ambiente studiosh për radio, televizion dhe teatër;
- b) Ambiente biznesi dhe mbledhjeje me kërkesa shumë të larta për punimet e brendshme, mobilim të kushtueshëm ose me kërkesa të larta teknike;
- c) Ambiente të brendshme me pjesë hyrëse -holli- me punime të brendshme të cilësisë më të lartë, mobilim të kushtueshëm ose me kërkesa të veçanta për pajisjet teknike.

SEKSIONI II STRUKTURAT NË AMBIENTET E JASHTME

Neni 30 Parimet e tarifave

1. Përveç kostove të instalimeve në natyrë, kostot e llogaritshme, për shërbimet themelore për strukturat në ambientet e jashtme, në mënyrë specifike përfshijnë kostot për strukturat dhe projektet e mëposhtme, ku ofruesi i shërbimit merr përsipër planifikimin e tyre teknik dhe/ose mbikëqyr realizimin e tyre:

- i) rrjedhave ujore të vetme me elemente të konsiderueshme ekologjike dhe të peizazhit;
- ii) pellgjeve ujëmbledhëse;
- iii) punimeve tokësore, në shkallë të gjerë, si pjesë e projektimit të peizazhit;
- iv) prerje të thjeshta dhe përforcime, si një mjet për projektimin e peizazhit, nëse kërkohet mbikëqyrje e përcaktuar në Kreun IV;
- v) barriera zhurma izoluese, si një mjet për projektimin e peizazhit;
- vi) strukturat për mbajtjen e ngarkesave dhe për përforcimin e tokës; mbështetjet, pa ngarkesën e trafikut, si një mjet për projektimin e peizazhit nëse nuk kërkon shërbime të përcaktuara në Kreun IV;
- vii) rrugë-kalimet dhe urat, nëse nuk kërkon shërbimet e përcaktuara në Kreun IV;
- viii) rrugët e papërshtatshme për trafikun e rregullt të makinave, me objekte të thjeshta të kullimit, plus rrugët e tjera dhe sipërfaqet e shtruara, të planifikuara si karakteristika të projektimit në strukturat, në ambient të jashtëm, të cilat nuk

kërkojnë shërbime të përcaktuara në Kreun III.

2. Në vijim nuk përfshihen në kostot e llogaritshme strukturat në ambientet e jashtme:

- i) Ndërtesa dhe shpenzimet e listuara në nenin 23, pika 3;
- ii) Puna për themelet dhe sipërfaqet e përfunduara të zonave të këmbësorëve, duke përjashtuar kostot e shtrimit të sipërfaqes.

Neni 31

Fazat e projektimit të strukturave në ambientet e jashtme sipas tipologjisë së shërbimit

Neni 23, pika 1 vlen, me përjashtim të rasteve kur janë të lidhura me strukturat, në ambientet e jashtme. Shërbimet janë përmbledhur në nëntë faza dhe vlerësohen, mbi bazën e përqindjeve ndaj tarifës së shërbimit, të përcaktuara në nenin 32, në vijim. Përqindjet, sipas fazave të shërbimit, janë treguar në tabelën më poshtë:

Nr.	Fazat e projektimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e I-rë	Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit	3%
2	Faza e II-të	Projektideja paraprake	10%
3	Faza e III-të	Projektideja përfundimtare	15%
4	Faza e IV-ërt	Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit	6%
5	Faza e V-të	Projekti i zbatimit	24%
6	Faza e VI-të	Preventivi përfundimtar	7%
7	Faza e VII-të	Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi	3%

8	Faza e VIII-të	Mbikëqyrja	29%
9	Faza e IX-të	Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar dhe kolaudim	3%

Tabela. 7 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për strukturat në ambientet e jashtme.

Neni 32

Tabela e tarifave për shërbimet, që kanë të bëjnë me strukturat në ambientet e jashtme

1. Tabela e mëposhtme specifikon vlerat e tarifave minimale dhe tarifat maksimale për shërbimet, në lidhje me strukturat në ambientet e hapura, të listuara në Nenin 31.
2. Përcaktimi i grupit tarifor, të shërbimit, bëhet sipas vlerësimit të shkallës së vështirësisë së kriterëve të mëposhtme:
 - i) Kërkesat, lidhur me integrimin me mjedisin përreth;
 - ii) Kërkesat në drejtim të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të natyrës dhe peizazhit;
 - iii) Gama e funksioneve;
 - iv) Kërkesat estetike;
 - v) Lidhja me infrastrukturën ekzistuese.
3. Gjatë llogaritjes së grupit tarifor, për strukturat, në ambientet e jashtme, për të cilat është i paqartë përcaktimi i grupit tarifor, atëherë është e nevojshme të përdoret sistemi i pikëzimit më poshtë për kriteret e vlerësimit. Për të arritur vlerësimin:
 - i) Grupi I tarifor:
Strukturat në ambientet e jashtme, deri në 8 pikë;
 - ii) Grupi II tarifor:
Strukturat në ambientet e jashtme me 9-15 pikë;
 - iii) Grupi III tarifor:
Strukturat në ambientet e jashtme me 16-22 pikë;
 - iv) Grupi IV tarifor:
Strukturat në ambientet e jashtme me 23-29 pikë;
 - v) Grupi V tarifor:
Strukturat në ambientet e jashtme me 30-36 pikë.
4. Për të caktuar grupin e saktë të tarifave të strukturave në ambientet e jashtme, bëhet vlerësimi si më poshtë:
 - i) Për strukturat në ambientet e jashtme:
 - pikat i), ii) dhe iv); deri në 8 pikë;

- pikat iii) dhe v)

deri në 6 pikë.

KOSTOTE LLOGARITSHME LEKE	GRUPI TARIFOR I		GRUPI TARIFOR II		GRUPI TARIFOR III		GRUPI TARIFOR IV		GRUPI TARIFOR V		
	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %	
2,863,280	4.71	5.77	5.77	7.18	7.18	9.30	10.71	9.30	10.71	10.71	11.77
3,500,000	4.70	5.75	5.75	7.15	7.15	9.25	10.65	9.25	10.65	10.65	11.71
4,200,000	4.66	5.71	5.71	7.10	7.10	9.19	10.59	9.19	10.59	10.59	11.63
4,900,000	4.64	5.68	5.68	7.06	7.06	9.13	10.52	9.13	10.52	10.52	11.55
5,600,000	4.62	5.65	5.65	7.02	7.02	9.08	10.45	9.08	10.45	10.45	11.48
6,300,000	4.59	5.62	5.62	6.98	6.98	9.02	10.38	9.02	10.38	10.38	11.41
7,000,000	4.57	5.58	5.58	6.94	6.94	8.96	10.31	8.96	10.31	10.31	11.33
14,000,000	4.32	5.26	5.26	6.51	6.51	8.38	9.63	8.38	9.63	9.63	10.57
21,000,000	4.07	4.94	4.94	6.09	6.09	7.81	8.96	7.81	8.96	8.96	9.83
28,000,000	3.83	4.62	4.62	5.67	5.67	7.24	8.29	7.24	8.29	8.29	9.08
35,000,000	3.59	4.30	4.30	5.25	5.25	6.68	7.63	6.68	7.63	7.63	8.34
42,000,000	3.57	4.23	4.23	5.12	5.12	6.45	7.34	6.45	7.34	7.34	8.00
49,000,000	3.57	4.19	4.19	5.02	5.02	6.26	7.09	6.26	7.09	7.09	7.72
56,000,000	3.57	4.15	4.15	4.92	4.92	6.08	6.85	6.08	6.85	6.85	7.43
63,000,000	3.57	4.10	4.10	4.82	4.82	5.89	6.60	5.89	6.60	6.60	7.14
70,000,000	3.57	4.06	4.06	4.71	4.71	5.70	6.35	5.70	6.35	6.35	6.85
140,000,000	3.57	3.94	3.94	4.44	4.44	5.19	5.69	5.19	5.69	5.69	6.07
210,000,000	3.57	3.92	3.92	4.39	4.39	5.10	5.58	5.10	5.58	5.58	5.93
214,742,640	3.57	3.92	3.92	4.39	4.39	5.10	5.57	5.10	5.57	5.57	5.93

Neni 33

Grupet tarifore dhe klasifikimi i tyre

Strukturat në ambient të hapur, përcaktohen sipas grupeve tarifore të mëposhtme si vijon:

i. Grupi I tarifor:

Komplekse në natyrë me kërkesa shumë të vogla planifikimi, kjo do të thotë me kërkesa shumë të vogla për lidhjen me zonën përreth, kërkesa shumë të vogla për mbrojtjen, trajtimin dhe zhvillimin e natyrës dhe peizazhit, një fushë funksionimi, kërkesa shumë të vogla kompozimi, me asnjë ose me pajisje nga më të thjeshtat për furnizimin dhe pastrimin e mbeturinave. Në këtë grup klasifikohen:

- a) Kompozime terrenesh me mbjellje në natyrë të lirë;
- b) Gjelbërim me mbjellje për mbrojtjen nga era;
- c) Livadhe lojrash, pjerrësi (pista) për ski dhe rrëshqitje pa pajisje teknike.

ii. Grupi II tarifor:

Komplekse në natyrë me kërkesa të pakta planifikimi, kjo do të thotë me kërkesa të pakta për lidhjen me zonën përreth, kërkesa të pakta për mbrojtjen, trajtimin dhe zhvillimin e natyrës dhe peizazhit me pak fusha funksionimi. Në këtë grup klasifikohen:

- a) Sipërfaqe të lira me përpunime të thjeshta në qendra të vogla banimi, pranë veprave ndërtimore të veçanta dhe pranë tregjeve bujqësore;
- b) Gjelbërim shoqërues pranë komplekseve të qarkullimit, përderisa nuk përmendet në grupin e I dhe të III të tarifave; lidhje me gjelbërim pa ndonjë pajisje të veçantë; sheshe për lojra me top (fusha futbollit të vogla);
- c) Livadhe lojrash, pjerrësi për ski dhe rrëshqitje me pajisje teknike;
- ç) Sheshe sportive pa pista vrapimi ose pa pajisje të tjera teknike, kompozim terreni dhe mbjellje bimësh për rehabilitimin e landfilleve, vend depozitimeve të mbetjeve dhe guroreve;
- d) Zona të mbjella rurale përveç atyre që mbuloohen nga grupi I tarifor, breza të ngushta të gjelbra midis zonave urbane.

iii. Grupi III tarifor:

Komplekse në natyrë me kërkesa mesatare planifikimi, kjo do të thotë me kërkesa mesatare për lidhjen me zonën përreth, kërkesa mesatare për mbrojtjen, trajtimin dhe zhvillimin e natyrës dhe peizazhit, me mjaft fusha funksionimi; kërkesa mesatare kompozimi; kërkesa normale ose të zakonshme për furnizimin (ujë, etj.) dhe pastrimin e mbeturinave. Në këtë grup klasifikohen:

- a) Sipërfaqe të lira pranë objekteve ndërtimore private dhe publike, përderisa ato

nuk përmenden në grupin e II, IV ose V të tarifave;

- b) Gjëlberim shoqëruar pranë komplekseve të qarkullimit kërkesa të rritura për mbrojtjen, trajtimin dhe zhvillimin e natyrës dhe peizazhit;
- c) Sipërfaqe për mbrojtjen e llojeve dhe Biotop, përderisa nuk përmenden në grupin e IV ose të V të tarifave;
- ç) Varrezat e dëshmorëve, monumentale dhe historike, statuja dhe obelisk, fusha të kombinuara loje, komplekse sportive përderisa nuk përmenden në grupin tarifor II ose IV;
- d) Zona me specie dhe habitate të mbrojtura, që nuk përmenden në grupet tarifore IV apo V;
- dh) Vende kampingu, tendash dhe pishina, komplekse kopshtarie në periferi të qytetit për përdorim privat.

iv. Grupi IV tarifor:

Komplekse në natyrë në kërkesa mbi mesatare planifikimi, kjo do të thotë me kërkesa mbi mesatare për lidhjen me zonën përreth, kërkesa mbi mesatare për mbrojtjen, trajtimin dhe zhvillimin e natyrës dhe peizazhit, mjaft fusha funksionimi me marrëdhënie të shumëllojshme, kërkesa mbi mesatare kompozimi, kërkesa mbi normalen për furnizimin dhe pastrimin e mbeturinave. Në këtë grup klasifikohen:

- a) Sipërfaqe të hapura me topografi dhe kushte hapësinore të veçanta, në struktura private apo publike;
- b) Rripa të gjerë, të gjëlber midis zonave urbane, zona të rregulluara dhe të gjëlberuara për këmbësorë, çati të gjëlbra me densitet të ulët;
- c) Zona me habitat të mbrojtur me kërkesa të veçanta apo funksione të veçanta habitati;
- ç) Objekte sportive, fusha loje/sportive, stadione, pishina të hapura, fusha golfi, varreza publike/private, parqe, teatro të hapur (amfiteatër), kopshte të gjëlbra shkollore, shtigje dhe zona për soditje peizazhi.

v. Grupi V tarifor:

Komplekse në natyrë në kërkesa shumë të larta planifikimi, kjo do të thotë me kërkesa shumë të larta për lidhjen me zonën përreth, kërkesa shumë të larta për mbrojtjen, trajtimin dhe zhvillimin e natyrës dhe peizazhit, shumë fusha funksionimi me marrëdhënie të shumëllojshme, kërkesa mbi mesatare kompozimi, kërkesa mbi normalen për furnizimin dhe pastrimin e mbeturinave. Në këtë grup klasifikohen:

- a) Kopshte, oborre me kërkesa të larta prezantimi, kopshte në tarraca dhe çati, gjëlberime intensive të çative;
- b) Sipërfaqe të lira të lidhura me komplekse historike, parqe, kopshte dhe sheshe historike;
- c) Kopshte botanike dhe zoologjike;
- ç) Sipërfaqe të lira me pajisje të veçanta për kërkesa shfrytëzimi të larta, kopshte-ekspozitë.

SEKSIONI III VEPRA INXHINIERIKE

Neni 34 Fusha e veprimit

Veprat inxhinierike përfshijnë:

1. Strukturat dhe objektet për furnizim me ujë;
2. Strukturat dhe objektet për largimin e ujërave të ndotura;
3. Strukturat dhe objektet për inxhinieri hidraulike, përveç objekteve të hapura të përcaktuara në nenin 2, pika 11;
4. Strukturat dhe objektet për furnizimin dhe largimin e gazrave dhe trupat e ngurtë, duke përfshirë ndotësit e ujit, lëngje, me përjashtim të objekteve të përcaktuara në nenin 52;
5. Strukturat dhe objektet për depozitimin e mbeturinave;
6. Objekte inxhinierike për shërbime transporti dhe qarkullimi;
7. Projekte të tjera individuale me përjashtim të ndërtesave dhe antenave të transmetimit.

Neni 35 Parimet e tarifave

1. Kostot e llogaritshme janë kostot e ndërtimit të veprave inxhinierike.
2. Në kostot e llogaritshme përfshihen edhe kostot e sistemeve teknike edhe kur projektuesi nuk i planifikon vetë. Në këtë rast, kostoja e ndërtimit llogaritet:
 - i) Në vlerën e plotë, kur kostot e sistemeve teknike nuk kalojnë 15% të kostove totale të projektit
 - ii) Në 50%, kur kostot e sistemeve teknike, kalojnë 15% të kostos totale të projektit.
3. Shpenzimet e mëposhtme nuk përfshihen në kostot e llogaritshme, në rastet kur projektuesi nuk i planifikon dhe nuk i mbikëqyr:
 - i) Përgatitjen e sheshit të ndërtimit;
 - ii) Lidhjen me infrastrukturën publike;
 - iii) Lidhjen me infrastrukturën publike dhe strukturat e jashtme.
4. Masat e rregullimit të trafikut gjatë periudhës së punimeve, për spostimin dhe lëvizjen e tubave, mobilimin rrugor dhe pajisjet ndihmëse, p.sh. shinave.
5. Instalimet e makinerive, të cilat shërbejnë për qëllime të veçanta të punimeve inxhinierike.

Neni 36 Fazat e projektimit të veprave inxhinierike

1. Neni 24, pika 1, fjalia e parë, është e vlefshme në përputhje me rrethanat e mëposhtme.

Shërbimet që lidhen me fazat e veprave inxhinierike janë të përmbledhura në 9 faza dhe llogariten në bazë të përqindjeve të tarifave, si në nenin 37, në vijim:

Nr.	Fazat e projektimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e I-rë	Analiza e detyrës së projektimit / termat e referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit	2% për objektin 2% rindërtim dhe mirëmbajtje
2	Faza e II-të	Projektideja paraprake	15% për objektin 13% rindërtim dhe mirëmbajtje
3	Faza e III-të	Projektideja përfundimtare	25% për objektin
4	Faza e IV-ërt	Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit	2% për objektin 2% rindërtim dhe mirëmbajtje
5	Faza e V-të	Projekti i zbatimit	18% për objektin 30% rindërtim dhe mirëmbajtje
6	Faza e VI-të	Preventivi përfundimtar	10% për objektin 10% rindërtim dhe mirëmbajtje
7	Faza e VII-të	Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi	5% për objektin 5% rindërtim dhe mirëmbajtje

8	Faza e VIII-të	Mbikëqyrja	20% për objektin 20% rindërtim dhe mirëmbajtje
9	Faza e IX-të	Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar dhe kolaudim	3% për objektin 3% rindërtim dhe mirëmbajtje

Tabela. 9 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për veprat inxhinierike

Në ndryshim nga vlerësimi i shërbimit për objektet, e përcaktuar në nenin 34 pika vi) dhe vii), tarifa e planifikimit të strukturave mbajtëse për Fazën II është 8%.

2. Neni 27 dhe 28, pika 2, zbatohen respektivisht.

Neni 37

Shërbimet për planifikimin e objekteve ndërtimore inxhinierike dhe të komunikacionit

1. Faza I Analiza e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit

i. Shërbime bazë:

- a) Sqarimi i shtrimit të detyrës edhe për zonën e planifikimit të strukturës mbajtëse.
- b) Vrojtimi i vendit.
- c) Përmbledhja e qëllimeve të planifikimit që influencojnë për detyrën.
- ç) Përmbledhja e vlerave dokumenteve.
- d) Shpjegimi i të dhënave të planit.

dh) Llogaritja e vëllimit të punës dhe punimeve paraprake të nevojshme, p. sh. studime të tabanit të ndërtimit, punime matjeje, mbrojtja nga emisionet; më tej për veprat e komunikacionit: statistika të qarkullimit.

- e) Formulimi i ndihmave për vendimin për zgjedhjen e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim.
- ë) Përmbledhja e rezultateve.

ii) Shërbime të veçanta:

- a) Zgjedhja dhe vrojtimi i objekteve të ngjashme.
- b) Llogaritja e ngarkesave të veçanta, që nuk janë përcaktuar në normë.

2. Faza II projektide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit)

Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit.

i. Shërbime bazë

- a) Akordimi i qëllimeve të përfytyruara me kushtet anësore, të cilat jepen veçanërisht nga rregullimi i territorit, planifikimi i ndërtimit, planifikimi detajuar vendor si dhe nga planifikimet vendore dhe kombëtare.
- b) Studimi i mundësive të zgjidhjes me influencat mbi kompozimin ndërtimor dhe konstruktiv, përshtatshmërinë, rentabilitetin duke respektuar pajtueshmërinë me mjedisin, sigurimi dhe vlerësimi i hartave zyrtare.
- c) Përpunimi i një koncepti planifikimi, përfshirë studimin e zgjidhjeve të mundshme alternative me kërkesa të njëjta me paraqitje vizatimore dhe vlerësim duke përpunuar kontribute të pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim.
- c) Në veprat e komunikacionit: Matje të përafërta teknike të qarkullimit të veprës së komunikacionit; llogaritja e emisioneve të zhurmave nga vepra e komunikacionit në pika kritike sipas tabelave të vlerave; studimi i masave të mundshme për mbrojtjen nga zhurmat, përjashto studime të detajuara teknike të zhurmave, në mënyrë të veçantë në rastet komplekse.
- d) Sqarimi dhe shpjegimi i lidhjeve themelore specifike të specialitetit, procese dhe kushte.
- dh) Bisedime paraprake me autoritete dhe pjesëmarrës të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, për aftësinë për miratim, në rast se duhet për pagesë (sponsorizim) dhe pjesëmarrje në shpenzime.
- e) Bashkëveprim në shpjegimin e konceptit të planifikimit kundrejt qytetarëve dhe organeve politike.
- ë) Përpunimi i konceptit të planifikimit sipas vërejtjeve dhe propozimeve.
- f) Përgatitja e dokumenteve si ekstrakte nga projektideja paraprake për përdorim për një procedurë të rregullimit të territorit.
- g) Vlerësimi i shpenzimeve.
- gj) Përmbledhja e të gjitha rezultateve të planifikimit paraparak.

ii. Shërbime të veçanta

- a) Përgatitja e studimeve dobia-shpenzimet.
- b) Përgatitja e dokumenteve topografike dhe hidrologjike.

- c) Llogaritje e saktë e pjesëve të veçanta të ndërtimit.
 - ç) Koordinimi dhe paraqitja e pajisjeve dhe linjave tek ndërtimi i shinave të trenit.
3. **Faza III Projektideja përfundimtare** (planifikimi i sistemit dhe i integritit)
Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së projektimi/termave të referencës.
- i. Shërbime bazë
 - a) Përpunimi i konceptit të planifikimit (përpunimi hap pas hapi i një zgjidhjeje vizatimore) duke pasur parasysh të gjitha kërkesat specifike të fushës dhe duke përdorur kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, deri në projektidenë e plotë.
 - b) Raport shpjegues.
 - c) Llogaritje specifike të fushës, përjashtojë llogaritjet e strukturës mbajtëse.
 - ç) Paraqitje vizatimore e të gjithë projektidesë.
 - d) Plani i financimit, plani i kohëve të ndërtimit dhe i shpenzimeve. Llogaritja dhe argumentimi i shpenzimeve që mund të sigurohen me ndihmë (subvencionim) si dhe përgatitja e kërkesave për financim; bashkëpunim gjatë shpjegimit të projektidesë paraprake ndaj qytetarëve dhe organeve publike; Përpunimi i projektidesë sipas vërejtjeve dhe propozimeve.
 - dh) Bisedime me autoritete dhe pjesëmarrës të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, për aftësinë për miratim.
 - e) Llogaritja e shpenzimeve.
 - ë) Kontrolli i shpenzimeve duke krahasuar llogaritjen e shpenzimeve me vlerësimin e shpenzimeve.
 - f) Në veprat e komunikacionit: Përcaktimi përafërt i dimensioneve të veprave ndërtimore inxhinierike; përmbledhja e të gjitha dokumenteve paraprake të projektidesë; zhvillim i mëtejshëm i projektidesë paraprake deri në projektidenë përfundimtare; llogaritja e emisioneve të zhurmave të veprës së komunikacionit sipas vlerave të tabelave; përcaktimi i masave të nevojshme për mbrojtjen nga zhurmat, në rast nevojë duke përpunuar rezultatet e studimeve të detajuara teknike për zhurmat dhe konstatimi i nevojës për masa mbrojtëse nga zhurmat në ndërtesat e prekura; përcaktimi me llogaritje i veprës së komunikacionit në tokat kryesore dhe të vogla; paraqitja e efekteve në pikat detyruese; dokumentimi i profileve hapësinore të dritës; llogaritje të përafërta të fazave themelore të ndërtimit duke pasur parasysh drejtimin e qarkullimit gjatë kohës së ndërtimit.
 - g) Përmbledhja e të gjitha dokumenteve të projektidesë.
 - ii. Shërbimet e veçanta

- a) Sigurimi i ekstrakteve nga libri themeltar, zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe dokumente të tjera zyrtare.
- b) Vazhdimi i studimeve dobi-shpenzime.
- c) Llogaritje tekniko-sinjalistike.
- ç) Bashkëveprim gjatë marrëveshjeve administrative.

4. Faza IV projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

Përpunimi dhe dorëzimi i dokumenteve për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

i. Shërbimet bazë

- a) Përpunimi i dokumenteve e nevojshme për procedurat publike e ligjore përfshirë kërkesat për raste përjashtimore dhe lirime (nga detyrime), përmbledhja e dokumentacionit të veprës ndërtimore dhe përdorimi i kontributeve të pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim.
- b) Dorëzimi i dokumenteve.
- c) Plani për blerjen e truallit dhe dokumentet për blerjen e truallit.
- ç) Në veprat e komunikacionit; Përpunimi i rezultateve të studimeve teknike për zhurmat.
- d) Plotësimi dhe përshtatja e dokumenteve të planifikimit, përshtatje dhe llogaritje duke përdorur kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim.
- dh) Bashkëpunim gjatë shpjegimeve ndaj qytetarëve.
- e) Bashkëveprim në procedurën e miratimit të planit përfshirë pjesëmarrjen në takime shqyrtimi si dhe bashkëveprim në hartimin e qëndrimit ndaj vërejtjeve dhe propozimeve.

ii. Shërbimet e veçanta

- a) Bashkëveprim në sigurimin e aprovimit të të prekurve.
- b) Hartimi i dokumenteve për themelimin e bashkimeve.

5. Faza V projekti i zbatimit

Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

i. Shërbimet bazë

- a) Përpunimi i rezultateve të fazave të punimeve 3 dhe 4 (përgatitja hap pas hapi e zgjidhjes dhe e paraqitjes së saj) duke pasur parasysh të gjitha kërkesat specifike të fushës dhe duke përdorur kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, deri në zgjidhjen e aftë për zbatim.

- b) Paraqitje vizatimore dhe llogaritëse e objektit me të gjitha të dhënat e veçanta të nevojshme për zbatimin, përfshirë vizatime të detajuara në shkallët e kërkuara.
- c) Përpunimi i bazave për të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, dhe integrimi i kontributeve të tyre deri në zgjidhjen e aftë për zbatim.
- ç) Vazhdimi i planifikimit të zbatimit gjatë ndërtimit të objektit.

ii. Shërbimet e veçanta

Hartimi grafikut të punimeve dhe i planeve të rrjetit.

6. Faza VI preventivi përfundimtar

Llogaritja e sasive dhe hartimi i dokumentave të tenderit.

i. Shërbimet bazë:

- a) Llogaritja e sasive dhe renditja e pozicioneve të veçanta duke përfshirë kontributin e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim.
- b) Hartimi i dokumenteve të dhënies, në mënyrë të veçantë i përshkrimeve të punëve me listën e punëve si dhe të kushteve të veçanta kontraktuale.
- c) Akordimi dhe koordinimi i dokumenteve të dhënies me pjesëmarrësit e tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim.
- ç) Përcaktimi i fazave kryesore të zbatimit.

7. Faza VII përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi

Përgatitja e dokumentacionit tekniko-ligjor sipas kritereve të prokurimit.

i. Shërbimet bazë

- a) Përmbledhja e dokumenteve të dhënies për të gjitha fushat e punës.
- b) Verifikimi dhe vlerësimi i termave të referencës përfshirë hartimin e dokumentacionit për prokurim.
- c) Akordimi dhe përmbledhja e punimeve të atyre që marrin pjesë profesionalisht, të cilët bashkëpunojnë gjatë dhënies së dokumenteve.
- ç) Llogaritja e shpenzimeve.
- d) Bashkëveprim gjatë dhënies së ofertës.

ii. Shërbimet e veçanta

Verifikimi dhe vlerësimi i bashkëpunimeve me operatorë të tjerë dhe i propozimeve për ndryshime me konstruksione thelbësisht të ndryshme lidhur me mundësinë teknike dhe funksionale të realizimit.

8. Faza VIII mbikëqyrja²: Mbikëqyrja e punimeve nëpërmjet shërbimit të kontrollit të mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke pasur parasysh dhe anën ekonomike të tij.

Mbikëqyrja kontrollon:

- a) Mbarëvajtjen e të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, rregullat teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke pasur parasysh dhe anën ekonomike të tij.
- b) Hartimi dhe mbikëqyrja e një grafiku punimesh.
- c) Konstatimi i firmave zbatuese për vonesat në punime.
- ç) Marrja e punëve dhe livrimeve në bashkëpunim me mbikëqyrjen dhe të tjerë që marrin pjesë profesionalisht në mbikëqyrjen e objektit duke përgatitur një protokoll për rezultatin e marrjes.
- d) Kërkesa për marrje nga ana e autoriteteve dhe pjesëmarrje.
- dh) Dorëzimi i objektit përfshirë grumbullimin dhe dorëzimin e dokumenteve të kërkuara, p. sh. protokollet e marrjes në dorëzim dhe kontrollet e kontrolleve.
- e) Grumbullimi i të gjitha dispozitave të mirëmbajtjes së objektit.
- ë) Mbikëqyrja e kontrolleve për aftësinë funksionuese të pjesëve të objektit dhe të gjithë objektit.
- f) Lista e afateve të parashkrimit të pretendimeve nga garancitë e dhëna.
- g) Konstatimi i shpenzimeve.
- gj) Kontrolli i shpenzimeve.
- h) Kontrolli i shpenzimeve duke kontrolluar llogaritë përfundimtare të punëve të sipërmarrjeve zbatuese të ndërtimit me çmimet e kontratës dhe llogaritjen në vazhdimësi të shpenzimeve.

9. Faza IX përgatitja e dokumentacionit përfundimtar për kolaudim

Mbikëqyrja dhe rregullimi i mangësive dhe dokumentimi i rezultatit të përgjithshëm.

i. Shërbimet bazë

- a) Verifikimi me përgjegjësi për realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
- b) Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
- c) Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
- ç) Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes. Mbikëqyrja konstaton mangësitë para skadimit të afateve të parashkrimit të të drejtave nga garancitë kundrejt sipërmarrjeve zbatuese.
- d) Mbikëqyrje dhe rregullim i mangësive, që shfaqen brenda afateve të

² Për detyrat e mbikëqyrës referohu akteve ligjore në fuqi.

parashkrimin të të drejtave nga garancitë, megjithatë e shumta deri në mbarim të jo më shumë se 2 viteve nga marrja në dorëzim e punëve.

dh) Bashkëpunim në dorëzimin e punëve të sigurisë.

e) Grumbullim sistematik i paraqitjeve vizatimore dhe rezultateve të llogarive të objektit.

Neni 38

Tabela e tarifave, për shërbimet, në lidhje me punimet e veprave inxhinierike

1. Tabela e mëposhtme specifikon tarifat minimale dhe maksimale për shërbimet, në lidhje me fazat e veprave inxhinierike në Nenin 36, të listuara për fushëveprimi në Nenin 34.

KOSTOT E LLOGARITSHME në million LEKË	GRUPI I TARIFOR		GRUPI II TARIFOR		GRUPI III TARIFOR		GRUPI IV TARIFOR		GRUPI V TARIFOR	
	nga	deri	nga	deri	nga	deri	nga	deri	nga	deri
	%		%		%		%		%	
1	10	11	11	12	12	13	13	14	14	15
2	10	11	11	12	12	13	13	14	14	15
5	10	11	11	12	12	13	13	14	14	15
10	10	11	11	12	12	13	13	14	14	15
15	10	11	11	12	12	13	13	14	14	15
20	10	11	11	12	12	13	13	14	14	15
25	10	11	11	12	12	13	13	14	14	15
30	9.89	10.94	10.94	12	12	13	13	14	14	15
40	9.13	10.13	10.13	11.16	11.16	12.18	12.18	13.2	13.2	14.23
50	8.49	9.49	9.49	10.5	10.5	11.51	11.51	12.51	12.51	13.52
60	7.99	8.98	8.98	9.97	9.97	10.96	10.96	11.94	11.94	12.93
70	7.57	8.54	8.54	9.52	9.52	10.49	10.49	11.46	11.46	12.44
80	7.21	8.16	8.16	9.13	9.13	10.09	10.09	11.04	11.04	12.01
90	6.88	7.83	7.83	8.78	8.78	9.73	9.73	10.67	10.67	11.63
100	6.6	7.53	7.53	8.47	8.47	9.41	9.41	10.35	10.35	11.29
120	6.1	7.02	7.02	7.94	7.94	8.86	8.86	9.78	9.78	10.71
140	5.68	6.58	6.58	7.49	7.49	8.4	8.4	9.3	9.3	10.21
160	5.31	6.2	6.2	7.1	7.1	7.99	7.99	8.88	8.88	9.78
180	4.99	5.87	5.87	6.76	6.76	7.64	7.64	8.51	8.51	9.4
200	4.7	5.57	5.57	6.45	6.45	7.32	7.32	8.19	8.19	9.06

250	4.09	4.94	4.94	5.79	5.79	6.64	6.64	7.49	7.49	8.35
300	3.59	4.42	4.42	5.26	5.26	6.09	6.09	6.92	6.92	7.76
350	3.17	3.99	3.99	4.81	4.81	5.63	5.63	6.44	6.44	7.27
400	2.81	3.61	3.61	4.42	4.42	5.22	5.22	6.02	6.02	6.84
450	2.5	3.28	3.28	4.08	4.08	4.87	4.87	5.66	5.66	6.46
500	2.5	3	3	3.77	3.77	4.55	4.55	5.33	5.33	6.12
550	2.5	3	3	3.5	3.5	4.26	4.26	5.03	5.03	5.82
600	2.5	3	3	3.5	3.5	4	4	4.76	4.76	5.54
650	2.5	3	3	3.5	3.5	4	4	4.51	4.51	5.28
700	2.5	3	3	3.5	3.5	4	4	4.5	4.5	5.04
750	2.5	3	3	3.5	3.5	4	4	4.5	4.5	5
800	2.5	3	3	3.5	3.5	4	4	4.5	4.5	5
850	2.5	3	3	3.5	3.5	4	4	4.5	4.5	5
900	2.5	3	3	3.5	3.5	4	4	4.5	4.5	5
950	2.5	3	3	3.5	3.5	4	4	4.5	4.5	5
1000	2.5	3	3	3.5	3.5	4	4	4.5	4.5	5

Tabela. 10 - Tabela shoqëruese e tarifave, neni 38, pika 1 – Punimet e veprave inxhinierike.

2. Përcaktimi i grupit tarifor, të shërbimit, bëhet sipas vlerësimit të shkallës së vështirësisë së kritereve të mëposhtme:

- i) Faktorët gjeologjikë dhe të nëntokës (formacione të qëndrueshme, formacione mesatarisht të qëndrueshme, formacione të dobëta, formacione shumë të dobëta. Kjo duhet të vlerësohet në përqindje për të gjithë gjatësinë e objektit) ;
- ii) Sistemet teknike dhe pajisjet;
- iii) Integrimi i projektit në mjedisin e tij ose përreth;
- iv) Shkalla e vështirësisë së zonave funksionale dhe/ose kërkesat konstruktive dhe teknike;
- v) Kushte të specializuara.

3. Kur kriteret e vlerësimit janë të zbatueshme, përmes shumës së një grupi tarifor për objekte të inxhinierisë, atëherë është e nevojshme që të përcaktohen pikat e llogaritjes, siç përshkruhet në paragrafin 4, në vijim.

Objekti klasifikohet në grupet e mëposhtme tarifore, në bazë të shumës së pikëve të vlerësimit:

- i) Grupi I tarifor: deri në 10 pikë;
- ii) Grupi II tarifor: 11-17 pikë;
- iii) Grupi III tarifor: 18-25 pikë;
- iv) Grupi IV tarifor: 26-33 pikë;
- v) Grupi V tarifor: 34-40 pikë.

4. Me qëllim, përcaktimin e punëve inxhinierike, për përcaktimin e grupit tarifor, të cilat shprehin shkallën e vështirësisë së kërkesave që duhet të përmbushen nga inxhinieri, duhet të përcaktohen kriteret e vlerësimit, si më poshtë:

Sipas pikës 2:

- pika i), ii) dhe iii) deri në 5 pikë;
- pika iv) deri në 10 pikë;
- pika v), deri në 15 pikë.

Neni 39

Grupet tarifore dhe klasifikimi i tyre

Strukturat e transportit dhe qarkullimit të mëposhtme, zakonisht i caktohen grupeve tarifore si vijon:

i. Grupi I tarifor

- a) Depozita uji, tubacione të ujit pa pika kontrolli;
- b) Tubacione të ujërave të zeza pa pika kontrolli (kanalizime të jashtme);
- c) Mirëmbajtja e sistemeve ujitëse me gravitet, fushore-kodrinore;
- ç) Mirëmbajtja e sistemeve të kullimit me gravitet, fushore-kodrinore;
- d) Damba dhe Landfille me lartësi më të vogël se 3 m;
- dh) Depozitime, pika grumbullimi dhe stacione të transferimit të mbetjeve urbane pa struktura të tjera shtesë;
- e) Rikonstruksioni i strukturave ekzistuese të thjeshta ndërtimore.

ii. Grupi II tarifor

- a) Sisteme të thjeshta për nxjerrjen dhe furnizimin me ujë, si: puse, burime ujore, rezervuar të thjeshtë, kontejnerë në struktura të parafabrikuara, sisteme shuarjeje zjarri;
- b) Linja të furnizimit me ujë, me lidhje minimale dhe pika të pakta kontrolli, rrjet i thjeshtë i furnizimit me ujë të pijshëm (ujësjellës i jashtëm);
- c) Linjat e kanalizimeve të ujërave të bardha për qëndrat e banuara;
- ç) Punime të trajtimit të ujit industrial të depozitave apo të punishteve të ujit të ndotur, zona filtrimi, basene mbledhëse të ujit të shiut, tubacione të ujërave të zeza me degëzime minimale dhe me pak pika kontrolli, rrjete të thjeshta të ujërave të zeza;
- d) Objekte të thjeshta të pompimit, stacione pompimi dhe makineritë e ujit;
- dh) Rikonstruksion i sistemeve ujitëse me gravitet fushore -kodrinore ekzistuese;
- e) Mirëmbajtja e sistemeve ujitëse me gravitet në toka malore;
- ë) Mirëmbajtja e sistemeve ujitëse me ngritje mekanike në toka fushore e kodrinore;
- f) Rikonstruksion i sistemeve kulluese me gravitet zona fushore e kodrinore;

- g) Mirëmbajtje e sistemeve kulluese me ngritje mekanike;
- gj) Mirëmbajtje e digave me material vendi ekzistuese;
- h) Mirëmbajtja e mbrojtjeve nga përmytjet, të fushave bujqësore;
- i) Mirëmbajtjen e pritave ekzistuese të përrenjve;
- j) Damba dhe Landfille me lartësi 3 – 6 m;
- k) Struktura të thjeshta ndërtimore.

iii) Grupi III tarifor

- a) Puse të thella, pajisje depozitimi;
- b) Impiante të kondicionimi të ujit të thjeshta, me sisteme me procese mekanike;
- c) Tubacione për ujë me lidhje dhe pika kontrolli të shumta, rrjetë ujore me lidhje dhe pika kontrolli të shumta, si dhe sisteme presioni (ujësjellës i jashtëm);
- ç) Punime për trajtimet e ujërave të zeza me stabilizim aerob (transformimi në humus dhe në produkte minerale, nga ajrosja e njëtrajtshme e substancave organike të baltës fundore), pika depozitimi të ujit të ndotur me sisteme mekanike;
- d) Tubacione të ujërave të zeza me pika të shumta lidhjeje dhe kontrolli;
- dh) Rrjete të ujërave të zeza me pika të shumta lidhjeje dhe kontrolli;
- e) Sisteme ujitëse me gravitet në toka fushore dhe kodrinore;
- ë) Rikonstruksion i sistemeve ujitëse me gravitet në toka malore;
- f) Rikonstruksion i sistemeve ujitëse me ngritje mekanike, fushore dhe kodrinore;
- g) Mirëmbajtja e sistemeve ujitëse me ngritje mekanike në toka malore;
- gj) Mirëmbajtja e veprave të artit në sisteme ujitëse;
- h) Sisteme kullimi me gravitet në zona fushore dhe kodrinore;
- i) Rikonstruksion i sistemeve kulluese me ngritje mekanike;
- j) Mirëmbajtje e veprave të artit në sisteme kulluese;
- k) Rikonstruksion i digave me material vendi;
- l) Mirëmbajtja e digave të betonit;
- ll) Mirëmbajtja e veprave të marrjes dhe shkarkimit të ujit;
- m) Rikonstruksioni i mbrojtjeve nga përmytjet, të fushave bujqësore;
- n) Mirëmbajtja e mbrojtjeve nga përmytjet e qendrave të banuara dhe brigjeve lumore;
- nj) Rikonstruksioni i pritave malore në përrenj;
- o) Vepra ngritëse të nivelit të ujit, Veprat e marrjes dhe shkarkuesit e prurjeve maksimale;
- p) Dekantuesit me prurje Q deri $5 \text{ m}^3/\text{s}$, Basenet e presionit, shkarkuesit e ujërave të tepërt;
- q) Kanalet e derivacionit, tunelet e derivacionit, tubacione turbinash, për Q deri $5 \text{ m}^3/\text{s}$;
- r) Damba dhe Landfille me lartësi $H=6-10\text{m}$;
- rr) Shkarkues i ujërave të tepërt në damba me lartësi deri në 10 m;
- s) Vepra për mbrojtjen nga ujërat nëntokësore të dambave me lartësi deri në 10m;
- sh) Mure mbajtëse me lartësi deri në 3 m;
- t) Kalata portesh, vepra të thjeshta portesh, portat e digës, basene të mbledhjes së

- ujit të shiut dhe kanaleve me disa lidhje dhe pika kontrolli, sisteme të drenazhimit të ujërave të shiut;
- th) Tubacione për lëngje dhe gazra që ndotin ujin, me pak pika lidhjeje dhe pika kontrolli, sisteme për depozitimin e lëngjeve që nuk duhet të përzihen me ujë, qendra pompimi për cisterna betoni, sisteme me një shkallë ndarjeje për ndarjen e lëngjeve të lehta, që nuk janë të përfshira në grupin tarifor II, rrjete tubash bosh me pak lidhje;
 - u) Vend depozitime mbetjesh të përkohshme, pika grumbullimi dhe rikuperimi të materialeve të papërmendura në grupet tarifore I ose II;
 - v) Impiante të përpunimit të mbetjeve të pa përfshira në grupet tarifore II ose IV; Impiante të përpunimit të materialeve të mbetura nga ndërtimi, të papërmendura në grupin tarifor II;
 - x) Impiante të kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme;
 - xh) Impiante të kompostimit të mbetjeve, të papërmendura në grupin tarifor IV, mbyllja e vendeve të ndotura të papërmendura në grupin tarifor IV;
 - y) Ura njëkalimshe, të papërmendura në grupin tarifor II ose IV;
 - z) Ura disakalimshe dhe të harkuara, strukturat ngarkesë mbajtëse me ankorim, muret e moleve dhe të pistave, të papërmendura në grupin tarifor II ose IV;
 - zh) Mure nëntokësore me pilota dhe rrjete, mure me pilota të thella;
 - aa) Objekte të thjeshta për mbrojtje nga zhurmat, që nuk përmenden në grupet tarifore II ose IV, por që kërkojnë shërbime, sikurse është përcaktuar në Kreun 4, seksionin I;
 - bb) Tunele të thjeshta dhe punime shpimesh;
 - cc) Oxhaqe me kompleksitet mesatar, kulla me superstruktura, kulla të thjeshta ajrimi/ftohjeje;
 - çç) Struktura furnizuese, për sisteme furnizimi në situata të veçanta, sillos me objekte ndihmëse të thjeshta;
 - dd) Porte dhe vendnisje anijesh/ varkash, të pa përfshira në grupin tarifor II ose IV;
 - dhdh) Vende ankoruese të thjeshta dhe garazhe nëntokësore të veçara;
 - ee) Punime të thjeshta kullash apo gërmimesh, punime të thjeshta shpimi, ndërtime komplekse për instalimet e ngrohjes qendrore, ndërtime të komplikuar betoni për sisteme ngrohjeje, stacione treni/tramvaji, të thjeshta nëntokësore.

iv) Grupi IV tarifor

- a) Shpime/galeri për puse nëntokësore dhe horizontale, cisterna depozitimi në formë kullash;
- b) Sisteme të përpunimit të ujit, me procese fizike dhe kimike, sisteme të thjeshta për dekontaminimin e ujerave nëntokësore, rrjete tubacionesh për ujë, me lidhje dhe kontrolle të shumta;
- c) Sisteme për trajtimin e ujërave të zeza, që nuk përmenden në grupet tarifore III ose V;
- ç) Sisteme për trajtimin e baltave, (llumrave);

- d) Rrjete tubacioni të ujërave të zeza, me lidhje dhe pika kontrolli të shumta; Sisteme komplekse të pompimit dhe makinerive ujore;
- dh) Sisteme ujitëse me gravitet në toka malore;
- e) Sisteme ujitëse me ngritje mekanike në toka fushore dhe kodrinore;
- ë) Rikonstruksioni i sistemeve ujitëse me ngritje mekanike në toka malore;
- f) Rikonstruksioni i veprave të artit në sistemet ujitëse;
- g) Rikonstruksioni i veprave të artit në sistemet kulluese;
- gj) Sisteme kulluese me ngritje mekanike;
- h) Diga me material vendi;
- i) Rikonstruksion i digave të betonit;
- j) Rikonstruksioni i Veprave të marrjes dhe shkarkimit të ujit;
- k) Trajtimi i mbrojtjes dhe pastrimit të rezervuarëve nga mbushjet e ngurta;
- l) Mbrojtja nga përmbytjet të fushave bujqësore;
- ll) Rikonstruksioni i mbrojtjeve nga përmbytjet të qendrave të banuara;
- m) Rikonstruksionin e mbrojtjes së brigjeve lumore dhe detare;
- n) Sistemimi i përrenjve;
- nj) Rikonstruksioni i mbrojtjes së brigjeve të përrenjve;
- o) Vepra ngritëse të nivelit të ujit deri në 10 m, vepra e marrjes dhe shkarkuesi i prurjeve maksimale;
- p) Dekantuesit për $Q=5-10\text{m}^3/\text{s}$, basenet e presionit, shkarkuesit e ujërave të tepërt;
- q) Kanalet e derivacionit, tunelet e derivacionit, tubacionet e turbinave, për $Q=5-10\text{m}^3/\text{s}$;
- r) Mirëmbajtja e veprave të veçanta në hidrocentrale;
- rr) Damba dhe Landfille me lartësi $H=10-15\text{m}$;
- s) Mure mbajtëse me lartësi 3-6 m;
- sh) Vendi i ankorimit të anijeve, pika të ngarkim shkarkimit, subjekt i baticave ose veprimtarive përmbytëse, vend parkime anësore, porte subjekt të baticave ose veprimtarive përmbytëse;
- t) Tubacione për lëngje dhe gazra të rrezikuara nga uji, me lidhje dhe pika kontrolli të shumta, sisteme me shumë faza për ndarjen e lëngjeve të lehta, rrjete tubacionesh bosh me lidhje të shumta;
- th) Sisteme të riciklimit dhe përpunimit të mbetjeve multi-fazore, sisteme kompostimi;
- u) Sisteme të përpunimit të mbetjeve të veçanta dhe mbetjeve urbane me kushte teknike të vështira, vend depozitime nëntokësore të mbetjeve, depozita mbetjesh, hermetizimi i gropave të vjetra dhe vendeve të kontaminuara, me kushte teknike të vështira, sistemet e trajtimit të tokës së kontaminuar;
- v) Ura komplekse, një apo disakalimshe dhe të harkuara;
- x) Mole dhe pista në ujë të një natyre komplekse;
- xh) Objekte për mbrojtjen nga zhurmat në vendndodhje të komplikuar, që nuk kërkojnë shërbimet e përcaktuara në Kreun 4, seksionin I, tunelet e thjeshta dhe punime gërmimesh horizontale;
- y) Oxhaqe komplekse;

- z) Kulla me superstruktura dhe platforma operimi;
- zh) Kulla ftohjeje/ventilimi të papërmendura në grupet tarifore III apo V;
- aa) Kanale furnizimi me gropa për disa tubacione të ndryshme, që ndërtohen në kushte të vështira;
- bb) Kulla me blloqe modulare dhe objekte ndihmëse, skela detare të vështira, vende për daljen e varkave dhe objekte skelash të thata, vende ankorimi të vështira, garazhe të vështira të papërmendura në grupin tarifor III, gjurmime horizontale, vertikale dhe nëntokësore të vështira të papërmendura në grupin tarifor V.

v) Grupi V tarifor

- a) Struktura dhe objekte për proceset me disa faza të përpunimit të ujit, sisteme komplekse të dezinfektimit të ujit;
- b) Punime komplekse të trajtimit të ujërave të zeza, struktura dhe objekte për trajtimin me shumë faza të llumrave;
- c) Stacione komplekse, si stacione pompimi ose gropa nëntokësore, objekte për ngritjen e anijeve;
- ç) Impiante incenerimi, impiante dekompozimi;
- d) Ura dhe tunele, veçanërisht të vështira;
- dh) Oxhaqe veçanërisht komplekse;
- e) Kulla me ndërtesa sipër tyre, struktura dhe objekte publike të larta, kulla ftohjeje të vështira, kulla dhe gjurmime veçanërisht të vështira, stacione nëntokësore lidhëse, objekte në det të hapur;
- ë) Stacione të pompimit dhe rrjeti për sisteme gazsjellësi;
- f) Sisteme ujitëse me ngritje mekanike në toka fushore, kodrinore dhe malore;
- g) Vepra arti në sistemet ujitëse dhe kulluese;
- gj) Diga betoni;
- h) Veprat e marrjes dhe të shkarkimit;
- i) Mbrojtja nga përmytjet e qendrave të banuara;
- j) Mbrojtja e brigjeve të përrenjve, lumore dhe detare;
- k) Vepra ngritëse të nivelit të ujit mbi 10 m, vepra e marrjes dhe shkarkuesi i prurjeve maksimale;
- l) Dekantuesit për prurje Q më shumë se $10\text{m}^3/\text{s}$, basenet e presionit, shkarkuesit e ujërave të tepërta;
- ll) Kanalet e derivacionit, tunelet e derivacionit, tubacione turbinash, për prurje Q më shumë se $10\text{m}^3/\text{s}$;
- m) Rikonstruksioni i veprave të veçanta në hidrocentrale;
- n) Damba dhe Landfille me lartësi H më të larta se 15m;
- nj) Shkarkuesi i ujërave të tepërta të dambës me lartësi H mbi 15 m;
- o) Vepra për mbrojtjen nga ujërat nëntokësore të dambave me lartësi H mbi 10m;
- p) Mure mbajtëse me lartësi H më shumë se 6 m.

SEKSIONI IV STRUKTURAT E TRANSPORTIT DHE QARKULLIMIT

Neni 40 Fusha e veprimit

Strukturat e transportit përfshijnë:

1. Strukturat e trafikut rrugor dhe sinjalistikës, me përjashtim të rrugëve të biçikletave, shtigjeve apo hapësirave të jashtme, siç përcaktohet në nenin 2, pika 11.
2. Strukturat e trafikut hekurudhor.
3. Strukturat e trafikut ajror.

Neni 41 Parimet e tarifave

1. Kostot e llogaritshme, janë kostot e ndërtimit të strukturave të transportit dhe qarkullimit.
2. Tarifimet e shërbimit, për fazën e I-rë deri në të VII-të dhe fazën IX-të, në rastin e strukturave të transportit përcaktohen, si në vijim:
 - i) Kostot për punimet e gërmimit e mbushjes duke përfshirë punimet në shkëmb deri në 40 % të kostove të llogaritshme siç përcaktohet, në pikën 1, të këtij neni.
 - ii) 10% të kostove të punimeve inxhinierike, nëse ofruesit të shërbimit nuk i është dhënë në të njëjtën kohë detyra për shërbimet e ndryshme, sipas pikave të përcaktuara në nenin 42, për veprat inxhinierike.
3. Kostot e llogaritshme, të mëposhtme, për fazën I-rë deri në të VII-të dhe fazën IX-të, të nenit 42, në rastin e rrugëve me shumë korsi, që kanë aks dhe pjerrësi të përbashkët të projektimit, si dhe aks hekurudhor të dyfishtë me platformë në një nivel, zbatohen vetëm me përqindjen e tarifave të mëposhtme, të kostos së llogaritshme, të përcaktuar dhe llogaritur sipas kushteve të pikave 1 dhe 2, të këtij neni:
 - i) Rrugë deri me 2 korsi 100%,
 - ii) Rrugët me tre korsi 85%,
 - iii) Rrugët me katër korsi 70%,
 - iv) Rrugët me më shumë se katër korsi 60%,
 - v) Dy trase hekurudhore dhe platformë 90%.

Neni 42 Fazat e projektimit të strukturave të transportit sipas tipologjisë së shërbimit

1. Shërbimet që lidhen me fazat e projektimit të strukturave të transportit, janë të përmbledhura në 9 faza dhe llogariten në bazë të përqindjeve të tarifave, të listuar në Nenin 43, në vijim:

Nr.	Fazat e shërbimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale	
			Per Grupin Tarifor I~III	Per Grupin Tarifor IV~V
1	Faza e I-rë	Analiza e detyrës së projektimit/ terma reference dhe përcaktimi i bazës së projektit	2%	2%
2	Faza e II-të	Projekt ideja paraprake	10%	15%
3	Faza e III-të	Projekt ideja përfundimtare	20%	20%
4	Faza e IV-ët	Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit	5%	5%
5	Faza e V-të	Projekti i zbatimit	20%	20%
6	Faza e VI-të	Preventivi përfundimtar	10%	10%
7	Faza e VII-të	Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi	5%	5%
8	Faza e VIII-të	Mbikëqyrja	25%	20%
9	Faza e IX-të	Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar për kolaudim	3%	3%

Tabela. 3 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për strukturat e transportit.

2. Nenet 27 dhe 28, pika 2, të zbatohen në përputhje me rrethanat.

Neni 43

Shërbimet për planifikimin e strukturave të transportit sipas tipologjisë së shërbimit

1. Analiza e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit: Gjetja e kushteve për zgjidhjen e detyrës nëpërmjet planifikimit.
2. Projektide paraprake: (Përgatitja e projektit dhe planifikimit) Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit.
3. Projekt ideja përfundimtare: (planifikimi i sistemit dhe i integritit) Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.
4. Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.
5. Projekti i zbatimit: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.
6. Preventivi përfundimtar: Llogaritja e sasive dhe hartimi i dokumentave të tenderit.
7. Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi: Përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor sipas kritereve të prokurimit.
8. Mbikëqyrja: Mbikëqyrja e punimeve nëpërmjet shërbimit të kontrollit të mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, rregullat teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij.
9. Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar për kolaudim: Mbikëqyrje dhe rregullimi i mangësive dhe dokumentimi i rezultatit të përgjithshëm.

Neni 44

Tabela e tarifave për shërbimet në lidhje me strukturat e transportit

1. Tabela e mëposhtme e tarifimit përcakton tarifatat minimale dhe maksimale për shërbimet lidhur me strukturat e transportit të përcaktuara në nenin 42 me fushëveprimi të përcaktuar në nenin 40.

KOSTOT E LLOGARITSHME LEKE	GRUPI TARIFOR I		GRUPI TARIFOR II		GRUPI TARIFOR III		GRUPI TARIFOR IV		GRUPI TARIFOR V	
	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %
3,579,100	5.92	7.43	7.43	8.95	8.95	10.48	10.48	12.00	12.00	13.51
4,200,000	5.74	7.18	7.18	8.63	8.63	10.08	10.08	11.52	11.52	12.97
4,900,000	5.56	6.95	6.95	8.34	8.34	9.72	9.72	11.11	11.11	12.49
5,600,000	5.41	6.74	6.74	8.08	8.08	9.41	9.41	10.75	10.75	12.09
6,300,000	5.28	6.57	6.57	7.87	7.87	9.16	9.16	10.45	10.45	11.74
7,000,000	5.17	6.42	6.42	7.68	7.68	8.93	8.93	10.18	10.18	11.43
10,500,000	4.75	5.86	5.86	6.98	6.98	8.09	8.09	9.20	9.20	10.31
14,000,000	4.48	5.50	5.50	6.52	6.52	7.54	7.54	8.56	8.56	9.58
21,000,000	4.11	5.01	5.01	5.91	5.91	6.81	6.81	7.70	7.70	8.60
28,000,000	3.85	4.67	4.67	5.49	5.49	6.32	6.32	7.14	7.14	7.96
35,000,000	3.66	4.42	4.42	5.18	5.18	5.95	5.95	6.71	6.71	7.47
42,000,000	3.50	4.22	4.22	4.94	4.94	5.65	5.65	6.37	6.37	7.09
49,000,000	3.37	4.05	4.05	4.73	4.73	5.41	5.41	6.09	6.09	6.76
56,000,000	3.25	3.90	3.90	4.55	4.55	5.20	5.20	5.84	5.84	6.49
63,000,000	3.15	3.77	3.77	4.39	4.39	5.01	5.01	5.63	5.63	6.25
70,000,000	3.06	3.66	3.66	4.25	4.25	4.85	4.85	5.44	5.44	6.04
105,000,000	2.70	3.20	3.20	3.71	3.71	4.21	4.21	4.71	4.71	5.22
140,000,000	2.43	2.87	2.87	3.31	3.31	3.75	3.75	4.20	4.20	4.64
210,000,000	2.24	2.63	2.63	3.02	3.02	3.41	3.41	3.80	3.80	4.19
280,000,000	2.12	2.48	2.48	2.83	2.83	3.19	3.19	3.55	3.55	3.90
350,000,000	2.03	2.36	2.36	2.70	2.70	3.03	3.03	3.36	3.36	3.70
420,000,000	1.96	2.27	2.27	2.59	2.59	2.91	2.91	3.22	3.22	3.54
490,000,000	1.90	2.20	2.20	2.50	2.50	2.81	2.81	3.11	3.11	3.41
560,000,000	1.85	2.14	2.14	2.43	2.43	2.72	2.72	3.01	3.01	3.30
630,000,000	1.81	2.09	2.09	2.37	2.37	2.65	2.65	2.93	2.93	3.21
700,000,000	1.77	2.04	2.04	2.32	2.32	2.59	2.59	2.86	2.86	3.13
1,050,000,000	1.64	1.88	1.88	2.12	2.12	2.35	2.35	2.59	2.59	2.83
1,400,000,000	1.55	1.77	1.77	1.99	1.99	2.21	2.21	2.42	2.42	2.64
2,100,000,000	1.43	1.63	1.63	1.82	1.82	2.01	2.01	2.20	2.20	2.39
2,800,000,000	1.36	1.53	1.53	1.71	1.71	1.88	1.88	2.06	2.06	2.23
3,500,000,000	1.30	1.46	1.46	1.63	1.63	1.79	1.79	1.95	1.95	2.11
3,579,043,160	1.29	1.46	1.46	1.62	1.62	1.78	1.78	1.94	1.94	2.10

Tabela. 12 Tabela shoqëruese e tarifave - Strukturat e transportit (Qarkullimi)

2. Përcaktimi i grupit tarifar, të shërbimit, bëhet sipas vlerësimit të shkallës së vështirësisë së kritereve të mëposhtme:
 - i) Faktorët gjeologjikë dhe të nëntokës (formacione të qëndrueshme, formacione mesatarisht të qëndrueshme, formacione të dobëta, formacione shumë të dobëta. Kjo duhet të vlerësohet në përqindje për të gjithë gjatësinë e objektit.) ;

- ii) Veprat e artit (rikonstruksione apo ndërtime të reja, numri i urave me gjërësi deri në 10 m, mbi 10 m, lartësia e urave, vepra arti etj.);
 - iii) Integrimi i projektit në mjedisin e tij ose përreth (fushore, kodrinore, malore me apo pa bimësi dhe/ose pengesa të tjera);
 - iv) Shkalla e vështirësisë së zonave funksionale dhe/ose kërkesat konstruktive dhe teknike (në varësi të gjatësisë së rrugës automobilistike apo hekurudhore në përqindje e cila kalon në zona urbane rurale, 0% deri në 5%, 5% deri në 10%, 10% deri në 20%, mbi 20% në rikonstruksion apo ndërtim të ri. Kërkesa për bypasse). ;
 - v) Kushte të specializuara (studime apo punime për mbrojtjen e ambjentit, kryqëzime në nivel apo disnivel, mbrojtje definitive apo provizore të skarpatave në gjërmim, drenazhime dhe ose parashikimin e rrjeteve të ndryshme infrastrukturore për rikonstruksione apo ndërtime të reja.).
3. Kur kriteret e vlerësimit janë të zbatueshme, përmes shumës së një grupi tarifor të strukturave të transportit dhe qarkullimit, atëherë është e nevojshme për të përcaktuar pikat e llogaritjes, siç përshkruhet në paragrafin 4, në vijim.
- Objekti klasifikohet në grupet e mëposhtme tarifore, në bazë të shumës së pikave të vlerësimit:

- i) Grupi I tarifor: deri në 10 pikë;
- ii) Grupi II tarifor: me 11-17 pikë;
- iii) Grupi III tarifor: me 18-25 pikë;
- iv) Grupi IV tarifor: me 26-33 pikë;
- v) Grupi V tarifor: me 34-40 pikë.

4. Me qëllim, përcaktimin e punëve inxhinierike, për përcaktimin e grupit tarifor, të cilat shprehin shkallën e vështirësisë së kërkesave që duhet të përmbushen nga inxhinieri, duhet të përcaktohen në kriteret e vlerësimit, si më poshtë:

Sipas pikës 2

- pika i), ii) deri në 5 pikë;
- pika iii) deri në 15 pikë;
- pika iv) deri në 10 pikë;
- pika v), deri në 5 pikë.

Neni 45 **Grupet tarifore dhe klasifikimi i tyre**

Strukturat e mëposhtme, zakonisht i caktohen grupeve tarifore si vijon:

i. Grupi I tarifor:

Objekte me kërkesa shumë të vogla planifikimi, ku hyjnë:

- a) Rrugë në terren fushor ose me pak thyerje me kushte të thjeshta kullimi të ujërave, përjashtoj rrugët që nuk kanë hyrje në rrugët për qarkullimin e rregullt të automjeteve me kushte të thjeshta kullimi të ujërave, si dhe rrugë të tjera dhe sipërfaqe të përforcuara, që planifikohen si element kompozimi për komplekse në natyrë të hapur dhe për të cilat nuk kërkohen shërbime sipas Kreut III, Seksionin III, sipërfaqe të thjeshta qarkullimi, sheshe parkimi në zona të jashtme.
- b) Shina dhe platforma stacionesh treni pa ndërrues dhe kryq, përderisa nuk përmenden në grupin tarifor II deri V.

ii. Grupi II tarifor:

Objekte me kërkesa të vogla planifikimi, ku hyjnë:

- a) Rrugë në terren të thyer në kushte të thjeshta të terrenit dhe të kullimi të ujërave, përjashtoj rrugët që nuk kanë hyrje në rrugët për qarkullimin e rregullt të automjeteve me kushte të thjeshta kullimi të ujërave, si dhe rrugë të tjera dhe sipërfaqe të përforcuara, që planifikohen si element kompozimi për komplekse në natyrë të hapur dhe për të cilat nuk kërkohen shërbime sipas Kreut III, Seksionin III;
- b) Rrugë jashtë qendrës së banuar pa pika të veçanta detyruese ose në terren pak të thyer; pika furnizimi të automjeteve dhe qendra të thjeshta pushimi buzë rrugëve, rrugë midis fqinjëve dhe rrugë të gjera në zonat e ndërtimeve të reja;
- c) Sheshe parkimi brenda qendrave të banuara;
- ç) Pika nryje të thjeshta në të njëjtën lartësi;
- d) Shina në sipërfaqe pa pika të veçanta detyruese, shina në sipërfaqe në terren pak të thyer, shina dhe platforma stacioni të stacioneve të trenit me plane të thjeshta korsish;
- dh) sipërfaqe komunikacioni të thjeshta për ulje mjeteve të udhëtimit ajror, terrene për aeronautikë.

iii. Grupi III tarifor:

Objekte me kërkesa mesatare planifikimi, ku hyjnë:

- a) Rrugë në terren të thyer në kushte të vështira të terrenit dhe të kullimi të ujërave, rrugë jashtë qendrave të banimit me pika të veçanta detyrimi ose në terren të thyer;
- b) Pika të vështira furnizimi të automjeteve dhe qendra të vështira pushimi buzë rrugëve; rrugë dhe sheshe brenda qendrave të banimit, përderisa nuk përmenden në grupin tarifor II, IV ose V;
- c) Zona të kontrollit të trafikut me përjashtim të projektimit të sipërfaqeve të lira dhe gjelbërimit për zonat këmbësore;
- ç) Kryqëzimet në një nivel, të thjeshta dhe në disa nivele, zonat me trafik dhe ato me trafik kamionësh;

- d) Hekurudha urbane të papërmendura në grupin tarifor IV;
- dh) Hekurudha në zona rurale pa kushte të veçanta;
- e) Hekurudha në zona rurale në terren kodrinor;
- ë) Hekurudha dhe platforma me shina, në plane lëvizje të komplikuar;
- f) Sipërfaqe komunikacioni të vështira për ulje mjetesh të udhëtimit ajror, spërfaqe të thjeshta qarkullimi për aeroporte.

iv. Grupi IV tarifor:

Objekte me kërkesa mbi mesatare planifikimi, ku hyjnë:

- a) Rrugë jashtë qendrave të banimit me një numër të madh pikash detyruese të veçanta ose në një terren shumë të thyer, përderisa nuk përmenden në grupin tarifor V;
- b) Rrugë dhe sheshe brenda qendrave të banimit me kërkesa të larta teknike të qarkullimit ose në pozicione të vështira urbanistike si dhe zona të krahasueshme të qeta nga qarkullimi, përjashtojë kompozim të sipërfaqes së sipërme dhe mbjellje me bimë për zona këmbësorësh sipas nenit 10; pika nyje shumë të vështira në të njëjtën lartësi;
- c) Pika nyje të vështira në lartësi të ndryshme;
- ç) Sipërfaqe qarkullimi për ngarkim-shkarkim në qarkullimin e kombinuar tokësor të mallrave;
- d) Shina të vështira brenda qendrave të banuara;
- dh) Shina në sipërfaqe me pika të shumta detyruese të veçanta;
- e) Shina në sipërfaqe në terren shumë të thyer, shina dhe platforma stacioni të stacioneve të trenit me plane shumë të vështira korsish;
- ë) Sipërfaqe të vështira qarkullimi për aeroporte.

v. Grupi V tarifor:

Objekte me kërkesa shumë të larta planifikimi, ku hyjnë:

- a) Rrugë të vështira malore, rrugë dhe sheshe të vështira brenda qendrave të banimit me kërkesa shumë të larta teknike dhe përsa i përket qarkullimit ose në situata shumë të vështira urbanistike;
- b) Pika nyje shumë të vështira në lartësi të ndryshme;
- c) Shina shumë të vështira brenda qendrave të banimit.

KREU IV PROJEKTET SPECIFIKE

SEKSIONI I
PROJEKTIMI I STRUKTURAVE ME AFTËSI MBAJTËSE

Neni 46
Fusha e veprimit

Strukturat e aftësisë mbajtëse janë:

1. Punimet e gërmimit;
2. Punimet e muraturës;
3. Punime betoni dhe betonarme;
4. Punime të gurit natyral;
5. Punime të gurit sintetik;
6. Struktura karpentierie dhe druri;
7. Punime për stuktura çeliku;
8. Struktura mbajtëse dhe element mbajtës strukturor të ndyshëm nga ato të cituara më sipër;
9. Punime përfundimtare për izolim;
10. Punime hidroizolimi dhe mbulim çatie;
11. Punime hidraulike;
12. Punimet me materiale metalike dhe punimet për montimin e strukturave mbajtëse (skeleri);
13. Punime gërmimi përveç punimeve për marjen e proves për studimin e strukturës së tokës;
14. Punime për përforcimin e faqeve të gropës së themeleve;
15. Depozitim dhe sistemim materialesh;
16. Punime drenazhimi.

Neni 47
Parimet e tarifave

1. Kostot e llogaritshme të ndërtesave dhe strukturave komplekse të lidhura me strukturën bazë janë 55% të kostos së ndërtimit dhe 10% të kostos së ndërtimit janë paisjet teknike.
2. Kostot e llogaritshme në veprat inxhinierike janë kostot e plota për strukturat e përcaktuara në nenin 48 të këtij manuali, duke përfshirë edhe kostot e sistemimit të sheshit të ndërtimit.
3. Nëse aplikohet pika 2 në koston e llogaritshme nuk përfshihen punimet sa më poshtë:
 - i) Përgatitja e sheshit të ndërtimit,
 - ii) Nivelimi i sheshit të ndërtimit,
 - iii) Kostot shtesë për punime të jashtëzakonshme për hapje pusesh,
 - iv) Hapje e gropash në formë tubi pa strukturë mbajtëse,
 - v) Muret jombajtëse me gjerësi më pak se 12 centimetra,
 - vi) Pllakë betonarme jombajtëse në tabanin e themelit,
 - vii) Kostot shtesë për procese të veçanta, si të çatave, beton i pastër ose veshje fasadash,

- viii) Masa mbrojtëse për punimet nga kushtet atmosferike, si sistemet për mbrojtjen nga ngricat dhe ndikimeve të tjera,
 - ix) Punimet e rifiniturës së një ndërtese, (punime të gurit natyror, punime të gurit sintetik, struktura mbajtëse druri, punime për stukturat metalike dhe punime hidraulike).
 - x) Shërbimet mbështetëse të ndërtimit.
4. Kostot e llogaritshme, për strukturat mbajtëse, në punimet inxhinierike, përfshijnë kostot e punimeve dhe kostot e lidhura me shërbimet në vend.
Kur komponentet strukturorë përdoren rishtazi, aplikohen vlera të reja në çdo rast.
5. Për përcaktimin e kostove, palët kontraktuese në rastin e privatit me privat, bien dakord për një pjesë ose tërësinë e kostove të punimeve jo të përfshira në pikën 1 dhe kostove të listuara në pikën vii/2 , e në rastin e ndërtesave, kostot e listuara në pikën xi~xiv / 1, janë të përfshira për rastet kur ofruesi i shërbimit, kryen aktivitete shtesë, në lidhje me strukturat mbajtëse, sipas përcaktimeve të Nenit 49 në vlerësimin e punimeve të mësipërme.

Neni 48

Fazat e projektimit të strukturave mbajtëse

1. Tipologjia e shërbimet themelore, në lidhje me planifikimin e strukturave mbajtëse për ndërtesat, strukturat ndihmëse, të lidhura me to, si dhe për punët inxhinierike në Nenin 34, pikat 1-5, janë të përmbledhura në Fazën I-rë deri në të VI-të, të shërbimit, ndërsa për punët inxhinierike, siç përshkruhet në nenin 34, pikat 6 dhe 7, në Fazën II-rë deri në tëVI-të dhe vlerësohen si normë përqindje ndaj tarifave të specifikuara në nenin 50:

Nr.	Fazat e projektimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e I-rë	Analiza e detyrës së projektimit/termat e referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit	3%
2	Faza e II-të	Projekt idea paraprake	10%
3	Faza e III-të	Projekt idea përfundimtare	12%
4	Faza e IV-ërt	Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit	30%

5	Faza e V-të	Projekti i zbatimit	42%
6	Faza e VI-të	Preventivi përfundimtar	3%

Tabela. 13 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për strukturat me aftësi mbajtëse.

Shërbimet themelore të Fazës I-rë, për veprat inxhinierike, siç përcaktohet në nenin 34, pika 6 dhe 7, janë përfshirë në tipologjinë e shërbimit për punimet inxhinierike, seksioni III, të përshkruara në nenin 36.

Pavarësisht nga pika 1, Faza V-të, duhet të tarifohen në 26% të tarifës së përcaktuar në nenin 50, për:

- i) Punime betonarmeje, kur ofruesit të shërbimit nuk i jepet detyra për të vizatuar betonforma (kallëpe);
 - ii) Strukturat metalike kur ofruesit të shërbimit nuk i kërkohet të verifikojë vizatimet për përputhshmërinë, me realizimin e projektit dhe vizatimet e zbatimit, faza V-të.
 - iii) Punimet e strukturave të drurit me vështirësi implementimi më pak se mesatarja.
2. Nenet 27 dhe 28, pika 2, zbatohen respektivisht.

Neni 49

Shërbimet për planifikimin e strukturve mbajtëse

1. Faza I e shërbimit: Analiza e detyrës së projektimit/ termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit

Shërbimet bazë.

Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit/termave të referencës, për fushat specifike të strukturave mbajtëse. E rëndësishme në këtë fazë është konsultimi me inxhinierët dhe arkitektët e projektit.

2. Faza II e shërbimit: Projekt idea paraprake (përgatitja e bazave të projektit dhe përgatitja për projektim).

i. Shërbimet bazë.

- a) Për projekte të veprave inxhinierike, siç përcaktohet në nenin 34, pika 6 dhe 7: ndërthurja e rezultateve sipas fazës I të shërbimit;
- b) Këshillim për çështje të projektimit të strukturës mbajtëse, duke marrë parasysh kërkesat mbi stabilitetin, funksionin dhe koston;
- c) Konsultë në pikëpamjen statiko-konstruktive duke patur parasysh problemet e qëndrueshmërisë, aftësisë për t'u përdorur dhe rentabilitetin ekonomik.
- ç) Bashkëveprim për përpunimin e një koncepti planifikimi, përfshirë studimin e

zgjdhjeve të mundshme alternative të strukturës mbajtëse me kërkesa të njëjta të objektit me paraqitje vizatimore. Sqarimi dhe dhënia përcaktimeve konstruktive kryesore për strukturën mbajtëse p. sh. për materialet e ndërtimit, mënyrat e ndërtimit dhe procedurat e prodhimit, rrjetat e konstruksionit dhe llojin e themelit-bazamentit.

- d) Negociatat paraprake me autoritetet lokale dhe specialistë të tjerë të përfshirë në projekt në lidhje me pajtueshmërinë dhe kushtet e miratimit;
- dh) Ndhurma në llogaritjen e kostos paraprake edhe në rastin e ndërtesave dhe objekteve strukturore.
- ii) Shërbime të veçanta
 - a) Hartimi i llogaritjeve krahasuese për disa mundësi zgjidhjesh nën kushte të ndryshme të objektit.
 - b) Përpilimi i një plani të ngarkesës , p.sh. si bazë për vlerësimin e trullit të ndërtimit dhe konsultën për bazamentin.
 - c) Llogaritje paraprake e verifikueshme e pjesëve themelore mbajtëse.
 - ç) Llogaritje paraprake e verifikueshme e bazamentit.

3. Faza III e shërbimit: Projekt idea përfundimtare(sistemet dhe integrimi i tyre në projekt)

i. Shërbimet bazë

- a) Zhvillimi i strukturës mbajtëse duke marrë parasysh planet e propozuara nga specialistët, si pjesë përbërëse për hartimin e projektit idesë përfundimtare, përfshirë këtu edhe paraqitjen grafike;
- b) Llogaritjet statike dhe matjet e përafërta;
- c) Përcaktime themelore të detajeve konstruktive dhe dimensioneve kryesore të strukturës mbajtëse për kompozimin e prerjeve tërthore mbajtëse, sipërfaqet e lira dhe lidhjet e mureve; zhvillimi i trarëve mbështetës të çatisë dhe pikave nyje si dhe e mjeteve lidhëse.
- ç) Bashkëpunimi në përshkrimin e objektit;
- d) Bashkëpunimi në negociatat me autoritetet lokale dhe specialistë të tjerë të përfshirë në projekt në lidhje me kushtet e miratimit;
- dh) Ndhurma me llogaritjen e kostos edhe në rastin e ndërtesave dhe impianteve strukturore;
- e) Ndhurma gjatë kontrollit të kostos duke krahasuar koston paraprake me koston e llogaritur.

ii) Shërbime të veçanta

- a) Llogaritje e parapëlqyer, e verifikueshme dhe e përshtatshme për zbatim e pjesëve kryesore mbajtëse.
- b) Llogaritje e parapëlqyer, e verifikueshme dhe e përshtatshme për bazamentin.
- c) Sasia e punës shtesë në mënyrë të veçantë të ndërtimit ose konstruksioneve të

veçanta, p.sh. sqarimi i detajeve konstruktive.

- ç) Llogaritja e parapëlqyer e sasive të çelikut dhe drurit e strukturës mbajtëse dhe e pjesëve lidhëse që transmetojnë forcën, për një tenderim, i cili zhvillohet pa paraqitjen e dokumentave të zbatimit.
- d) Raporti gjeologjik dhe sizmik.

4. Faza IV e shërbimit: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

i. Shërbimet bazë:

- a) Përmbledhja e llogaritjeve statike të verifikueshme për konstruksionin mbajtës duke patur parasysh kërkesat e dhëna e përshkruara në ligjet dhe normat në fuqi;
- b) Veprat inxhinierike: Përshkrimi i kushteve normale të realizimit;
- c) Përgatitja e planeve të strukturave mbajtës, i planeve të kollonave, përcaktimi i llojit dhe cilësisë së materialeve të ndërtimit dhe cilësitë e konstruksioneve të veçanta të dhëna në vizatimet e projektit të planifikuesit të objektit.
- ç) Grumbullimi i dokumentave të planifikimit të strukturës mbajtëse për miratimin që shërben si bazë edhe për mbikëqyrjen e ndërtimit.
- d) Negocimi me qëndrat (struktura) e testimit dhe inxhinierë që merren me testimin e objektit;
- dh) Plotësimi dhe rregullimi i llogaritjeve dhe planeve.
- e) Kompletimi dhe ndryshimi i llogaritjeve dhe vizatimeve.

ii. Shërbimet e veçanta

- a) Raporti për mbrojtjen nga zjarri.
- b) Llogaritje statike dhe paraqitje vizatimore për sigurimin e dëmeve në sipërfaqe, përderisa këto punë e tejkalojnë atë që është parashikuar në rrethanat ndërtimore normale.
- c) Vizatime me pozicione statike dhe dimensione të strukturës mbajtëse, me prerrjet tërthore përforcuese, ngarkesat e qarkullimit dhe llojin dhe cilësinë e materialeve të ndërtimit si dhe të veçantat e konstruksioneve për tu paraqitur ne kontrollin mbikëqyrës të ndërtimit në vend të planeve të pozicioneve.
- ç) Përfshirja e gjendjeve të ndërtimit në veprat ndërtimore inxhinierike, në të cilat sistemi statik devijon nga ai i gjendjes përfundimtare.

5. Faza V e shërbimit: Projekti i zbatimit

i. Shërbimet bazë

- a) Rishikimi/ripërpunimi i rezultateve të Fazës III-të dhe IV-ërt, të shërbimit duke repektuar integrimin e specialiteteve nëpërmjet planifikimit të objektit;
- b) Përgatitja e vizatimeve të betonformave/kallepëve si dhe të shtesave të

projektit arkitekturor;

- c) Paraqitje vizatimore e konstruksioneve me udhëzime për vendosjen dhe zhvendosjen, p.sh. planet e përforcimeve (betonit), planet e ndërtimit me çelik, planet e konstruksioneve prej druri (jo vizatime të studios).
- ç) Përpilimi i tabelave të hekurit ose profileve metalikë gjithashtu paraqitja e llogaritjeve të sasisë së tij.

ii. Shërbime të veçanta

- a) Vizatime të ndërtimeve me elementë çeliku dhe druri përfshirë listën e profileve, planimetri të elementëve për pjesë të parapërgatitura prej çeliku përfshirë çelikon dhe listat e pjesëve.
- b) Llogaritja e rrugëve të shtrirjes, përcaktimi i procesit të tendosjes dhe hartimi i protokollit të tendosjes në ndërtimet me betorarme të lojit me tendosje (tërheqje) të çelikut.
- c) Punë të rëndësishme, të cilat bëhen të nevojshme si rezultat i ndryshimeve të planifikimit, për të cilat nuk është përgjegjës punëmarrësi.
- ç) Vizatime karabinaje në ndërtimin me betonarme, të cilat në kantierin e ndërtimit nuk kanë nevojë për plotësim nëpërmjet planeve të planifikuesit të objektit.

6. Faza VI e shërbimit: Preventivi përfundimtar

i. Shërbimet bazë

- a) Përcaktimi i sasisë së hekurit të armimit të nevojshëm për beton / armenë, sasinë e hekurit, dhe sasinë e drurit për teknikat e kornizave si një kontribut për llogaritjet e sasisë nga ana e projektuesit;
- b) Llogaritja e përafërt për sasinë e hekurit dhe lidhjet statikisht të nevojshme për ndërtimet me strukturë druri dhe mjeteve lidhëse dhe përforcuese të kërkuara nga ana statike në ndërtimet inxhinierike prej druri.
- c) Përcaktimet dhe specifikimet e projektit për të plotësuar llogaritjet sasiore si një bazë për preventivin për strukturën mbajtëse.

ii. Shërbime të veçanta

Kontribut për përpilimin e përmbledhjeve krahasuese të shpenzimeve të strukturës mbajtëse.

Neni 50

Tabela e tarifave për shërbimet në lidhje me projektimin e strukturave mbajtëse

Tabela e mëposhtme specifikon normat e tarifave minimale dhe maksimale për shërbimet, në lidhje me projektimin e strukturave mbajtëse, të listuar në nenin 48.

KOSTO E LLOGARITSHME LEKE	GRUPI TARIFOR I			GRUPI TARIFOR II			GRUPI TARIFOR III			GRUPI TARIFOR IV			GRUPI TARIFOR V		
	Nga %	Deri %	Nga %	Nga %	Deri %	Nga %	Nga %	Deri %	Nga %	Nga %	Deri %	Nga %	Nga %	Deri %	Nga %
1,431,640	4.03	4.70	4.70	6.34	8.31	8.31	8.31	9.97	9.97	9.97	9.97	9.97	10.62	10.62	10.62
2,100,000	3.78	4.38	4.38	5.86	7.64	7.64	7.64	9.12	9.12	9.12	9.12	9.12	9.72	9.72	9.72
2,800,000	3.59	4.14	4.14	5.52	7.17	7.17	7.17	8.56	8.56	8.56	8.56	8.56	9.11	9.11	9.11
3,500,000	3.44	3.96	3.96	5.27	6.83	6.83	6.83	8.14	8.14	8.14	8.14	8.14	8.66	8.66	8.66
4,200,000	3.34	3.83	3.83	5.07	6.57	6.57	6.57	7.81	7.81	7.81	7.81	7.81	8.31	8.31	8.31
4,900,000	3.25	3.73	3.73	4.92	6.35	6.35	6.35	7.54	7.54	7.54	7.54	7.54	8.02	8.02	8.02
5,600,000	3.16	3.63	3.63	4.78	6.17	6.17	6.17	7.32	7.32	7.32	7.32	7.32	7.78	7.78	7.78
6,300,000	3.10	3.55	3.55	4.67	6.01	6.01	6.01	7.13	7.13	7.13	7.13	7.13	7.58	7.58	7.58
7,000,000	3.04	3.48	3.48	4.57	5.87	5.87	5.87	6.96	6.96	6.96	6.96	6.96	7.40	7.40	7.40
10,500,000	2.83	3.22	3.22	4.20	5.37	5.37	5.37	6.35	6.35	6.35	6.35	6.35	6.74	6.74	6.74
14,000,000	2.69	3.05	3.05	3.96	5.05	5.05	5.05	5.95	5.95	5.95	5.95	5.95	6.31	6.31	6.31
21,000,000	2.50	2.82	2.82	3.64	4.62	4.62	4.62	5.43	5.43	5.43	5.43	5.43	5.76	5.76	5.76
28,000,000	2.37	2.67	2.67	3.43	4.34	4.34	4.34	5.09	5.09	5.09	5.09	5.09	5.39	5.39	5.39
35,000,000	2.28	2.56	2.56	3.27	4.13	4.13	4.13	4.84	4.84	4.84	4.84	4.84	5.13	5.13	5.13
42,000,000	2.20	2.48	2.48	3.16	3.97	3.97	3.97	4.65	4.65	4.65	4.65	4.65	4.92	4.92	4.92
49,000,000	2.14	2.40	2.40	3.06	3.84	3.84	3.84	4.49	4.49	4.49	4.49	4.49	4.75	4.75	4.75
56,000,000	2.09	2.34	2.34	2.97	3.73	3.73	3.73	4.36	4.36	4.36	4.36	4.36	4.61	4.61	4.61
63,000,000	2.05	2.29	2.29	2.90	3.63	3.63	3.63	4.24	4.24	4.24	4.24	4.24	4.49	4.49	4.49
70,000,000	2.01	2.25	2.25	2.84	3.55	3.55	3.55	4.14	4.14	4.14	4.14	4.14	4.38	4.38	4.38
105,000,000	1.87	2.08	2.08	2.61	3.25	3.25	3.25	3.78	3.78	3.78	3.78	3.78	3.99	3.99	3.99
140,000,000	1.77	1.97	1.97	2.46	3.05	3.05	3.05	3.54	3.54	3.54	3.54	3.54	3.74	3.74	3.74
210,000,000	1.65	1.83	1.83	2.27	2.79	2.79	2.79	3.23	3.23	3.23	3.23	3.23	3.41	3.41	3.41
280,000,000	1.57	1.73	1.73	2.14	2.62	2.62	2.62	3.03	3.03	3.03	3.03	3.03	3.19	3.19	3.19
350,000,000	1.51	1.66	1.66	2.04	2.50	2.50	2.50	2.88	2.88	2.88	2.88	2.88	3.04	3.04	3.04
420,000,000	1.46	1.60	1.60	1.97	2.40	2.40	2.40	2.77	2.77	2.77	2.77	2.77	2.91	2.91	2.91
490,000,000	1.42	1.56	1.56	1.91	2.32	2.32	2.32	2.67	2.67	2.67	2.67	2.67	2.81	2.81	2.81
560,000,000	1.38	1.52	1.52	1.85	2.26	2.26	2.26	2.59	2.59	2.59	2.59	2.59	2.73	2.73	2.73
630,000,000	1.35	1.48	1.48	1.81	2.20	2.20	2.20	2.53	2.53	2.53	2.53	2.53	2.66	2.66	2.66
700,000,000	1.33	1.46	1.46	1.77	2.15	2.15	2.15	2.47	2.47	2.47	2.47	2.47	2.59	2.59	2.59
1,050,000,000	1.23	1.35	1.35	1.63	1.97	1.97	1.97	2.25	2.25	2.25	2.25	2.25	2.36	2.36	2.36
1,400,000,000	1.17	1.28	1.28	1.54	1.85	1.85	1.85	2.11	2.11	2.11	2.11	2.11	2.21	2.21	2.21
2,100,000,000	1.09	1.18	1.18	1.42	1.69	1.69	1.69	1.93	1.93	1.93	1.93	1.93	2.02	2.02	2.02
2,147,425,840	1.09	1.18	1.18	1.41	1.69	1.69	1.69	1.92	1.92	1.92	1.92	1.92	2.01	2.01	2.01

Tabela. 14 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 50, pika 1 – Strukturat mbajtëse.

Neni 51 Grupet tarifore dhe klasifikimi i tyre

Grupet e tarifave për planifikimin e strukturave mbajtëse janë përcaktuar duke iu referuar shkallës të vështirësisë, bazuar në kriteret e mëposhtme të vlerësimit:

i. Grupi I tarifor:

Struktura mbajtëse, që kanë një nivel shumë të ulët vështirësie në planifikim.

Struktura të thjeshta, statikisht të caktuara prej druri, hekuri, guri ose betoni, nën

ngarkesa të përhershme, që nuk kërkojnë përforsime kundrejt forcave horizontale.

ii. **Grupi II tarifor:**

Struktura mbajtëse me një nivel të ulët vështirësie në planifikim.

- a) Struktura statikisht të caktuara, që kërkojnë llogaritje të thjeshta, jo të paratensionuara ose struktura mikse, nën ngarkesa të përhershme;
- b) Strukturat e tavanit nën ngarkesa të përhershme, të llogaritura në bazë të tabelave standarde;
- c) Strukturat e muraturës me mure mbajtëse të vazhduar deri tek themelet, që nuk kërkojnë llogaritje, për përforsime ndaj ngarkesave horizontale;
- ç) Themele pllakë dhe mure mbajtëse të një tipi të thjeshtë.

iii. **Grupi III tarifor:**

Struktura mbajtëse, që kanë një shkallë mesatare vështirësie në planifikim.

- a) Struktura mbajtëse, plane statikisht të caktuara dhe të pacaktuara, që nuk përdorin elementë të paratensionuar;
- b) Struktura mikse të thjeshta që nuk kanë nevojë për llogaritje të tkurrjeve dhe deformkohës;
- c) Struktura mbajtëse për ndërtesa me kontraventime;
- ç) Struktura me skelet të lidhur (kontraventime diagonale);
- d) Themele me pilota;
- dh) Struktura të thjeshta të harkuara;
- e) Struktura të thjeshta tip ramë që nuk përdorin elemente të paratensionuar;
- ë) Skela të thjeshta për mbajtjen e strukturave inxhinierike;
- f) Mure mbajtës të thjeshtë të ankoruar.

iv. **Grupi IV tarifor:**

Struktura mbajtëse, që përfshijnë një nivel vështirësie në planifikim mbi mesataren.

- a) Struktura komplekse të projektimit konvencional dhe struktura mbajtëse, në llogaritjen e të cilave duhet të merren parasysh faktorët ndikues, të cilët janë të vështirë për t'u vlerësuar;
- b) Sisteme me shumë parametra të panjohur;
- c) Kapriata tre dimensionale;
- ç) Struktura horizontale me hapësira të mëdha, që llogariten si trarë;
- d) Struktura statikisht të caktuara, ku lindin forcat e brendshme dhe zhvendosje të rendit të dytë (efektet $P\Delta$);
- dh) Struktura të thjeshta të tensionuara;
- e) Struktura mbajtëse komplekse dhe struktura të larta, llogaritjet e të cilave kërkojnë përdorimin e teknikave speciale;
- ë) Struktura të përbëra që nuk janë përmendur në Grupin III ose V të tarifave;
- f) Struktura mbajtëse të rrjetëzuara të thjeshta dhe pllaka të thjeshta të brinjëzuara;
- g) Struktura mbajtëse në zona me sizmicitet deri mesatar;
- gj) Themelet pllakë statikisht të pacaktuara dhe komplekse;
- h) Themele të thella, themele me pilota, përforsime të themeleve me metoda

- speciale;
- i) Pllaka këndore me një hapësirë, për punime inxhinierike;
- j) Struktura të rrjetëzuara shumëplanëshe;
- k) Struktura të vështira tip kube;
- l) Struktura tip ramë, të papërmendura në grupet tariforë III ose V;
- ll) Skeleri të vështira për mbajtjen e veprave inxhinierike;
- m) Mure mbajtës të ankoruar;
- n) Struktura murature komplekse.

v. Grupi V tarifor:

Struktura mbajtëse që përfshijnë një nivel të lartë vështirësie në planifikim. Struktura mbajtëse, shumë të vështira nga pikëpamja statike dhe dinamike dhe me një projektim kompleks.

- a) Struktura mbajtëse të vështira, të tipeve të reja strukturore,
 - b) Trarët horizontalë tre-dimensionalë dhe kapriatat e pacaktuara tri dimensionale,
 - c) Struktura të rrjetëzuara të vështira të pacaktuara me pllaka të brinjëzuara,
 - ç) Struktura mikse të tensionuara,
 - d) Struktura mbajtëse (pllaka, disqe, membrana) të cilat kërkojnë aplikimin e teorisë të elasticitetit,
 - dh) Struktura të pacaktuara, që kërkojnë seksione speciale, nën efektet e rendit të dytë ($P\Delta$).
 - e) Struktura mbajtëse, aftësia mbajtëse e të cilave mund të vlerësohen vetëm me ndihmën e modelimeve kompjuterike, statike dhe dinamike me elementë të fundëm,
 - ë) Struktura mbajtëse në zona shumë sizmike që nuk janë përmendur në grupin e tarifave IV,
 - f) Struktura të varura të papërmendura në grupin tarifor IV,
 - g) Pllaka të vazhduara,
 - gj) Struktura të rrjetëzuara të kubëzuara ose këndore,
 - h) Struktura ramë, të vështira me elemente të tensionuar që kanë nevojë për teste të aftësisë mbajtëse,
 - i) Skeleri shumë të vështira për punime inxhinierike, p.sh. hapësira të mëdha dhe struktura të larta,
 - j) Struktura mbajtëse, ngurtësia e lidhjeve të të cilave përfshihen në llogaritje.
3. Kur kriteret e vlerësimit nuk përcaktojnë me saktësi grupin tarifor ose kur ka pasiguri se kujt grupi tarifash duhet t'i përkasë kjo strukturë, tarifa merret duke pasur parasysh, se cilit grup tarifash i përket pjesa më e madhe e kriterëve në piken 2, sikurse dhe rëndësinë e tyre për rastin specifik.

SEKSIONI II SISTEMET TEKNIKE

Neni 52

Fusha e veprimit

1. Shërbimet për sistemet teknike përfshijnë projektin teknik, si pjesë e projektit të përgjithshëm.
2. Sistemet teknike përfshijnë impiantet e mëposhtme në:
 - i) Instalimin e sistemit të gazit, ujrave të bardha dhe ujrave të zeza;
 - ii) Instalimin e sistemit të ngrohjes, prodhimit;
 - iii) Instalimin e sistemit të ventilimit;
 - iv) Instalimin e sistemit të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë;
 - v) Instalimin e sistemeve të telekomunikacionin dhe procesimin e të dhënave;
 - vi) Sistemin transportues;
 - vii) Instalimin e sistemit me një qëllim të caktuar, duke përfshirë instalimin e sistemit mekanikë dhe elektro-teknikë në objektet civile inxhinierike;
 - viii) Sistemet e automatizimit të ndërtesës;
 - ix) Sistemet matjes kontrollit transmetimit të të dhënave dhe komandimit (sistemi SCADA).

Neni 53

Parimet e tarifave

1. Tarifat për shërbimet, që kanë lidhje me sistemet teknike, vendosen duke iu referuar kostove të llogaritshme të grupit të sistemit teknik (ujë, ngrohje, instalime elektrike, etj.), siç është përcaktuar tek neni 52, pika 2.
2. Neni 11, pika 1, nuk zbatohet, nëse disa grupe impiantesh që janë të kombinuara brenda një grupi ndërtesash, siç përcaktohen në nenin 52, pika 2, ndërtohen dhe vihen në përdorim në të njëjtën kohë, si pjesë e të njëjtit projektim.
3. Kostot e pa llogaritshme, janë kostot, për lidhjen e sistemit jo-publik të impianteve të shërbimit, nëse ofruesi i shërbimit nuk i planifikon, nuk i projekton dhe nuk i mbikëqyr ato.
4. Kur pjesë të sistemeve teknike zbatohen në ndërtime, kontraktorët rregullojnë me kontratë nëse kostoja e llogaritshme do të llogaritet e plotë ose pjesërisht. Pika 1, më sipër, aplikohet në përputhje me përbërësit strukturalë të kostos së ndërtimit, ku dimensionimi, apo ndërtimi i të cilëve preket në mënyrë domethënëse nga sistemet teknike.

Neni 54

Fazat e projektimit të sistemeve teknike sipas tipologjisë

1. Tipologjia për sistemet teknike përfshin shërbimet e siguruara nga ofruesi i tyre në lidhje me sistemet e reja, rindërtime, zgjerime, shndërrime, proceset e modernizimit, të mirëmbajtjes dhe riparimet. Shërbimet që i takojnë sistemeve teknike përmbliohen, në IX-të faza dhe vlerësohen, në bazë të përqindjeve të tarifës, sipas nenit 56 në vijim.

Nr.	Fazat e projektimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e parë	Analiza e detyrës së projektimit/termat e referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit	3%
2	Faza e dytë	Projekt idea paraprake	11%
3	Faza e tretë	Projekt idea përfundimtare	15%
4	Faza e katërt	Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit	6%
5	Faza e pestë	Projekti i zbatimit	18%
6	Faza e gjashtë	Preventivi përfundimtar	6%
7	Faza e shtatë	Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi	5%
8	Faza e tetë	Mbikëqyrja	33%
9	Faza e nëntë	Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar dhe kolaudim	3%

Tabela. 4 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për sistemet teknike

2. Faza 5 e projektimit, ndryshon nga paragrafi 1 nëse ofruesi i shërbimit nuk është kontraktuar për projektimin e hapjeve të mureve dhe të pllakave të dysHEMEVE, në këtë rast llogaritet me 14% të tarifës së nenit 56.
3. Nenet 27 dhe 28, zbatohen respektivisht.

Neni 55

Shërbimet në planifikimin e sistemeve teknike

1. Faza I e shërbimit: Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit. Gjetja e kushteve për zgjidhjen teknike të detyrës nëpërmjet planifikimit.

i. Shërbime bazë.

a) Sqarimi i shtrimit të detyrës në fushën e pajisjes teknike në marrëdhëniet me porosidhënësin dhe planifikuesin e objektit, në mënyrë të veçantë në principet teknike dhe të rentabilitetit.

b) Përmbledhja e rezultateve

ii. Shërbime të veçanta

a) Analiza e sistemit (sqarimi i sistemeve të mundshme sipas dobisë, punës, rentabilitetit dhe realizueshmërisë dhe pajtueshmërisë me ambientin).

b) Përmbledhja e të dhënave, analiza dhe procese optimimi, p.sh. për kursimin e energjisë dhe pajtueshmërinë me ambientin.

2. Faza II e shërbimit: Projekt idea paraprake (përgatitja për projektim dhe për planifikim). (përgatitja e projektit dhe planifikimit) Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit.

i. Shërbime bazë.

a) Përpunimi i një koncepti të planifikimit me spjegime të përafërta të sistemeve dhe pjesëve më të rëndësishme të impianteve përfshirë studimin e zgjidhjeve të mundshme alternative sipas kërkesave të njëjta të objektit me paraqitje vizatimore për integrimin në planifikimin e objektit përfshirë parastudimin e rentabilitetit.

b) Hartimi i një skeme të funksionimit ose figure të vënies në funksionim të çdo impianti.

c) Sqarimi dhe spjegimi i lidhjeve themelore specifike të fushës, proceseve dhe kushteve.

ç) Bashkëpunim në bisedimet paraprake me autorite dhe të tjerë, që marrin pjese profesionalisht në planifikimin e aftësisë për t'u miratuar.

d) Bashkëveprim për vlerësimin e shpenzimeve.

dh) Grumbullimi i rezultateve të paraplanifikimit.

ii. Shërbime të veçanta

a) Përpunimi i të dhënave për planifikimin e të tretëve, p.sh. për teknikën qendrore

të dritës.

b) Dëshmi e detajuar për rentabilitetin ekonomik.

c) Krahasim i detajuar për emisionet e lëndëve të dëmshme.

ç) Llogaritjet e shpenzimeve të prodhimit.

d) Llogaritjet e emisioneve të lëndëve të dëmshme.

dh) Hartimi i pjesës teknike të një libri të hapësirës si kontribut për përshkrimin e punës të planifikuesit të objektit.

3. Faza III e shërbimit: Projektidea përfundimtare (sistemet dhe integrimi i tyre në projekt)

i. Shërbime bazë

a) Përpunimi i konceptit të planifikimit (përpunimi hap pas hapi i një zgjidhjeje vizatimore) duke patur parasysh të gjitha kërkesat specifike të fushës si dhe duke respektuar të gjitha planifikimet e specialitetit të integruara në planifikimin e objektit deri në projekt-idene e plotë.

b) Përcaktimi i të gjitha sistemeve dhe pjesëve të Impianteve.

c) Llogaritja dhe matja si dhe paraqitja vizatimore e të përshkrimit të impianteve.

ç) Dhënia dhe akordimi i të gjitha veprimeve të nevojshme për planifikimin e strukturës mbajtëse dhe të dhënat për ngarkesëm (pa përgatitjen e planit çarjeve dhe prishjeve).

d) Bashkëpunim në bisedimet me autoritet dhe të tjerë, që pjesë e strukturave miratuese. Bashkëpunim në llogaritjen e shpenzimeve.

dh) Bashkëpunim në kontrollin e shpenzimeve duke krahasuar llogaritjen e shpenzimeve me vlerësimin e shpenzimeve.

4. Faza IV e shërbimit: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit.

i. Shërbime bazë

a) Përpunimi i dokumentave të nevojshme sipas dispozitave ligjore publike për lejet ose aprovimet e nevojshme përfshirë kërkesat për përjashtime dhe lirime si dhe grumbullimi i këtyre dokumentave pas bisedimeve të nevojshme me autoritetet.

b) Plotësimi dhe përshtatja e dokumentave të planifikimit , përshkrimeve dhe llogaritjeve.

ii. Shërbime të veçanta

a) Kontrolli dhe pranimi i skemave të funksionimit të planifikuesit të strukturës mbajtëse dhe vizatimeve të montimit dhe punishtes për përputhshmërinë me planifikimin,

b) Përgatitja e planeve për bashkimin e mjeteve të ndërmarrjes dhe makinave të vëna në dispozicion nga të tjerë.

c) Përgatitja e planeve të linjave elektrike.

5. Faza V e shërbimit: Projekti i zbatimit

i. Shërbime bazë

- a) Përpunimi i rezultateve të fazave të punimeve III dhe IV (përpunimi hap pas hapi i paraqitjes së zgjidhjes) duke repektuar planifikimet e specialitetit të integruara nëpërmjet planifikimit të objektit.
- b) Paraqitje vizatimore e impianteve (paisjeve) me dimensione (jo vizatime për montimin dhe punishten).
- c) Përgatitja e planeve për hapje dhe prishje.
- ç) Përditësimi dhe plotësimi i vazhdueshëm dhe i detyuar i vizatimeve

ii. Shërbimet e veçanta

- a) Kontrolli dhe pranimi i skemave të funksionimit të planifikuesit të strukturës mbajtëse dhe vizatimeve të montimit për përputhshmërinë me planifikimin,
- b) Përgatitja e planeve për bashkimin e mjeteve të ndërmarrjes dhe makinave të vëna në dispozicion nga të tretë.
- c) Përgatitja e planeve të linjave elektrike.

6. Faza VI e shërbimit: Preventivi përfundimtar

i. Shërbimet bazë

- a) Llogaritja e sasive për përgatitjen e preventivit, në kordinim me specialistët e tjerë të grupit të projektit;
- b) Përgatitja e preventivit në përputhje me planin e punës dhe në bazë të zonave të shërbimit dhe përshkrimi i detyuar i tij.

7. Faza VII e shërbimit: Përgatitja e dokumentacionit për procedurë tenderimi.

ii. Shërbime Bazë

8. Përmbledhja e dokumentave të dhënies për të gjitha fushat e punës.
9. Verifikimi dhe vlerësimi i termave të referencës përfshirë hartimin e dokumentacionit për prokurim.
10. Akordimi dhe përmbledhja e punimeve të atyre që marrin pjesë profesionalisht, të cilët bashkëpunojnë gjatë dhënies së dokumentave.
11. Llogaritja e shpenzimeve.
12. Bashkëveprim gjatë dhënies së ofertës.

13. Faza VIII e shërbimit: Mbikëqyrja³ e punimeve

i. Shërbime Bazë

- a) Mbikëqyrja kontrollon mbarëvajtjen e të gjitha procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, rregullat teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe

³ Per detyrat e mbikqyresit referohu akteve ligjore ne fuqi.

- destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anën ekonomike të tij.
- b) Hartimi dhe mbikqyrja e një grafiku punimesh.
 - c) Konstatimi i firmave zbatuese për vonesat në punime.
 - c) Marrja e punëve dhe livrimeve në bashkëpunim me mbikëqyrjen vendore dhe të tjerë që marrin pjesë profesionalisht në mbikëqyrjen objektit duke përgatitur një protokoll për rezultatin e marrjes.
 - d) Kërkesa për marrje nga ana e autoriteteve dhe pjesëmarrje në atë.
 - dh) Dorëzim i objektit përfshirë grumbullimin dhe dorëzimin e dokumentave të kërkuara, p. sh. protokollet e marrjes në dorëzim dhe kontrollet e kontrolleve.
 - e) Grumbullimi i të gjitha dispozitave të mirëmbajtjes së objektit.
 - ë) Mbikqyrja e kontrolleve për aftësinë funksionuese të pjesëve të objektit dhe e të gjithë objektit.
 - f) Lista e afateve të parashkrimit të pretendimeve nga garancitë e dhëna.
 - g) Konstatimi i shpenzimeve.
 - gj) Kontrolli i shpenzimeve.
 - h) Kontrolli i shpenzimeve duke kontrolluar llogaritë përfundimtare të punëve të sipërmarrjeve zbatuese të ndërtimit me çmimet e kontratës dhe llogaritjen në vazhdimësi të shpenzimeve.

iii. Shërbime të veçanta

- a) Kualifikimi dhe udhëzimi i personelit të shërbimit.
- b) Mbikqyrja dhe korrekturë e detajuar tek prodhuesi.
- c) Hartimi, vazhdimi i përpunimit dhe mbikqyrja e planeve të afateve. (Plani teknik përpunimi elektronik i të dhënave).
- ç) Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar për kolaudim.

14. Faza IX e shërbimit: Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar dhe përkujdesja për objektin

i. Shërbimet bazë

- a) Verifikimi me përgjegjësi për realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
- b) Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
- c) Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
- ç) Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes. Mbikqyrja konstaton mangësitë para skadimit të afateve të parashkrimit të të drejtave nga garancitë kundrejt sipërmarrjeve zbatuese.
- d) Mbikëqyrje dhe rregullim i mangësive, që shfaqen brenda afateve të parashkrimit të të drejtave nga garancitë, megjithatë e shumta deri në mbarim të jo më shumë se 2 vjetëve nga marrja në dorëzim e punëve.
- dh) Bashkëpunim në dorëzimin e punëve të sigurisë.
- e) Grumbullim sistematik i paraqitjeve vizatimore dhe rezultateve të llogarive të objektit.

ii. Shërbime të veçanta

- a) Përpunimi i planit për mirëmbajtjen dhe organizimin.
- b) Kontroll inxhiniero-teknik i harxhimit të energjisë dhe i emisioneve të lëndëve të dëmshme.

Neni 56

Tabela e tarifave për sistemet teknike

1. Tabela e tarifave në vijim, specifikon tarifat minimale dhe maksimale, sipas grupit tarifor, për shërbimet e listuara në nenin 54, sipas instalimeve individuale në ndërtesa.

KOSTOT E LLOGARITSHME LEKE	GRUPI TARIFOR I		GRUPI TARIFOR II		GRUPI TARIFOR III	
	Nga	Deri	Nga	Deri	Nga	Deri
	%	%	%	%	%	%
715,820	7.42	9.62	9.62	11.83	11.83	14.04
1,050,000	6.95	8.98	8.98	11.01	11.01	13.04
1,400,000	6.56	8.44	8.44	10.32	10.32	12.20
2,100,000	6.07	7.75	7.75	9.42	9.42	11.09
2,800,000	5.74	7.31	7.31	8.87	8.87	10.44
3,500,000	5.49	6.99	6.99	8.49	8.49	9.99
4,200,000	5.29	6.74	6.74	8.21	8.21	9.67
4,900,000	5.12	6.54	6.54	7.95	7.95	9.37
5,600,000	4.96	6.35	6.35	7.74	7.74	9.13
6,300,000	4.84	6.19	6.19	7.54	7.54	8.89
7,000,000	4.74	6.06	6.06	7.38	7.38	8.70
10,500,000	4.30	5.49	5.49	6.68	6.68	7.87
14,000,000	4.01	5.10	5.10	6.18	6.18	7.27
21,000,000	3.61	4.55	4.55	5.49	5.49	6.43
28,000,000	3.39	4.21	4.21	5.04	5.04	5.86
350,000,000	0.33	0.40	0.40	0.48	0.48	0.55
42,000,000	3.21	3.91	3.91	4.61	4.61	5.31
49,000,000	3.17	3.83	3.83	4.50	4.50	5.16
56,000,000	3.13	3.78	3.78	4.42	4.42	5.07
63,000,000	3.11	3.73	3.73	4.36	4.36	4.99
70,000,000	3.09	3.70	3.70	4.31	4.31	4.92
105,000,000	3.01	3.53	3.53	4.06	4.06	4.59
140,000,000	2.93	3.38	3.38	3.83	3.83	4.28
210,000,000	2.81	3.12	3.12	3.44	3.44	3.75
280,000,000	2.73	2.97	2.97	3.21	3.21	3.45
350,000,000	2.67	2.88	2.88	3.09	3.09	3.30
420,000,000	2.61	2.79	2.79	2.98	2.98	3.17
490,000,000	2.54	2.70	2.70	2.87	2.87	3.04
525,000,000	2.50	2.66	2.66	2.82	2.82	2.98
536,856,460	2.49	2.64	2.64	2.80	2.80	2.96

Tabela. 56 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 56, pika 1 – Sistemet teknike.

2. Përcaktimi i grupit tarifor, të shërbimit për sistemet teknike, bëhet sipas vlerësimit të shkallës së vështirësisë së kriterëve të mëposhtme:
 - i) Gama e funksioneve,
 - ii) Integrimi i kërkesave,
 - iii) Zhvillimi teknik i kërkuar,
 - iv) Kriteret inxhinierike,

- v) Kërkesat strukturale.
3. Nëse sistemet teknike mund të klasifikohen në grupe të ndryshme tarifore, atëherë tarifa, siç është përcaktuar në paragrafin 1, të këtij neni, llogaritet duke bërë shumën e tarifave të veçanta. Për instalimet, që i përkasin një grupi të veçantë tarifash, përcaktohet gjithmonë një tarifë e vetme. Për të llogaritur tarifat e veçanta, së pari llogaritet tarifa për instalimet sipas grupit tarifor, tarifën, që do të rezultonte në qoftë se, totali i kostove të llogaritshme për atë sistem teknik i përket vetëm atij grupi tarifash. Tarifa e vetme përcaktohet, më pas, duke u bazuar në raportin e kostove totale të tarifueshme të instalimeve, në një grup tarifash me totalin e kostove që tarifohen grupi i ndërtimeve.

Neni 57 **Grupet tarifore dhe klasifikimi i tyre**

Grupet tarifore të objekteve për impiantet e pajisjes teknike janë:

i. Grupi I tarifor:

- a) Sisteme për gazin, ujin, ujërat e zeza me rrjete të shkurtra dhe të thjeshta;
- b) Sisteme ngrohje me pajisje me djegie të drejtpërdrejtë dhe sisteme të thjeshta të ngrohjes qendrore, pa kërkesa të veçanta në kontroll, sisteme ajrosje të thjeshta;
- c) Struktura telekomunikacioni të thjeshta dhe me voltazh të ulët;
- ç) Sisteme me kanale të brendshme të thjeshta për hedhjen e mbeturinave ose pastrimin e rrobave, sisteme magazinimi të larta, të papërmendura në grupet tarifore II ose III;
- d) Strukturat e pastrimit kimik;
- dh) Sisteme dhe fabrika mjekësore dhe laboratorike për pajisje elektro-mjekësore, dentare, të mekanikes mjekësore, optike, si dhe për pajisje për klinika të mjekësisë së përgjithshme.

ii. Grupi II tarifor:

- a) Struktura për gazin, ujin, ujërat e zeza me rrjete komplekse tubacionesh, me ngritje mekanike dhe me presion, me alarme manuale kundra zjarrit;
- b) Sisteme të ngrohjes qendrore, me kërkesa të veçanta të rregullimit/kontrollit, sisteme të ajrosjes me kërkesa të larta në akustikë, pa korrente ajri dhe me kërkesa për trajtimin e ajrit (përveç ftohjes së ajrit të rregulluar automatikisht);
- c) Struktura kompakte, me voltazh të ulët dhe objekte shpërndarje të papërmendura në grupet tarifore I ose III, instalimet e telekomunikacionit dhe rrjetet e tyre, si: sistemet e thirrjes, të alarmit, sistemet e ndriçimit bazuar në metodën e përlllogaritjes së efikasitetit, instalimet për mbrojtjen nga rrufeja;
- ç) Platforma peshëngritëse, vinça të kontrolluar nga toka;
- d) Sistemet e raft-magazinimit, lëvizëse, modulare dhe sistemet e transportuesve me shirit lëvizës me deri në dy stacione marrje-dhënie, ashensorët e vështirë të pavarur, grupe ashensorësh të thjeshtë, pa kërkesa të veçanta, sisteme teknike peshëngritëse;

- dh) Kuzhina dhe lavanderi në madhësi mesatare;
- e) Sisteme dhe fabrika mjekësore dhe laboratorike për pajisje elektro-mjekësore, dentare, të mekanikës mjekësore, optike, si dhe sisteme nukleare dhe radiografike me rrezatim të vogël, për mjek të specializuar ose grupe klinikash, sanatoriume, shtëpi të moshuarish, si dhe pavione të thjeshta spitalësh;
- ë) Struktura laboratorike për shkolla dhe laboratorë fotografikë.

iii. Grupi III tarifor:

- a) Sisteme të prodhimit të gazit dhe stacione për rregullimin e presionit të gazit, duke përfshirë rrjetin e tubacioneve, sisteme për pastrimin dhe detoksifikimin dhe neutralizimin e ujërave të ndotura, sisteme për trajtimin fizik, biologjik dhe kimik të ujit, impiante uji për ujëra të zeza dhe kushte higjienike mbi mesataren, sisteme të automatizuara të fikjes dhe alarmit kundra zjarrit;
- b) Impiante të avullit, impiante të ujit të nxehtë, sisteme të vështira të ngrohjes qendrore bazuar në teknologji të reja, sistemet e ngrohjes me pompë, ato të ngrohjes dhe ventilimit në distancë, fabrikat frigoriferike, fabrikat e ventilimit dhe ftohjes së rregulluar dhe sisteme me ajër të kondicionuar, që përfshijnë dhe fabrikat frigoriferike;
- c) Instalimet me tension të lartë dhe të mesëm, qendra të kontrollit të tensionit të ulët, linja private të prodhimit dhe transformimit të energjisë, objektet e shpërndarjes me furnizim tensioni të ulët dhe për llogaritje të qarkut të shkurtër, sisteme të lehta bazuar në metodën e përlllogaritjes pikë për pikë, të matjes dhe kontrollit të transmetimit të të dhënave dhe komandimit, sisteme të mëdha të telekomunikacionit dhe rrjeteve të tyre;
- ç) Grupime ashensorësh me kërkesa të veçanta, sisteme të kontrolluara transportuese shirit me më shumë se dy qendra marrje dhe dhënie, makineri për furnizimin e raftëve me sistemet e tyre, sisteme qendrore për eliminimin e rrobave, mbetjeve, ose pluhurit, sisteme teknike për skena të mëdha, dysheme të levizshme dhe sistem për krijimin e dallgëve në pishina, sisteme automatike të mbrojtjes nga dielli;
- d) Kuzhina dhe lavanderi të mëdha;
- dh) Instalime mjekësore dhe laboratorike për spitale të mëdha, me dhoma trajtimi dhe ekzaminimi të specializuar, për klinika dhe institute me funksione mësimore dhe kërkimore, dhoma për kontrollimin e klimës me pajisjet përkatëse, dhoma të posaçme me temperaturë të kontrolluar dhe pa pluhur, sisteme për pasurimin ose eliminimin e substancave të veçanta, ndërmarrje të mëdha të sektorit kimik, qendra kërkimore dhe zhvillimore dhe qendra prodhimi dhe mësimi, klinika.

SEKSIONI III
SHËRBIMET QË I TAKOJNË NËNTOKËS DHE PUNIMEVE NË THEMELE

Neni 58
Parimet e tarifave

1. Shërbimet, që lidhen me kapacitetin mbajtës të tokës, punime tokësore dhe themele, janë për të regjistruar reagimet midis strukturës së tokës dhe ndërtesave, si dhe mjedisin e saj, për të përcaktuar parametrat kryesorë të strukturës së tokës të nevojshme për llogaritje.
2. Shërbimet që lidhen me kapacitetin mbajtës të tokës, punime tokësore dhe themele, në mënyrë të veçantë mund të përfshijnë:
 - i. Vlerësimi i nëntokës dhe puna konsultuese për pozicionimin e themelit, si një bazë për dimensionimin e tyre si mbajtës ngarkesash në strukturën inxhinierike, për aq sa këto shërbime nuk mund të kryhen me aplikimin e tabelave ose informacioneve të tjera, të përfshira në rregulloret e ndërtimit në fuqi;
 - ii. Mbikëqyrja dhe vlerësimi përgatitor për vendin e punës;
 - iii. Kryerja e analizave laboratorike dhe e testeve në terren;
 - iv. Këshillimi për sigurimin e strukturave ngjitur;
 - v. Dhënia e zgjidhjeve, drenazhimi dhe llogaritje të tjera statike të tokës, ku shërbime të tilla nuk janë të përfshira, nga pikën 1 më lart, ose nga shërbimet e përcaktuara në nenin 36 ose nenin 48.
 - vi. Studimet që përfshijnë tensionet dinamike në llogaritjet e ndërtesave apo themeleve;
 - vii. Këshillimi mbi masat e ndërtimit në shtresat e ngurta shkëmbore;
 - viii. Miratimi dhe pranimi i gërmimeve dhe derdhjeve;
 - ix. Vlerësimi i përgjithshëm i kapacitetit mbajtës të strukturës së tokës dhe mundësitë për themele, që nuk lidhen me një ndërtesë të veçantë ose vepra inxhinierike.

Neni 59
Fazat e projektimit të shërbimeve të nëntokës dhe punimeve në themele

1. Vlerësimet e nëntokës dhe këshillimet e punës së themeleve, siç janë përcaktuar në Neni 58, pika 2, përfshijnë shërbimet në respektim të ndërtesave dhe punëve inxhinierike.

Fazat e shërbimit dhe përqindjet përkatëse jepen në tabelën më poshtë:

Nr.	Shërbimet që i takojnë nëntokës dhe punimeve në themel	Përshkrimi	Përqindja e tarifës, në lidhje me vlerën totale
-----	--	------------	---

1	Faza I	<p>1. Qartësimi i kërkesave të projektit;</p> <p>2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipas testeve të kërkuara.</p>	15%
2	Faza II	<p>1. Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve, laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës;</p> <p>2. Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji;</p> <p>3. Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës.</p>	35%
3	Faza III	<p>1. Paraqitja e rekomandimeve për qëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themelit;</p> <p>2. Deklaratë mbi çedimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final, siç paraqitet tek neni 39;</p> <p>3. Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur.</p>	50%

Tabela. 17 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për nëntokën dhe punimet e themeleve.

2. Tarifat për shërbimet, siç tregohen në pikën 1 si më sipër, mund të përcaktohen duke iu referuar kostove të llogaritshme, grupit tarifor për të cilat janë caktuar themelet dhe tabelës së tarifave në nenin 60.
3. Kostot e llogaritshme mund të përcaktohen sipas nenit 47.
4. Nëse komisioni nuk i mbulon të gjitha shërbimet e renditura në pikën 1 të këtij neni atëherë neni 8 zbatohet në përputhje me rrethanat.
5. Tarifat për veprat e inxhinierisë, në objekte me gjatësi lineare të madhe, (psh: salla të

mëdha fabrikash) janë objekte negocimi.

6. Neni 11, pikat 1 deri në 3, të zbatohen në përputhje me rrethanat.

Neni 60

Tabela e tarifave për shërbimet që i takojnë nëntokës punimeve nën themele

Tabela e mëposhtme përcakton tarifat për shërbimet lidhur me vlerësimin e nëntokës dhe punën këshilluese për themele.

TABELA SHOQËRUESE E TARIFAVE NE LIDHJE ME VLERËSIMIN E NËNTOKËS DHE PUNIMET E THEMELIT													
KOSTOTE LLOGARITSHME LEKE	GRUPI TARIFOR I		GRUPI TARIFOR II		GRUPI TARIFOR III		GRUPI TARIFOR IV		GRUPI TARIFOR V				
	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %	Nga %	Deri %			
7,158,060	0.54	0.97	0.97	1.40	1.40	1.84	1.84	2.26	2.26	2.70			
10,500,000	0.45	0.80	0.80	1.14	1.14	1.49	1.49	1.83	1.83	2.18			
14,000,000	0.39	0.69	0.69	0.98	0.98	1.27	1.27	1.56	1.56	1.86			
21,000,000	0.32	0.56	0.56	0.79	0.79	1.02	1.02	1.25	1.25	1.48			
28,000,000	0.28	0.48	0.48	0.68	0.68	0.87	0.87	1.07	1.07	1.26			
35,000,000	0.25	0.43	0.43	0.60	0.60	0.77	0.77	0.94	0.94	1.12			
42,000,000	0.23	0.39	0.39	0.54	0.54	0.70	0.70	0.85	0.85	1.01			
49,000,000	0.22	0.36	0.36	0.50	0.50	0.64	0.64	0.78	0.78	0.93			
56,000,000	0.20	0.34	0.34	0.47	0.47	0.60	0.60	0.73	0.73	0.86			
63,000,000	0.19	0.31	0.31	0.44	0.44	0.56	0.56	0.68	0.68	0.80			
70,000,000	0.18	0.30	0.30	0.41	0.41	0.53	0.53	0.64	0.64	0.76			
105,000,000	0.15	0.24	0.24	0.33	0.33	0.42	0.42	0.51	0.51	0.61			
140,000,000	0.13	0.21	0.21	0.29	0.29	0.36	0.36	0.44	0.44	0.52			
210,000,000	0.11	0.17	0.17	0.23	0.23	0.29	0.29	0.35	0.35	0.41			
280,000,000	0.10	0.15	0.15	0.20	0.20	0.25	0.25	0.30	0.30	0.35			
350,000,000	0.09	0.13	0.13	0.18	0.18	0.22	0.22	0.27	0.27	0.31			
420,000,000	0.08	0.12	0.12	0.16	0.16	0.20	0.20	0.24	0.24	0.28			
490,000,000	0.07	0.11	0.11	0.15	0.15	0.18	0.18	0.22	0.22	0.26			
560,000,000	0.07	0.10	0.10	0.14	0.14	0.17	0.17	0.20	0.20	0.24			
630,000,000	0.06	0.10	0.10	0.13	0.13	0.16	0.16	0.19	0.19	0.22			
700,000,000	0.06	0.09	0.09	0.12	0.12	0.15	0.15	0.18	0.18	0.21			
1,050,000,000	0.05	0.07	0.07	0.10	0.10	0.12	0.12	0.14	0.14	0.17			
1,073,712,920	0.06	0.08	0.08	0.11	0.11	0.14	0.14	0.16	0.16	0.19			
2,100,000,000	0.04	0.05	0.05	0.07	0.07	0.08	0.08	0.10	0.10	0.11			
2,800,000,000	0.03	0.04	0.04	0.06	0.06	0.07	0.07	0.08	0.08	0.10			
3,500,000,000	0.03	0.04	0.04	0.05	0.05	0.06	0.06	0.07	0.07	0.09			
3,579,043,160	0.03	0.04	0.04	0.05	0.05	0.06	0.06	0.07	0.07	0.09			

Tabela. 18 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 60, pika 1 - shërbimet që i takojnë nëntokës punimeve nën themele.

Neni 61

Grupet tarifore dhe klasifikimi i tyre

Grupet tarifore për vlerësimin e nëntokës dhe punës këshilluese për themelet mund të përcaktohet në bazë të kritereve të mëposhtme:

i. Grupi i tarifor:

Punimi i themeleve që përfshin një shkallë shumë të ulët vështirësie në planifikim.

Struktura që ndikohen shumë pak nga çedimi, me mundësi zgjidhjeje me një lloj themeli të vetëm, shtresimi i rregullt i nëntokës, aftësi mbajtëse të njëtrajtshme dhe mundësi cedimi, brenda sipërfaqes së ndërtimit.

ii. Grupi II tarifor:

Punimi i themeleve, që përfshin një shkallë të ulët vështirësie në planifikim në mënyrë specifike:

- a) Struktura, që ndikohen nga çedimi, me mundësi zgjidhjeje me lloje të ndryshme themeli apo tensione të lokalizuara, fuqimisht të ndryshme, shtresimi i rregullt i nëntokës, aftësi mbajtëse të njëtrajtshme dhe mundësi cedimi, brenda sipërfaqes së ndërtimit;
- b) Struktura që ndikohen pak nga çedimi, me mundësi zgjidhjeje me lloje të ndryshme themeli, apo tensione të lokalizuara fuqimisht të ndryshme, shtresimi i rregullt i nëntokës, aftësi mbajtëse të njëtrajtshme dhe mundësi cedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit;
- c) Struktura që ndikohen pak nga çedimi, me mundësi zgjidhjeje me një lloj të vetëm themeli, shtresimi i parregullt i nëntokës, aftësi të ndryshme mbajtëse dhe mundësi cedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit.

iii. Grupi III tarifor:

Punimi i themeleve që përfshin një shkallë mesatare vështirësie në planifikim.

- a) Struktura, që ndikohen shumë nga çedimi, me mundësi për zgjidhje, shtresimi i rregullt i nëntokës dhe aftësi mbajtëse të njëtrajtshme dhe mundësi cedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit;
- b) Struktura, që ndikohen nga çedimi, me mundësi për zgjidhje me tipe vendndodhësh të ndryshme të themelimit apo tensione të lokalizuara fuqimisht të ndryshme, me shtresim të parregullt të nëntokës, varion aftësia mbajtëse dhe mundësi cedimi, brenda sipërfaqes së ndërtimit;
- c) Struktura, që ndikohen pak nga çedimi, me mundësi për zgjidhje me tipe vendndodhësh të ndryshme të themelimit apo tensione të lokalizuara fuqimisht të ndryshme, me shtresim të parregullt të nëntokës, varion aftësia mbajtëse dhe mundësi cedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit;

- c) Struktura, që ndikohen pak nga çedimi, me mundësi zgjidhjeje me një lloj të vetëm themeli, shtresimi i parregullt i nëntokës, aftësia mbajtëse fuqimisht e ndryshme dhe mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit.

iv. Grupi IV tarifor

Punimi i themeleve, që përfshin një shkallë, mbi mesatare.

- a) Struktura, që ndikohen shumë nga çedimi, me shtresëzim të parregullt të nëntokës dhe aftësi të ndryshme mbajtëse dhe mundësi mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit;
- b) Struktura, që ndikohen nga çedimi, me mundësi për zgjidhje me tipe vendndodhesh të ndryshme të themeli apo tensione të lokalizuara fuqimisht të ndryshme, me shtresim të parregullt të nëntokës dhe aftësi mbajtëse fuqimisht e ndryshme dhe mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit;
- c) Struktura, që ndikohen pak nga çedimi, me mundësi për zgjidhje me tipe vendndodhesh të ndryshme themeli, apo tensione të lokalizuara fuqimisht të ndryshme, me shtresim të parregullt të nëntokës dhe aftësi mbajtëse fuqimisht e ndryshme dhe mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit.

v. Grupi V tarifor:

Punimi i themeleve që përfshin një shkallë shumë të lartë të vështirësie në planifikim,

Struktura, që ndikohen shumë nga çedimi, shtresimi i parregullt i nëntokës, kapaciteti mbajtës fuqimisht i ndryshëm dhe mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit.

Neni 47, paragrafi 3, aplikohet në përputhje me rrethanat.

KREU V

SHËRBIMET PËR KOLAUDIMIN

Neni 62

Tarifat për kualidimin e shërbimeve të ndërtimit

1. Gjatë kolaudimit bëhet shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit dhe provat e nevojshme për të vërtetuar kërkesat e projektit, kontratës dhe dispozitave të tjera në fuqi dhe në përfundim lëshohet çertifikata e kolaudimit.

Tabela e mëposhtme specifikon tarifat minimale dhe tarifat maksimale për shërbimet e ndërtimit:

Kostot e llogaritshme leke	Tarifa në përqindje
1 000 000	0.85

2 000 000	0.50
2 500 000	0.45
5 000 000	0.30
7 500 000	0.25
10 000 000	0.22
20 000 000	0.15
30 000 000	0.12
40 000 000	0.10
50 000 000	0.08
60 000 000	0.07
70 000 000	0.06
100 000 000	0.05
200 000 000	0.04

Tabela. 19 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 62, pika 1 – shërbimet që i takojnë shërbimeve për kolaudimin

2. Tarifa për ndertesat me kosto te llogaritshme deri 1 000 000 lekë është e pandryshueshme, për ndërtesa me kosto te llogaritshme nga 1~200 milionë lekë tarifrat ndërmjetëse merren me interpolim, ndërsa mbi 200 milionë lekë janë të pandryshueshme.
3. Kur kërkohet që gjatë kolaudimit të bëhet edhe shpërndarja e shpenzimeve në ngarkim të bashkëpronarëve të ndryshëm në varësi nga kuotat e bashkëpronësisë, tarifrat e mësipërme rriten me 30%.
4. Në raste të ndryshme dhe për objekte të rëndësisë së veçantë, kur kolaudatori caktohet që në fillim me detyrimin që të bëjë kontrolle të vazhdueshme gjatë zbatimit të punimeve, tarifrat rritet me 20%.

KREU VI SHËRBIMET E RILEVIMIT TOPOGRAFIK

Neni 63 Fusha e veprimit

1. Shërbimet e rilevimit topografik nënkuptojnë mbledhjen e të dhënave të veprave ndërtimore dhe të komplekseve të parcelave dhe topografisë, prodhimin e planeve/planshetave, transferimin e projekteve në terren, si dhe mbikëqyrjen e realizimit në aspektin topografik, si dhe shërbime, të cilat duhet të kryhen duke përdorur teknika dhe instrumenta topografikë.
2. Shërbimet e rilevimit topografik përfshijnë:
 - a) Rilevim për planifikimin dhe për projektimin e ndërtesave për veprat inxhinierike dhe për strukturat e transportit dhe qarkullimit,

- b) Rilevim i objekteve për ndërtim dhe për dokumentacionin përfundimtar për objektet ndërtimore, për veprat inxhinierike dhe për strukturat e transportit dhe qarkullimit,
- c) Rilevime dhe matje, në lidhje me objektet mbas fazës së projektimit dhe të ndërtimit, shërbime për rilevime, që nuk janë të lidhura me objektin, mbledhja e të dhënave gjeografike dhe gjeometrike, si dhe shërbime të tjera, të lidhura me rilevime.

SEKSIONI I SHËRBIME TOPOGRAFIKE NË FAZËN E PROJEKTIMIT

Neni 64 Parimet e tarifave

1. Tarifa për shërbime bazë, të rilevimit të projektit varet nga kosto e llogaritshme e objektit, grupi tarifor, në të cilën bën pjesë shërbimi i rilevimit topografik të projektit, si dhe nga tabela e parashikuar në nenin 72.
2. Kostot e llogaritshme mund të përcaktohen në bazë të llogaritjes së koston së ndërtimit, përveç, nëse kjo nuk është në dispozicion, ose në bazë të vlerësimit të koston, në qoftë se palët kontraktuese bien dakord me shkrim në një kontratë paraprake.
3. Kostot e llogaritshme janë kostot e realizimit të objektit. Ato do të llogariten në bazë të nenit 4, si dhe:
 - a) Në rastin e ndërtesave dhe ndarjeve funksionale të tyre neni 23;
 - b) Në rastin e veprave inxhinierike neni 35;
 - c) Në rastin e strukturave të transportit dhe qarkullimit Neni 41;
 - ç) Në rastin e PPV-ve dhe PDV-ve, si kosto e llogaritshme do të merret tarifa e planifikuesit urban, e cila llogaritet sipas Kreut II.
4. Në rastin ndërtesave, veprave inxhinierike dhe PDV, si kosto e llogaritshme merret kostoja e ndërtesave, veprave inxhinierike dhe PDV-ve, në pikën 3 të këtij neni, pasi i nënshtrohet rregullit të përqindjeve të mëposhtme:
 - i) Nën 25,000,000 lekë, 25%;
 - ii) Ndërmjet 25,000,000 dhe 50,000,000 lekë, 20%;
 - iii) Ndërmjet 50,000,000 dhe 100,000,000 lekë, 18%;
 - iv) Mbi 100,000,000 lekë, 15%.
5. Në rastin e PPV-ve, si kosto e llogaritshme merret kostoja e PPV-ve, në pikën 3 të këtij neni, pasi i nënshtrohet rregullit të përqindjeve të mëposhtme:
 - i) Nën 25,000,000 lekë, 20%;
 - ii) Ndërmjet 25,000,000 dhe 50,000,000 lekë, 15%;
 - iii) Ndërmjet 50,000,000 dhe 100,000,000 lekë, 13%;

iv) Mbi 100,000,000 lekë, 10%.

6. Në rastin e strukturave të transportit dhe qarkullimit, si kosto e llogaritshme merret kostoja ndërtimit të tyre.
7. Pikat 1 deri 4 të këtij neni, si dhe neni 66 dhe neni 67 nuk aplikohen për shërbimet e rilevimit topografik, në lidhje me kabllot nën dhe mbi tokë, instalimet e transportit urban me trafik kryesisht urban, përveç rrugëve ujore, këmbësore, biçikletash dhe instalimi i platformave hekurudhore. Tarifimi për projektet e listuara në këtë paragraf mund të vendosen me negociim të lirë midis palëve.

Kur një detyrë përfshin më shumë se një objekt shërbimi, atëherë tarifatat mund të llogariten të veçuara.

Neni 65 **Fazat e shërbimit**

1. Kuadri i shërbimit të rilevimit topografik në fazën e projektimit përfshijnë shërbimet topografike tokësore, fotogrametrike, për planifikimin dhe për projektimin e ndërtesave, të veprave inxhinierike, të strukturave të transportit dhe qarkullimit. Këto shërbime bazë janë përmbledhur në gjashtë faza dhe vlerësohen, mbi bazën e përqindje ndaj tarifës së shërbimit, përcaktuar në nenin 72.
2. Fazat e shërbimit dhe përqindjet përkatëse, jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Fazat e projektimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1.	Faza I	Analiza e detyrës së projektimit /termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit	3%
2.	Faza II	Grupimi i pikave të palëvizshme gjeodezike	15%
3.	Faza III	Planet e pozicionimit dhe të rilevimit	52%
4.	Faza IV	Vizatime të piketave	15%
5.	Faza V	Projekti i zbatimit: Piketat për	5%

		qëllime planifikimi	
6.	Faza VI	Seksionet gjeologjike	10%

Tabela. 20 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për rilevimet topografike.

Neni 66 Shërbimet për rilevimin topografik në fazën e projektimit

1. Faza I: Analiza e detyrës së projektimit, termave të referencës, dhe përcaktimi i bazës së projektit

i. Shërbimet bazë

- a) Gjetja dhe marrja e informacionit dhe dokumentacionit në vendndodhjen ku është planifikuar objekti.
- b) Gjetja e dokumentacionit të rilevimit. Inspektimi në vend.
- c) Vendosja e qëllimit të projektit e lidhur relativisht me kërkesat e saktësisë dhe shkallën e vështirësisë.

ii. Shërbime të veçanta

Marrja e lejeve me shkrim për të hyrë në truallin për ndërtim, leje transporti në ujë dhe leje për masat e sigurisë ndaj trafikut që kërkon autorizim.

2. Faza II: Grupimi i pikave të palëvizshme gjeodezike

i. Shërbime bazë

- a) Identifikimi dhe shënimi i pikave për pozicionim dhe rilevim.
- b) Hartimi i përshkrimeve për pikat e palëvizshme dhe shoqëruar me skemat përkatëse.
- c) Kryerja e matjeve për të përcaktuar pikat fikse dhe ato të kontrollit.
- ç) Analizimi i matjeve dhe hartimi i rrjetit mbështetës gjeodezik dhe atë të rilevimit.

ii. Shërbime të veçanta

- a) Analiza e rrjetit dhe grafikut të punimeve të rilevimit për rrjete tokësore shumë ekzakte.
- b) Shënimi i piketave për kërkesa të veçanta.
- c) Instalimi i pikave fikse dhe stacionet.

3. Faza III: Planet e pozicionimit dhe të rilevimit

i. Shërbime bazë

- a) Studimet topografike/morfologjike (tokësore/ajrore) duke përfshirë regjistrimet e pikave kufizuese.
- b) Analiza e matjeve/fotografive ajrore.
- c) Hartimi i planeve që paraqesin situatën e objektit duke përfshirë zonën e mbuluar nga projekti dhe të dhënat kadastrale.
- c) Paraqitja e rilevimeve në format të pikëzuar, matrica ose në formë vizash konturuese.
- d) Hartimi i një model terreni të dixhitalizuar.
- dh) Prezantim grafik i kanaleve, rrjetit elektrik, kabllot dhe strukturat nëntokësore sipas dokumentacionit ekzistues. Përfshi rregullat zyrtare bashkëkohore.

Të gjitha matjet të jenë në format dixhital.

ii. Shërbime të veçanta

- a) Përcaktimi dhe rilevimi i strukturave nëntokësore.
- b) Rilevimi nëntokë, nënujë ose natën.
- c) Masa të shumta për sigurinë nga trafiku që kërkojnë autorizim.
- c) Regjistrime të detajuara të projekteve ekzistuese dhe strukturave ekzistuese duke tejkalluar standardet normale topografike; p.sh. fasadat, dhe hapësirat e brendshme të ndërtesave.
- d) Përfshirja e të dhënave të pronësisë.
- dh) Paraqitja e të dhëna në shkallë të ndryshme.
- e) Rilevim jashtë zonës të mbuluar nga plani.
- ë) Përgatitja e planeve të pozicionit në lidhje me kërkesat ligjore për procedurat e pranimit zyrtar.
- f) Matje dhe regjistrime të kurorave të pemëve.

4. Faza IV: Vizatime të piketave

Llogaritja e matjeve gjeometrike bazuar në projekt dhe përpilimi i dokumentacionit dhe piketimit

i. Shërbime bazë

- a) Piketimi për projektin
- b) Përcaktimi dhe transferimi i vijës referenciale për objekte lineare në kantier
- c) Përcaktimi dhe transferimi i gjeometrisë së projektit në kantier për procedurat e orientimit dhe të vendosjes së kondicioneve urbane.

ii. Shërbime të veçanta

Realizimi i llogaritjeve optimale që kanë të bëjnë me gjeometrinë e ndërtesave (përdorimi i tokës, ndarjet dhe sipërfaqet rrugore).

5. Faza V: Projekti i zbatimit: Piketat për qëllime planifikimi

i. Shërbime bazë

- a) Transferimi në terren i vijës referenciale për objektet lineare (p.sh. kufiri i ndërtimit)
- b) Transferimi i gjurmës së projektit në terren për kontrollin e aktit të piketimit të objektit nga organet kompetente.

6. Faza VI: Seksionet gjellogjike

Identifikimi dhe paraqitja e profileve gjatësore dhe tërthore nga matjet tokësore dhe fotogrametrike.

Neni 67

Grupet tarifore për shërbimet e rilevimit topografik, në fazën e projektimit

Grupet tarifore të shërbimeve të rilevimit topografik përcaktohen në bazë të vlerësimeve të mëposhtme:

1. Shërbimet sipas grupeve tarifore:

i. Grupi I tarifor:

Shërbime për të cilat ka kërkesa minimale për topografinë.

- a) Cilësi shumë të lartë të hartave ekzistuese;
- b) Kërkesa minimale për saktësi;
- c) Cilësi shumë të lartë për vargun e pikave ekzistuese për pozicionimin, si dhe pikave fikse të lartësisë;
- ç) Probleme minimale për sa i përket natyrës së terrenit dhe aksesit të këmbësorit;
- d) Pengesa minimale nga zhvillimi ose bimësia;
- dh) Pengesa minimale nga trafiku;
- e) Dendësia minimale e karakteristikave topografike.

ii. Grupi II tarifor:

Shërbime, për të cilat ka kërkesa të ulëta për topografinë.

- a) cilësi të mirë të hartave ekzistuese,
- b) kërkesa modeste për saktësi,
- c) cilësi e lartë për vargun e pikave ekzistuese për pozicionimin, si dhe pikave fikse të lartësisë,

- c) probleme të vogla, përsa i përket natyrës së terrenit dhe aksesit të këmbësorit,
- d) pengesa të vogla nga zhvillimi ose bimësia,
- dh) pengesa të vogla nga trafiku,
- e) dendësi të ulët e karakteristikave topografike.

iii. Grupi III tarifor:

Shërbime, për të cilat ka kërkesa mesatare për topografinë.

- a) Cilësi të kënaqshme të hartave ekzistuese;
- b) Kërkesa mesatare për saktësi;
- c) Cilësi mesatare për vargun e pikave ekzistuese për pozicionimin, si dhe pikave fikse të lartësisë;
- ç) Probleme mesatare, përsa i përket natyrës së terrenit dhe aksesit të këmbësorit;
- d) Pengesa mesatare nga zhvillimi ose bimësia;
- dh) Pengesa mesatare nga trafiku;
- e) Dendësi mesatare e karakteristikave topografike.

iv. Grupi IV tarifor:

Shërbime për të cilat ka kërkesa mbi mesataren për topografinë.

- a) Cilësi pothuajse e përshtatshme të hartave ekzistuese;
- b) Kërkesa mbi mesataren për saktësi;
- c) Cilësi pothuajse të përshtatshme për vargun e pikave ekzistuese për pozicionimin, si dhe pikave fikse të lartësisë;
- ç) Probleme mbi mesataren, përsa i përket natyrës së terrenit dhe aksesit të këmbësorit;
- d) Pengesa mbi mesataren nga zhvillimi ose bimësia;
- dh) Pengesa mbi mesataren nga trafiku;
- e) Dendësi mbi mesataren e karakteristikave topografike.

v. Grupi V Tarifor:

1. Rilevime me kërkesa të larta topografike.

- a) Harta ekzistuese jo cilësore;
- b) Kërkesa me saktësi të lartë;
- c) Të dhëna jo cilësore mbi pozicionin dhe lartësinë e pikave të palëvizshme ekzistuese;
- ç) Probleme të rënda për sa i përket natyrës së tokës dhe kalimeve të këmbësorëve;
- d) Pengesa shumë të mëdha nga bimësia;
- dh) Pengesa shumë të mëdha nga trafiku;
- e) Dendësi shumë e lartë topografike..

2. Kur një ose më shumë grupe tarifore plotësojnë kriteret e nevojshme në lidhje me

projektin e rilevimit, është vështirë të përcaktohet se cili grup tarifor është i përshtatshëm për projektin. Në këtë rast është e nevojshme që të saktësohet një sistem i pikëzimit, sikurse përshkruhet në paragrafin 1.3.3.3. më poshtë, si dhe të përcaktohet grupi tarifor, bazuar në shumën totale të pikëve. Rilevimi mund të klasifikohet në grupet e mëposhtme tarifore:

- i) Grupi I tarifor: Rilevim deri në 14 pikë;
- ii) Grupi II tarifor: Rilevim nga 15-25 pikë;
- iii) Grupi III tarifor: Rilevim nga 26-37 pikë;
- iv) Grupi IV tarifor: Rilevim nga 38-48 pikë;
- v) Grupi V tarifor: Rilevim nga 49-60 pikë.

3. Për të përcaktuar grupin e saktë tarifor për shërbimet e topografisë në fazën e projektimit, vlerësimi me pikë bëhet duke reflektuar në shkallën e vështirësisë së kërkesave të vëna nga topografi për kriteret e vlerësimit.

- a) Cilësia e hartave ekzistuese;
- b) Kërkesa në lidhje me saktësinë e cilësinë e përmasave ekzistuese të pozicionit dhe lartësisë për pikat e palëvizshme;
- c) Të dhëna mbi pozicionin dhe lartësinë e pikave të pa lëvizshme ekzistuese;
- ç) Probleme për sa i përket natyrës së tokës dhe kalimeve të këmbësorëve;
- d) Pengesat nga bimësia;
- dh) Pengesat nga trafiku;
- e) Densiteti i karakteristikave topografike.

4. Për të caktuar grupin e saktë të tarifave të rilevimit topografik, bëhet vlerësimi si më poshtë:

- Pika i), ii) dhe iii) deri në 5 pikë;
- Pika iv) v) dhe vi) deri në 10 pikë;
- Pika vii) deri në 15 pikë.

SEKSIONI II

SHËRBIMI TOPOGRAFIK NË FAZËN E NDËRTIMIT

NENI 68

Parimet e tarifimit

1. Tarifatat për shërbimet bazë lidhur me rilevimet për ndërtime, janë përcaktuar duke ju referuar kostove të llogaritshme të objektit, grupit tarifor në të cilin përfshihet projekti i rilevimit dhe tabelës së tarifave në neni 72.
2. Kostot e llogaritshme mund të llogariten sipas pikës 3, nenit 64. Baza e llogaritjes së tarifës për shërbimin topografik në fazën e ndërtimit merret:

- i) 80% të kostove të llogaritshme në strukturat e transportit dhe qarkullimit;
 - ii) 60% e kostove të llogaritshme në ndërtesat dhe në veprat inxhinierike.
3. Pikat 1 dhe 2 me sipër dhe neni 69 dhe neni 71 nuk aplikohen për shërbime rilevimi që kanë të bëjnë me kabllot mbi dhe nën tokë, tunele, galeri ose shpella, instalimet e transportit urban dhe kryesisht trafikun urban përveç rrugëve ujore, dhe kalimeve të kalimtarëve e për biçikleta, dhe instalimet e platformave hekurudhore. Çmimi për projektet e sipërpërmendura mund të negociohet më vete.
 4. Pavarësisht nenit 69, tarifat për Fazën III të shërbimit, mund të tarifohen në 45-66% në rastin e ndërtesave.

Neni 69 Fazat e shërbimit

Kuadri i shërbimit të rilevimit topografik në fazën e ndërtimit përfshijnë shërbimet topografike tokësore, fotogrametrike, për planifikimin dhe për projektimin e ndërtesave, të veprave inxhinierike, të strukturave të transportit dhe qarkullimit. Këto shërbime bazë janë përmbledhur në katër faza dhe vlerësohen, mbi bazën e përqindje ndaj tarifës së shërbimit, përcaktuar në nenin 72.

Fazat e shërbimit dhe përqindjet përkatëse, jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Fazat e projektimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza I	Shërbimet këshilluese për gjeometrinë e ndërtesës	2%
2	Faza II	Piketime për ekzekutim	14%
3	Faza III	Matja e realizimit të punimeve	66%
4	Faza IV	Mbikëqyrja e aspekteve topografike në zbatim	18%

Tabela. 21 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për rilevimet topografike, shërbimet e veçanta.

Neni 70

Shërbimet për rilevimin topografik në fazën e ndërtimit

1. Faza I: Shërbimet këshilluese për gjeometrinë e ndërtesës

i. Shërbimet bazë

- a) Këshillim gjatë fazës së projektimit, vecanërisht në aspektin e kërkesave të saktësisë dhe të tolerancave, konceptimi i një programi matës, përcaktimi i masave si sistem referencial dhe emërtimi i tyre.
- b) Përcaktimi i një programi për matjet e lëvizshme dhe për deformimet përfshirë punët përgatitore dhe ndihmëse në kantiër.

ii. Shërbime të veçanta

- a) Përpilim i grafikut të punimeve për specifikimet e projektit të rilevimit;
- b) Përgatitja e propozimeve organizative për ndarjet e kompetencave të përgjegjësisë për pikat e takimit gjatë matjes së objektit.

2. Faza II: Piketime për ekzekutim

i. Shërbimet bazë

- a) Përcaktimi i pikës gjeodezike;
- b) Përcaktimi dhe transferimi i pikave të palëvizshme, horizontale dhe vertikale;
- c) Përgatitja e skicave të rilevimit dhe i përshkrimit të pikave referenciale;
- ç) Matja për përcaktimin e pikave të palëvizshme dhe të ndërmjetme;
- d) Vlerësimi i matjeve dhe përgatitja e të dhënave mbi koordinatat dhe lartësitë.

3. Faza III: Matja e realizimit të punimeve

i. Shërbimet bazë

- a) Përgatitja e planit të rilevimit dhe kuotave;
- b) Matje për të prodhuar të tjera pika pozicioni dhe pika të palëvizshme dhe të ndërmjetme
- c) Matje për të kontrollimin dhe mbajtjen e pikave të palëvizshme dhe të ndërmjetme;
- ç) Piketime për shoqërimin e vazhdueshëm të pikave strukturore për pozicionim në plan dhe lartësi.
- d) Matje për të regjistruar lëvizjet dhe deformimet e objektit gjatë ndërtimit për pika të rëndësishme strukturore (nuk është shërbim bazë për punimet në ujësjellësa urë). Matje për kontroll.
- dh) Regjistrime të vazhdueshme gjatë ekzekutimit, të cilat do të reflektohen në vizatimet e hartuara pas ndërtimit.

ii. Shërbime të veçanta

- a) Piketimi duke patur parasysh deformimet nën ndikimin e ngarkesave teknike dhe realizimit/prodhimit;
- b) Testime për saktësinë e dimensioneve për komponentët e parafabrikuara;
- c) Matja e punimeve të ndërtimit aty ku kërkohet rilevim i veçantë;
- ç) Hartimi i vizatimeve gjatë ekzekutimit;
- d) Hartimi i vizatimeve të metejshme pas përfundimit të shërbimeve bazë.

4. Faza IV: Mbikëqyrja e aspekteve topografike në zbatim

i. Shërbimet bazë

- a) Kontrolli gjatë zbatimit të projektit për kryerjen e provave/matjeve të formave të betonit, dhe komponentëve strukturorë;
- b) Hartimi i raporteve të rilevimit;
- c) Kryerja e provave/matjeve për lëvizje dhe deformim gjatë ndërtimit për pikat kryesore strukturale.

ii. Shërbime të veçanta

- a) Kontrolli i llogaritjeve sasiore;
- b) Hartimi dhe zbatimi i një programi afatgjatë për monitorimin e rilevimit me qëllim mbikëqyrjen e ndërtesës;
- c) Matje në mbështetje të pranimit të punëve në ndërtesë ku ka kërkesa të veçanta për rilevim.

Neni 71

Grupet tarifore për shërbime të rilevimit topografik në fazën e projektimit

1. Grupet tarifore për rilevimin mund të përcaktohet bazuar në kriteret e mëposhtme:

i. Grupi I tarifor:

Rilevime që kanë kërkesa minimale topografike.

- a) Ndikimi minimal nga struktura e relievit dhe nga karakteristika për të qarkulluar mbi të;
- b) Pengesa minimale nga ndërtimi dhe bimësia;
- c) Pengesa minimale nga trafiku;
- ç) Kërkesa minimale për saktësinë;
- d) Kërkesa minimale në lidhje me gjeometrinë e objektit;
- dh) Pengesa minimale nga veprimtaritë në kantier.

ii. Grupi II tarifor:

Rilevime që kanë kërkesa të vogla topografike.

- a) Ndikimi i vogël nga struktura e relievit dhe nga karakteristika për të qarkulluar mbi të;
- b) Pengesa të vogla nga ndërtimi dhe bimësia;
- c) Pengesa të vogla nga trafiku;
- ç) Kërkesa të vogla për saktësinë;

- d) Kërkesa minimale në lidhje me gjeometrinë e objektit;
- dh) Pengesatë vogla nga veprimtaritë në kantier.

iii. Grupi III tarifor:

Rilevime që kanë kërkesa mesatare topografike.

- a) Ndikimi mesatar nga struktura e relievit dhe nga karakteristika për të qarkulluar mbi të;
- b) Pengesa mesatare nga ndërtimi dhe bimësia;
- c) Pengesa mesatare nga trafiku;
- ç) Kërkesa mesatare për saktësinë;
- d) Kërkesa mesatare në lidhje me gjeometrinë e objektit;
- dh) Pengesa mesatare vogla nga veprimtaritë në kantier.

iv. Grupi IV tarifor:

Rilevime që kanë kërkesa mbi-mesatare topografike.

- a) Ndikimi mbi mesatar nga struktura e relievit dhe nga karakteristika për të qarkulluar mbi të;
- b) Pengesa mbi mesatare nga ndërtimi dhe bimësia;
- c) Pengesa mbi mesatare nga trafiku;
- ç) Kërkesa mbi mesatare për saktësinë;
- d) Kërkesa mbi mesatare në lidhje me gjeometrinë e objektit;
- dh) Pengesa mbi mesatare vogla nga veprimtaritë në kantier.

v. Grupi V tarifor:

Rilevime që kanë kërkesa të larta topografike.

- a) Ndikimi shume te lartë nga struktura e relievit dhe nga karakteristika për të qarkulluar mbi të;
- b) Pengesa shumë të larta nga ndërtimi dhe bimësia;
- c) Pengesa shumë të larta nga trafiku;
- ç) Kërkesa shumë të larta për saktësinë;
- d) Kërkesa shumë të larta në lidhje me gjeometrinë e objektit;
- dh) Pengesa shumë të lartanga veprimtaritë në kantier.

2. Neni 67 dhe nënpika 1 e pikës v, të nenit 67 aplikohet sipas rastit.

3. Për të përcaktuar grupin e saktë tarifor për sa i përket projektit të rilevimit, pikët duhet të vlerësohen duke reflektuar shkallën e vështirësisë së kërkesave të vëna nga topografi për kriteret e vlerësimit si më poshtë:

- i) Ndikimi i strukturave të relievit dhe nga karakteristika për të qarkulluar mbi të;
 - ii) Pengesa nga ndërtimi dhe bimësia;
 - iii) Pengesa nga trafiku;
 - iv) Kërkesa për saktësinë;
 - v) Kërkesa në lidhje me gjeometrinë e objektit;
 - vi) Pengesa nga veprimtaritë në kantier.
- Pika i), deri në 5 pikë

- Pikaa) iii) iv) dhe v) deri në 10 pikë
Pika vi) deri në 15 pikë
4. Pasi të jetë bërë vlerësimi i pikëzuar duhet t'i referoheni në pikës 1 të pikës v, të nenit 67, për të përcaktuar grupin tarifor.

SEKSIONI III

Tabela e tarifave për shërbimet e rievimeve topografike

Neni 72

Tabela e tarifave

Tabela e mëposhtme e tarifave përcakton tarifat për shërbimet e renditura në Nenin 63 lidhur me rievimet topografike.

TABELA SHOQËRUESE E TARIFAVE NË LIDHJE ME TOPOGRAFINË

KOSTOT E LLOGARITSHME LEKE	GRUPI TARIFOR I		GRUPI TARIFOR II		GRUPI TARIFOR III		GRUPI TARIFOR IV		GRUPI TARIFOR V		
	NGA %	DERI %	NGA %	DERI %	NGA %	DERI %	NGA %	DERI %	NGA %	DERI %	
3,000,000	2.12	2.43	2.43	2.74	2.74	3.04	3.04	3.04	3.43	3.43	3.66
5,000,000	1.94	2.25	2.25	2.56	2.56	2.86	2.86	2.86	3.25	3.25	3.48
7,000,000	1.76	2.07	2.07	2.38	2.38	2.68	2.68	2.68	3.07	3.07	3.30
14,000,000	1.33	1.53	1.53	1.73	1.73	1.93	1.93	1.93	2.13	2.13	2.33
21,000,000	1.15	1.31	1.31	1.48	1.48	1.64	1.64	1.64	1.80	1.80	1.97
28,000,000	1.03	1.17	1.17	1.31	1.31	1.44	1.44	1.44	1.59	1.59	1.72
35,000,000	0.94	1.06	1.06	1.19	1.19	1.31	1.31	1.31	1.44	1.44	1.56
42,000,000	0.87	1.05	1.05	1.10	1.10	1.21	1.21	1.21	1.32	1.32	1.43
49,000,000	0.82	0.93	0.93	1.03	1.03	1.13	1.13	1.13	1.24	1.24	1.34
56,000,000	0.79	0.89	0.89	0.98	0.98	1.08	1.08	1.08	1.18	1.18	1.28
63,000,000	0.76	0.85	0.85	0.94	0.94	1.04	1.04	1.04	1.13	1.13	1.22
70,000,000	0.73	0.82	0.82	0.91	0.91	1.00	1.00	1.00	1.09	1.09	1.18
105,000,000	0.60	0.68	0.68	0.75	0.75	0.82	0.82	0.82	0.89	0.89	0.96
140,000,000	0.54	0.60	0.60	0.66	0.66	0.72	0.72	0.72	0.79	0.79	0.85
210,000,000	0.47	0.52	0.52	0.58	0.58	0.63	0.63	0.63	0.68	0.68	0.74
280,000,000	0.44	0.48	0.48	0.53	0.53	0.58	0.58	0.58	0.63	0.63	0.68
350,000,000	0.42	0.46	0.46	0.51	0.51	0.55	0.55	0.55	0.60	0.60	0.65
420,000,000	0.40	0.45	0.45	0.49	0.49	0.53	0.53	0.53	0.58	0.58	0.62
490,000,000	0.39	0.44	0.44	0.48	0.48	0.52	0.52	0.52	0.56	0.56	0.61
560,000,000	0.39	0.43	0.43	0.47	0.47	0.51	0.51	0.51	0.55	0.55	0.59
630,000,000	0.38	0.42	0.42	0.46	0.46	0.50	0.50	0.50	0.54	0.54	0.59
700,000,000	0.38	0.42	0.42	0.46	0.46	0.50	0.50	0.50	0.54	0.54	0.58
1,050,000,000	0.36	0.40	0.40	0.44	0.44	0.48	0.48	0.48	0.52	0.52	0.56
1,400,000,000	0.35	0.39	0.39	0.43	0.43	0.47	0.47	0.47	0.51	0.51	0.54
1,431,617,320	0.35	0.39	0.39	0.43	0.43	0.47	0.47	0.47	0.51	0.51	0.54

Tabela. 22 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 72– shërbimet e rievimit topografik.

Neni 73
Shërbime të rilevimit topografik kadastrale

Tabela e mëposhtme e tarifave përcakton tarifat për shërbimet kadastrale lidhur me rilevimet topografike.

Nr	Lloji I shërbimit	Njesia	Cmimi/leke	
1	Dixhitalizim i hartave ekzistuese	pasuri	100	
2	Informatizim i kartelave të pusurisë	cope	200	
3	Azhornim i hartave kadastrale për zone kadastrale	Shkalla 1:500	pasuri	10000
		Shkalla 1:1000	pasuri	7000
		Shkalla 1:2500	pasuri	6000
Plan rilevimi				
4	Plan rilevimi për ndërtesa	deri 100 m ²	ndertese	16000
		nga 101 m ² deri në 500 m ²	ndertese	15000
		mbi 501 m ²	ndertese	25000
5	Planimetri për njësite në ndërtesa	deri 50 m ²	njesi	15000
		nga 51 m ² deri 100 m ²	njesi	16000
		mbi 101 m ²	njesi	22000
6	Plan rilevimi për parcela	deri 300 m ²	parcel	27000
		nga 301 m ² deri në 1000 m ²	parcel	32000
		nga 1000 m ² deri në 5000 m ²	parcel	40000
		mbi 5000 m ²	l/m ²	10
7	Plan rilevimi për ndarje ose bashkim pasurie	deri në 2 parcela	cope	27000
		për çdo ndarje tjetër	cope	4000
8	Konsulencë teknike	ore/punë	4000	

Tabela. 23 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 73- shërbimet e rilevimit topografik kadastrale.

KREU VII
SHËRBIMET E STUDIMEVE TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Neni 74
Fazat e studimeve të ndikimit në mjedis

1. Shërbimet bazë, që i takojnë studimeve të ndikimit në mjedis, për të vlerësuar gjendjen ekzistuese si pjesë e vlerësimit të ndikimit në mjedis, mund të përmbliken nga shërbimet të përcaktuara në nenin 74, në vijim.

Fazat e shërbimit dhe përqindjet përkatëse jepen në tabelën më poshtë:

Nr.	Shërbimet e studimeve të ndikimit në mjedis	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza I	Aplikimi për VNM paraprake	30%
2	Faza II	Njoftimi për rastet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së	20%
3	Faza III	Organizimi i dëgjësës publike për konsultimin e draft raportit të VNM-së të thelluar	20%
4	Faza IV	Aplikimi për deklaratë Mjedisore	30%

Tabela. 24 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për vlerësimet e ndikimit në mjedis

Neni 75

Shërbimet për studimet e ndikimit në mjedis

1. Faza I: Aplikimi për VNM paraprake

A) Raportin teknik të projektit të propozuar, i cili përmban:

- a) qëllimin e projektit të propozuar;
- b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit;
- c) kufijtë e sipërfaqes në hartë topografike, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE;
- ç) fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
- d) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti;
- dh) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektit, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;

- e) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- ë) informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
- f) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- g) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
- gj) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
- h) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
- i) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
- j) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
- k) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;
- l) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

B) Raportin paraprak të VNM-së, i cili përmban:

- a) përshkrimin e mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;
- b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;
- c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
- ç) një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;
- d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;
- dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;
- e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
- ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

2) Njoftimi për raportin e thelluar të VNM-së përmban:

C) Raportin teknik të projektit të propozuar, i cili përfshin:

- a) përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar;
- b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
- c) informacionin për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;
- ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit;
- d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- dh) të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
- e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit;
- f) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
- g) informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
- gj) informacion për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
- h) të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe për mënyrën e sigurimit të tyre;
- i) të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
- j) informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit.
- k) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

- Ç) Informacion për ndërveprimin me mjedisin të projektit, i cili përmban
- a) një përshkrim të shkurtër të mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, të shoqëruar dhe me imazhe të marra jo më vonë se 6 muaj nga data e aplikimit;
 - b) informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;
 - c) një identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër;
 - ç) një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve;
 - d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;
 - dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;
 - e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të sipërfaqes së mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
 - ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
 - f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

2. Faza II: Njoftimi për rastet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së.

3. Faza III: Organizimi i dëgjësës publike për konsultimin e draft raportit të VNM-së të thelluar.

Pas marrjes së njoftimit nga Agjencia Kombëtare të Mjedisit në këtë fazë hartohet projektraporti i thelluar i VNM-së dhe organizohet dëgjesa me publikun, sipas procedurave të legjislationit përkatës në fuqi për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrje.

4. Faza IV: Aplikimi për deklaratë Mjedisore

Në përfundim të dëgjësës vlerësohen komentet e publikut dhe hartohet Raporti i Thelluar i VNM-së, sipas kriterëve të legjislationit përkatës në fuqi.

Neni 76

Grupet tarifore për shërbimet bazë, lidhur me studimet e ndikimit në mjedis

1. Tarifat fikse për shërbimet, lidhur me studimet e ndikimit në mjedis, janë përcaktuar, duke iu referuar kriterëve në vijim:

i. Grupi I tarifor:

Studime të ndikimit në mjedis, në një shkallë të ulët vështirësie, specifiku për një zonë në studim:

- a) Me një nivel të ulët të strukturave ekologjike të rëndësishme,
- b) Me një nivel të ulët ndryshueshmërie të peizazhit,

- c) Me një nivel të ulët të përdorimit rekreativ,
- c) Me një ndryshueshmëri të ulët të kufijve ose të kërkesave të përdorimit,
- d) Me një nivel të ulët të ndjeshmërisë së presioneve ndaj mjedisit dhe problemeve të ekosistemit dhe peizazhit,
- dh) Projekteve dhe masave me nivel të ulët të intensitetit të mundshëm të dëmtimeve;

ii. Grupi II tarifor:

Studime të ndikimit në mjedis, me një shkallë vështirësie mesatare, specifikisht për një zonë në studim:

- a) Me një nivel mesatar të strukturave, ekologjikisht të rëndësishme,
- b) Me një nivel mesatar ndryshueshmërie të peizazhit,
- c) Me një nivel mesatar të përdorimit rekreativ,
- c) Me një ndryshueshmëri mesatare të kufijve ose të kërkesave të përdorimit,
- d) Me një nivel mesatar të ndjeshmërisë së presioneve ndaj mjedisit dhe problemeve të ekosistemit dhe peizazhit,
- dh) Projekteve dhe masave, me nivel mesatar të intensitetit të mundshëm të dëmtimeve;

iii. Grupi III tarifor:

Studime të ndikimit në mjedis, me një shkallë vështirësie të lartë, specifikisht për një zonë në studim:

- a) Me një nivel të variueshëm dhe më të gjerë të strukturave ekologjikisht të rëndësishme,
- b) Me një shkallë të lartë ndryshueshmërie të peizazhit,
- c) Me një përdorim rekreativ intensiv,
- c) Me një ndryshueshmëri të lartë të kufijve ose të kërkesave të përdorimit,
- d) Me një nivel të lartë të ndjeshmërisë së presioneve ndaj mjedisit dhe problemeve të ekosistemit dhe peizazhit,
- dh) Projekteve dhe masave me nivel të lartë të intensitetit potencial të dëmtimeve.

2. Për rastet, kur studimet e ndikimit në mjedis kanë kritere, të cilat nuk përfshihen brenda të njëjtit grup tarifor dhe që bëhen shkas për pasiguri në përcaktimin e secilit grup tarifor do t'i përkojë studimi, atëherë do të ndiqet sistemi i përlllogaritjes së pikëve, siç parashtrohet në paragrafin 1.1.2.3, në vijim dhe përcaktimi i grupit tarifor do të bëhet mbi bazën e shumës totale të pikëve të grumbulluara.

- i) Grupi I tarifor: Studime të ndikimit në mjedis deri 16 pikë;
- ii) Grupi II tarifor: Studime të ndikimit në mjedis me 17-30 pikë;
- iii) Grupi III tarifor: Studime të ndikimit në mjedis me 31-42 pikë.

3. Për të caktuar studimin e ndikimit në mjedis, në grupin tarifar të duhur, do të vendosen pikë, që reflektojnë shkallën e vështirësisë për kërkesat e mëposhtme:

- i) Niveli i strukturave me rëndësi ekologjike;
- ii) Pamja e peizazhit;
- iii) Përdorimi rekreativ;
- iv) Kërkesat për përdorim, sa i komplikuar është destinacioni (shkalla e vështirësisë për arkitektin);
- v) Ndjeshmëria ndaj presioneve mjedisore dhe problematikat e ekosistemit të peizazhit;
- vi) Projektet dhe masat, me një nivel të lartë të intensitetit potencial, të ndikimit në mjedis:

4. Për të caktuar grupin e saktë tarifar të studimeve të ndikimit në mjedis, bëhet vlerësimi si më poshtë:

Pika i), ii) iii) dhe iv) deri në 6 pikë;

Pika v) dhe vi) deri në 9 pikë.

Neni 77

Tabela e tarifave

Tarifat për shërbimet bazë, të listuara në nenin 73 dhe 74, në lidhje me studimet e ndikimit në mjedis, bazohen në tabelën në vijim të tarifave, që përmban vlerën e tarifës minimale dhe maksimale, në përputhje me sipërfaqen totale të zonës në studim, në hektarë.

TABELA SHOQËRUESE E TARIFAVE TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS						
SIPERFAQE NË HEKTARË	GRUPI TARIFOR I		GRUPI TARIFOR II		GRUPI TARIFOR III	
	Nga	Deri	Nga	Deri	Nga	Deri
	Lekë	Lekë	Lekë	Lekë	Lekë	Lekë
0.5	9,310	11,369	11,369	13,419	13,419	15,479
1	11,172	13,643	13,643	16,103	16,103	18,574
5	55,860	68,217	68,217	80,515	80,515	92,872
10	111,720	136,434	136,434	161,029	161,029	185,743
20	223,440	181,853	181,853	214,657	214,657	247,564
30	335,160	299,128	299,128	356,145	356,145	413,251
40	446,880	468,794	468,794	562,947	562,947	657,101
50	558,600	682,168	682,168	805,147	805,147	928,716
100	744,726	909,263	909,263	1,073,284	1,073,284	1,237,821
250	1,210,116	1,495,642	1,495,642	1,780,726	1,780,726	2,066,253
500	1,873,126	2,343,968	2,343,968	2,814,737	2,814,737	3,285,505
750	2,449,189	3,091,495	3,091,495	3,734,316	3,734,316	4,376,695
1000	2,978,463	3,788,179	3,788,179	4,597,968	4,597,968	5,407,684
1250	3,461,168	4,421,053	4,421,053	5,380,789	5,380,789	6,340,600
1500	3,909,168	5,026,000	5,026,000	6,142,905	6,142,905	7,259,737
1750	4,397,768	5,646,863	5,646,863	6,895,442	6,895,442	8,144,463
2000	4,839,947	6,205,095	6,205,095	7,570,168	7,570,168	8,935,242
2500	5,642,737	7,232,842	7,232,842	8,822,874	8,822,874	10,412,979
3000	6,422,242	8,167,305	8,167,305	9,912,442	9,912,442	11,657,505
3500	7,085,326	8,985,347	8,985,347	10,885,884	10,885,884	12,785,979
4000	7,725,126	9,741,642	9,741,642	11,758,600	11,758,600	13,775,116
4500	8,272,158	10,436,263	10,436,263	12,600,295	12,600,295	14,764,400
5000	8,842,326	11,130,368	11,130,368	13,418,779	13,418,779	15,706,821
5500	9,470,705	11,816,663	11,816,663	14,163,063	14,163,063	16,509,021
6000	10,052,074	12,472,232	12,472,232	14,892,021	14,892,021	17,312,179
6500	10,587,537	13,108,421	13,108,421	15,628,863	15,628,863	18,149,747
7000	11,076,063	13,728,768	13,728,768	16,381,474	16,381,474	19,034,105
7500	11,692,726	14,485,063	14,485,063	17,277,400	17,277,400	20,069,737
8000	12,286,179	15,202,379	15,202,379	18,118,653	18,118,653	21,034,926
8500	12,855,979	15,954,547	15,954,547	19,053,632	19,053,632	22,152,200
9000	13,403,011	16,683,947	16,683,947	19,964,884	19,964,884	23,245,821
9500	13,926,463	17,426,537	17,426,537	20,926,316	20,926,316	24,426,537
10000	14,426,632	18,149,747	18,149,747	21,872,863	21,872,863	25,595,905

Tabela. 25 Tabela shoqëruese e tarifave, neni 76- shërbimet e lidhur me studimet e ndikimit në mjedis.

KREU VIII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 78

Dispozitat kalimtare

Ky Manual nuk aplikohet ndaj shërbimeve, që sigurohen nga ofruesit në zbatim të kontratave të mbyllura, përpara datës në të cilën ai hyn në fuqi. Sipas kësaj, vazhdojnë të respektohen rregulloret e mëparshme.

Neni 79

Shfuqizimet

Vendimi nr.704, datë 29.10.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", vendimi nr.888, datë 17.12.2014, "Për disa shtesa e ndryshime në vendimi nr.704, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", shfuqizohen.

Neni 80

Hyrja në Fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

Shtojca 1. Ref. Nenet 13: Interpolimi

Në rast se kostoja e llogaritëshme ($X =$ vlera e preventivit), është një vlerë e cila nuk gjendet në tabelë atëherë do të përdorimin formulën e interpolimit për të gjetur tarifën, e cila do të llogaritet si më poshtë:

Në fillim do të gjejmë në tabelë kostot e llogaritëshme, mes të cilave ndodhet kostoja e llogaritëshme (X) për të cilën duam të llogarisim tarifën.

Kostoja e llogaritëshme K_1 me vlerë minimale (a) vlerë maksimale (b)

Kostoja e llogaritëshme K_2 me vlerë minimale (c) vlerë maksimale (d)

Llogarisim koston minimale/maksimale mes vlerave a dhe b sipas formulës:

$$H_1 = a + (0 \div 1) \times (b - a)$$

Llogarisim koston minimale/maksimale mes vlerave c dhe d sipas formulës:

$$H_2 = c + (0 \div 1) \times (d - c)$$

Llogarisim diferencën e kostove të llogaritëshme reale $X - K_1 = D_1$

Llogarisim diferencën mes dy kostove $K_2 - K_1 = D_2$

Llogarisim diferencën minimale/maksimale:

$$H_2 - H_1 = D_3 \text{ min}$$

$$H_2 - H_1 = D_3 \text{ max}$$

Formula e interpolimit për tarifën minimale, do të jetë:

$$H_1 + \frac{D_{3\text{min}} \times D_1}{D_2}$$

$$a + 0 \times (b - a) + \frac{[(c + 0 \times (d - c)) - (a + 0 \times (b - a))] \times (X - K_1)}{K_2 - K_1} = \text{tarifa minimale}$$

Formula e interpolimit për tarifën maksimale do të jetë :

$$H1 + \frac{D3_{\max} \times D1}{D2}$$

$$a + 1 \times (b-a) + \frac{[(c+1 \times (d-c)) - (a+1 \times (b-a))] \times (X-K1)}{K2 - K1} = \text{tarifa maksimale}$$

Për vlerën e saktë të tarifës bihet dakord mes palëve, gjatë momentit të nënshkrimit të kontratës, ku kjo vlerë do të jetë mes kufijve minimalë dhe maksimalë të mësipërm.